# RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

# MBI PËRPUTHSHMËRINË & RREGULLSHMËRINË

# NË

# “QENDRËN KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE”

**Qershor 2023**

| Nr. | Përmbajtja | Faqe |
|---|---|---|
| **I** | **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** | **2** |
| 1. | Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfunditmar të Auditimit | 2 |
| 2. | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve | 2 |
| 3. | Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit | 11 |
| **II.** | **HYRJA** | **13** |
| 1. | Titulli........................................................................................................ | 13 |
| 2. | Marrësi..................................................................................................... | 13 |
| 3. | Objektivat dhe qëllimi........................................................................... | 14 |
| 4 | Identifikimi i çështjes........................................................................... | 14 |
| 5 | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese................................................... | 14 |
| 6 | Përgjegjësitë e audituesve.................................................................... | 14 |
| 7 | Kriteret e vlerësimit............................................................................. | 14 |
| 8 | Standardet e auditimit.......................................................................... | 15 |
| 9 | Metoda e auditimit................................................................................ | 15 |
| 10 | Dokumentimi i auditimit...................................................................... | 15 |
| **III.** | **PËRSHRIMI I AUDITIMIT..........................................................................** | **15** |
| 1. | Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.................................... | 15 |
| 2. | Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit........................................... | 16 |
| 2.1 | **Pika 1** Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre | 16 |
| 2.2 | **Pika 2** Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore | 16 |
| 2.3 | **Pika 3** Mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit si dhe shpenzimet administrative | 16 |
| 2.4 | **Pika 4** Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve. | 29 |
| 2.5 | **Pika 5** Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimi i punimeve ,deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve. | 31 |
| 2.6 | **Pika 6** Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizimet. Etj) | 55 |
| 2.7 | **Pika 7** Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit (identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi, Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm). | 62 |
| **IV.** | **GJETJET DHE REKOMANDIMET...........................................................** | **64** |
| | Masa Organizative | 64 |
| | Masa Shpërblim Dëmi | 72 |
| | Masa për Eliminimin e Efekteve Negative | 73 |
| **V.** | **Lista e dokumentacionit të auditimit............................................................** | **75** |
| **VI** | **ANEKSE.........................................................................................................** | **76** |

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit**

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e KLSH"*, në zbatim të projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së nr. 1200/1 Prot., datë 17.01.2023, i ndryshuar, për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2022 si dhe zhvillimin e auditimit "Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë" nga data 16.01.2023 deri më datë 16.03.2023 në subjektin Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore. ( Këtu e tutje QKUM).

**Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve**

| Nr. | Përmbledhje | Ref. | Rëndësia | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nga auditimi i kërkesave buxhetore të vitit 2021, është konstatuar se kërkesat e mëposhtme nuk janë të mire argumentuara si:<br>-Shpenzime për anëtarët e parlamentit në shumën 960 mijë lekë.<br>-Shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna" në shumën 900 mijë lekë.<br>-Pajisje për përdorim policor në shumën 960 mijë lekë.<br>-Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulike në shumën 2,700 mijë lekë.<br>-Shpenzime për mirëmbajtjen e rezervës shtetërore në shumën 960 mijë lekë.<br>-Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore në shumën 1,500 mijë lekë.<br>-Shpenzime gjyqësore në shumën 960 mijë lekë.<br>QUKM ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktin konkret të projektit dhe programit buxhetor, si edhe një analizë e detajuar prioritarizmi duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, duke cënuar kështu përdorimin me eficencë, efektivitet dhe produktivitet të fondeve në dispozicion të institucionit. | 2.3 | E Mesme | QKUM, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm dhe të nevojshëm të kërkesave buxhetore duke argumentuar të gjitha kërkesat, lidhjen e objektivave të tyre me produktin e programit buxhetor, bazuar në një analizë buxhetore prioritarizmi të dokumentuar, me qëllim parandalimin e keq planifikimit të fondeve të institucionit. |
| 2 | Parashikimi i *"shpenzimeve për personelin"* përfshin pagat bruto për punonjësit e përhershëm dhe të përkohshëm, (punonjësit e përkohshëm, janë kërkuar personel mjekësor shtesë për shkak të pandemisë), shtesat mujore mbi pagë si orët për turnet e dyta dhe të treta. Përveç shpenzimeve për paga, parashikohen edhe shpenzimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat janë planifikuar në masën 16.7% të nivelit të bazës së pagës bruto.<br>Punonjësit e përhershëm i përkasin strukturës së QKUM pra 86 punonjës (punonjësit e përkohshëm janë kërkuar për shtesë 49 | 2.3 | | QKUM, të adresojë pranë MSHMS kërkesën për rishikim të menjëhershëm të strukturës organizative të institucionit, shoqëruar me relacionin përkatës argumentues mbi domosdoshmërinë e limitimit të pozicioneve të punës me kontratë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | punonjës (personel mjekësor për shkak të pandemisë mjekë, infermierë, dhe shoferë), Parashikimi i shpenzimeve për paga, ka ndryshim të fondit të pagave në PBA e viteve 2021-2023 dhe 2022-2024, është më i lartë për arsye të kërkesës për shtim personeli me kontratë të përkohshme si dhe zbatimit të vendimit nr. 207, datë 10.03.2020 "Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe Punonjës të tjerë".<br>Megjithëse kërkesa buxhetore për vitin 2021 është për 86 punonjës, MSHMS ka miratuar 88 punonjës.<br>Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për përballimin e fluksit të urgjencave mjekësore si edhe dinamikës në rritje (për shkak të tërmetit, pandemisë) në vitet 2020-2021-2022, ka parashikuar rritje të burimeve njerëzore, numrit të punonjësve të QKUM-së i janë shtuar 10 mjekë, 20 infermierë dhe 15 shoferë sipas VKM nr.215, datë 12.03.2020 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.47, datë 22.01.2020 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*", VKM nr.234, datë 19.03.2020 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.47, datë 22.01.2020* dhe VKM nr.369, datë 06.05.2020, VKM nr.1151, datë 24.12.2020 *"Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkoshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore"* si dhe VKM nr.35, datë 19.01.2022*"Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkoshme për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore".*<br>Pra, konstatohen ndryshime të shpeshta të stafit mjekësor të cilat sjellin mangësi në kryerjen e detyrës dhe investimi që kryhet nga QKUM për përgatitjen profesionale të kësaj kategorie punonjësish, nuk është i qendrueshëm dhe ndikon në shërbimin cilësor ndaj qytetarëve. | | | afatshkurtër (aktualisht 57% e stafit) në një institucion me rëndësi jetike për qytetarët dhe pa natyrë pune me karakter sezonal, me qëllim që investimi i kryer për përgatitjen profesionale të kësaj kategorie punonjësish, të jetë i qendrueshëm dhe afatgjatë për shërbim profesional dhe cilësor ndaj qytetarëve. |
| **3** | Në pasqyrën e flukseve monetare (Cash Flow) deklarohen të hyra nga të ardhurat jotatimore në vlerën 16,542 lekë për vitin 2021, të cilat nuk janë pasqyruar në Pasqyrën e performancës financiare.<br>Në llogarinë 423,429 (Personeli, paradhenie, deficite, gjoba) e cila paraqitet në vlerën 3,529,735 për vitin 2021 dhe 78,404 për vitin 2020, si vlera të cilat duhet të arkëtohen nga punonjës të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, vlerë e cila pas konsultimeve duket e vështirë për tu arkëtuar.<br>Në llogarinë 215 (Mjete transporti), për vitin 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë, e cila paraqitet si vlerë negative nga amortizimi i akumuluar i aktivit, por nga historiku i llogarisë, ka nxjerrje jashtë përdorimi të aktivi përfundimisht dhe shuma në llogarinë e akumuluar të amortizimit që lidhet me atë aktiv kthehet | **2.4** | | QKUM, të marrë masat të bëjë korrigjimet dhe rregullimet përkatëse në pasqyrat financiare të llogarive të sipërpërmendura si dhe të bëjë të mundur arkëtimin e vlerës prej 3,529,735 për vitin 2021 dhe vlerën prej 78,404 për vitin 2020 nga punonjësit të cilët nuk janë më në marrëdhënie pune. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | mbrapsht. E njëjta gjë ndodh dhe me llogarinë 218 (Inventarë ekonomik).<br>Përsa i përket llogarisë 466 (Kreditorë në mjete në ruajtje) nuk pasqyrohet si vlerë në Pasqyrën e flukseve monetare (Cash flow).<br>Përsa i përket kreditorëve, nuk shfaqen anomali si dhe likudimi i tyre ndodh në kohë dhe sipas një rradhe të caktuar. | | | |
| **4** | Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit "Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat" 2022, gjatë verifikimit të testimit të tregut dhe ofertave të marra në treg, vihet re që formati i marrjes së ofertave është i njëjtë për të gjithë operatorët dhe nuk mund të merret oferta në treg duke u nisur vetëm nga objekti i kontratës "Shërbim GPS dhe monitorim për Autoambulancat", duke mos qenë në dijeni se në përshkrimin e mallrave përfshihen GPS për automjete, sistemi audio-video, kamera, software, PC për monitorimin të cilat kanë specifikime të veçanta teknike. Pra, nga NJ.P. nuk është për bërë përshkrim i plotë i procedurës së prokurimit përpara marrjes së ofertave. Gjithashtu, nga NJ.P., njëkohësisht grupi për llogaritjen e fondit limit të kontratës, nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë Institucioni sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".<br>Specifikimet teknike për GPS dhe kamera të vendosura nga A.K. kanë një ngjashmëri të theksuar me specifikimet e katalogut të OE fitues. Gjithashtu një pjesë e specifikimeve teknike janë të ekzagjeruara dhe nuk mund të verifikohen nga anëtarët e KVO-së dhe të atyre të marrjes në dorëzim si dhe kanë një vlerë fikse duke mos përdorur termat ekuivalente.<br>Në hartimin e specifikimeve teknike nga A.K. në një pikë citohet "Në çdo qendër spitalore kompania do të krijojë mundësinë e monitorimit të ambulancave që i përkasin çdo drejtorie" dhe nuk jepen shpjegime më të detajuara se si do të krijohet ky monitorim në çdo qendër spitalore.<br>Në hartimin e specifikimeve teknike për suportin, konstatohet se afati për implementimin e shërbimit të GPS është brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Duke u nisur nga numri i lartë i autoambulancave, i qendrave spitalore dhe vendodhjes së tyre, grupi i auditimit mendon që është e vështirë realizimi i shërbimit brenda 5 ditëve, duke e konsideruar si kriter diskriminues për O.E. të tjerë. | **2.5** | | QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllogaritet drejtë fondi limit. |
| **5** | Përsa i përket dokumentacionit për marrjen në dorëzim të GPS dhe vendosjes së tyre, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni origjinal i procesverbaleve mbi | **2.5** | | QKUM, në rastet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, përvec hartimit të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | instalimin e pajisjeve por ishin kopje të tyre si dhe këto të fundit rezultuan me korrigjime për sa i përket datës së mbajtjes së tyre. A.K. ka lidhur kontratë shërbimi nr. 193/9 dt. 11.05.2022 për 12 muaj për 347 GPS në vlerën 8,744,400 lekë pa tvsh, në të cilën nuk cilësohet afati prej 5 ditësh për implementimin e shërbimit sipas procesverbalit të hartimit të specifikimeve teknike.<br>Me qëllim verifikimin mbi funksionimin e sistemit dhe kohën e implementimit të tij, grupi i auditimit kërkoi nga A.K. t'i vihet në dispozicion sistemi i databazës për dy vitet, 2021 dhe 2022. Nga A.K. është vënë në dispozicion databaza për vitin 2022 në formatin Excel, i cili është një format mbi të cilin mund të bëhen ndryshime dhe nuk lihen gjurmë gjatë këtyre ndryshimeve, duke u konsideruar nga grupi i auditimit si një burim jo i besueshëm për të provuar funksionimin e tij. Problematika e tillë i ka fillesat që në hartimin e specifikimeve teknike dhe në lidhjen e kontratës, që për të garantuar vazhdimin e shërbimit duhej të ishte përpiluar në formën e një SLA, Marrëveshje në Nivel Shërbimi.<br>Gjatë analizimi të databazës së mësipërme vihet re që edhe pse janë mbajtur procesverbalet në data 12, 13, 14, 15 dhe 16 Maj, shërbimi me GPS për Autoambulancat ka rekorde që datojnë nga 11 Maj, O.E. fitues të ketë përdorur të njëjtët GPS të huazuar nga O.E. i mëparshëm.<br>Gjatë analizimit të databazës vihet re që ½ e autoambulancave gjatë periudhës nën shërbim nuk kanë lëvizur ose kanë rekorde lëvizjeje disa metra në muaj, ku pas intervistimit me komisionin e ndjekjes së kontratës, pjesa më e madhe shprehen se janë në servis dhe është e vështire kontrolli i tyre pasi nuk janë në pronësinë e QKUM-së, gjë që vështirëson ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe pagesat e kryera për ambulancat të cilat nuk janë në funksion, ku pagesa mujore për një autoambulancë është në vlerën 2,100 lekë pa TVSH. | | | procesverbale dhe firmosjes së tyre, të bëjnë të mundur verifikimin e detajuar të mallrave/shërbimeve nëse janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe brenda datës së kërkuar për implementimin e shërbimit në këtë rast. Gjithashtu, përsa i përket funksionimit të ambulancave duke mos krijuar hapësira për përdorim të fondeve pa 3E (efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet), për një menaxhim sa më të mirë dhe më efektiv, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të bëjnë të mundur alokimin e urgjencave mjekësore (Staf + Ambulanca) në pronësi dhe menaxhim të QKUM. |
| **6** | Bashkëlidhur kërkesës për zhvillimin e procedurës së prokurimit, nuk ka asnjë procesverbal të mbajtur, lidhur me nevojat e ambulancave për sete urgjence.<br>Për disa nga artikujt, mungojnë certifikatat e ISO 9001:2015 apo ISO 13485:2016 ose ekuivalente e prodhuesit. Konkretisht nga prodhuesi Romed mungon certifikata për artikullin fasho autoadezive, ndërsa nga Gima mungon certifikata për artikujt paketa dizifektuese dhe chlorhexidine. Gjithashtu, në certifikatat e paraqitura nga OE për produktet e prodhuesit Romed, mungon përkthimi në gjuhën shqipe të emrit të artikullit, gjë që e vështirëson identifikimin korrekt të artikullit të certifikuar. | **2.5** | | QKUM, në të ardhmen të marrë parasysh që zhvillimi i procedurave të prokurimit iniciohet fillimisht nga një nevojë që i lind institucionit e cila hartohet në mënyrë të detajuar dhe regjistrohet në regjistrin e parashikimeve ku në bazë të fondeve dhe rëndësisë që ka kjo nevojë zhvillohet nga ana e institucioni si dhe në rastin e vlerësimit të ofertave të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | tregohet kujdes që mallrat/shërbimet e ofruara nga O.E. pjesëmarrës të përkojnë me ato të kërkuara në specifikimet teknike nga ana e A.K. |
| **7** | Disa nga specifikimet teknike nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës. Konkretisht, në katalogun e paraqitur nga fituesi, nuk përcaktohet përqindja e kërkuar në specifikimet teknike të AK të artikullit klorhexidin 5%. Nuk gjenden në katalogun e paraqitur nga OE fitues artikujt piastra adulte dhe piastra pediatrike të përputhshme për defibrilatorët Primedic dhe Rescue Life. Për artikullin maska silikoni, nga AK janë kërkuar 6 përmasa të ndryshme, ndërkohë në katalog janë paraqitur vetëm 4 përmasa. Për artikullin maskë oksigjeni me rezervuar, është kërkuar nga AK me përqindje të mesme, ndërkohë në katalogun e OE fitues është paraqitur maskë silikoni me përqindje të lartë. Për artikullin mushama (telo) janë kërkuar nga AK Përmasat 200X150cm, ndërkohë në katalogun e fituesit është paraqitur mushama telo me përmasa 180X76 cm. Nga AK, për artikullin doreza sterile janë kërkuar në përmasa të ndryshme, ndërsa në katalog është paraqitur vetëm në masën S (masë e vogël). | **2.5** | | QKUM, në të ardhmen të marrë parasysh që zhvillimi i procedurave të prokurimit iniciohet fillimisht nga një nevojë që i lind institucionit e cila hartohet në mënyrë të detajuar dhe regjistrohet në regjistrin e parashikimeve ku në bazë të fondeve dhe rëndësisë që ka kjo nevojë zhvillohet nga ana e institucioni si dhe në rastin e vlerësimit të ofertave të tregohet kujdes që mallrat/shërbimet e ofruara nga O.E. pjesëmarrës të përkojnë me ato të kërkuara në specifikimet teknike nga ana e A.K. |
| **8** | Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në hartimin e specifikimeve teknike një pjesë e madhe e artikujve të ilustruara me foto ka ngjashmëri absolute me artikujt e paraqitur në katalogun e sjellë nga O.E. fitues.<br>Për artikujt të paraqitur në katalogun e OE fitues të Kompanisë Teleflex (artikujt 67-68) mungon përkthimi në gjuhën shqipe, për të cilat mungojnë certifikatat e ISO 9001:2015 apo ISO. Gjithashtu, nga prodhuesi Romed mungon certifikata për artikullin fasho autoadezive, ndërsa nga Gima mungon certifikata për artikujt paketa dizifektuese dhe chlorhexidine.<br>Disa nga specifikimet teknike nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës. Konkretisht, në katalogun e paraqitur nga fituesi, nuk përcaktohet përqindja e kërkuar në specifikimet teknike të AK të artikullit klorhexidin 5%. Nuk gjenden në katalogun e paraqitur nga OE fitues artikujt piastra adulte dhe piastra pediatrike të përputhshme për defibrilatorët Primedic dhe Rescue Life. Për artikullin maska silikoni, nga AK janë kërkuar 6 përmasa të ndryshme, ndërkohë në katalog janë paraqitur vetëm 4 përmasa. Për artikullin maskë oksigjeni me rezervuar, është kërkuar nga AK me përqindje të mesme, ndërkohë në katalogun e OE fitues është paraqitur | **2.5** | | QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke krijuar hapësirë për zhvillimin e një gare të ndershme dhe konkurruese. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | maskë silikoni me përqindje të lartë. Për artikullin mushama (telo) janë kërkuar nga AK Përmasat 200X150cm, ndërkohë në katalogun e fituesit është paraqitur mushama telo me përmasa 180X76 cm. Nga AK, për artikullin doreza sterile janë kërkuar në përmasa të ndryshme, ndërsa në katalog është paraqitur vetëm në masën S (masë e vogël). | | | |
| **9** | Në kërkesat për kualifikim "Specifikimet teknike" për pajisjet mjekësore, konkretisht pika II.5 dhe II.6 për manekin PCR infant/perdiatrik dhe ventilator për autoambulanca rezulton se ka një ngjashmëri absolute midis specifikimeve teknike të pajisjeve mjekësore të hartuara nga A.K., me specifikimet teknike të katalogut të sjellë nga Operatori Ekonomik fitues.<br>**Në pikën 2.2** nga AK kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3(tre) viteve të fundit, ku vlera e xhiros mesatare vjetore për tre vitet e fundit duhet **të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit** të kontratës që po prokurohet në mospërputhje me shkronjën c[1] të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>**Në pikën 2.3.** nga AK kërkohet kërkohet që OE të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë ***sa 20%*** të vlerës së përllogaritur të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit në mospërputhje me shkronjën b[2] të pikës 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. | **2.5** | | QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke krijuar hapësirë për zhvillimin e një gare të ndershme dhe konkurruese. |
| **10** | Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës për procedurën e prokurimit "blerje pajisjes mjekësore" konstatohet se:<br>Për disa nga pajisjet mjekësore, disa nga specifikimet teknike të karrocës me katër rrota me zinxhir dhe fluksometrit nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës. | **2.5** | | QKUM, në rastet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, përvec hartimit të procesverbale dhe firmosjes së tyre, të bëjnë të mundur verifikimin e detajuar të mallrave/shërbimeve nëse janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. |
| **11** | Është e pamundur që të studiohet tregu dhe të jepen oferta nga specifikimet teknike të hartuara nga A.K., pa të dhëna kryesore si nr., sasi, m2 etj... si më poshtë (me bold):<br>**Plintusa metalik për rrëshkitje 1**<br>**Mirëmbajtje dhe riparim i pompës thithëse 1** | **2.5** | | QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse, në përputhje me volumin e kontratës dhe të detajuara |

[1] vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës** së parashikuar të kontratës. Ky kriter i cili barazon vlerën e xhiros vjetore me vlerën e fondit limtit ul pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

[2] vlera totatle e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Piston për derën kryesore me presion vaji 1**<br>Suvatim, mermetim muresh 250 m2<br>Lyerje tavani kartonxhes 210 m2<br>Lyerje e murit të brendshëm 1850 m2<br>Pastrim i fasadës së ventiluar 900m2<br>Pastrim troutari dhe parkimit 345 m2<br>Patinim muresh 100m2<br>**Vijat e verdha të parkimit 1**<br><br>Realizimi i punimeve të mësipërme për afatin 5 ditor është e pamundur të realizohet me 5 punëtore të kërkuara në kriteret e veçanta që duhet të përmbushë O.E. sipas A.K.<br>Procesverbali i kryerjes së punimeve nuk është shoqëruar me foto që të tregohen qartë realizimi i zërave të mësipërm. | | | në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllogaritet drejtë fondi limit dhe ofertat e dhëna si dhe të dokumentohet i gjithë zbatimi i kontratës. |
| **12** | QKUM nuk ka zhvilluar ende një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv.<br>Në Rregulloren e brendshme të QKUM, nuk është përcaktuar në formë eksplicite mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal brenda strukturave.<br>Sistemi i IT i QKUM aktualisht nuk është pajisur me një procedurë të përshtatshme rezervë (back-up) nga ku të mundësojë gjithashtu ri-përfitimin e të dhënave në rastin e një aksidenti në sistem ose ndaj rrezikut të një sulmi kibernetik. | **2.6** | | QKUM, të marrë masat që të plotësojë rregulloren e brendshme me mënyrat e komunikimit dhe të informimit të informacionit, sipas niveleve të hierarkisë së institucionit. |
| **13** | Nga ofertat e sjella nga O.E. garues, oferta e sjellë nga O.E. “A.” sh.p.k., prej 1,199,960 lekë pa tvsh, u shpall ofertë anomalisht e ulët dhe me anë të kërkesës nr. 26.05.2021 nga K.V.O, u kërkuar sqarim për çmimet dhe koston e propozuar në ofertë. O.E. “A.” sh.p.k. me anë të shkresës nr. 2905 Prot., datë 29.05.2021 ka paraqitur shpjegimin përkatës me të gjithë dokumentacionin e plotë mbi arsyet e dhënies së ofertës.<br>Nga ana e K.V.O. nuk ka dokumentacion në lidhje me analizimin e shkresës së sjellë nga O.E..<br>Pas analizimeve të dokumentacionit të sjellë nga O.E. i mësipërm, grupi i auditimit mendon që oferta e sjellë nga O.E. duhej të ishte marrë për bazë pas shpjegimit të saj dhe O.E. i mësipërm duhej të ishte shpallur fitues. Nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, vlera prej **420,210 lekë pa tvsh**, si diferencë midis O.E. fitues dhe këtij të fundit që duhej të ishte shpallur fitues, është përdorur pa 3E.<br>Gjatë analizimit mbi mënyrën e likuidimit dhe zbatimit të kontratës vihet re që vlera e kontratës është likuiduar nga dy pagesa, ku pagesa e fundit mban datën 28.10.2021, që nënkupton që për periudhën e mbetur deri në 06.07.2022 mbetet e pa mbuluar me shërbim.<br>Kjo vjen për arsye se mënyra e likuidimit dhe procesverbaleve duhej të ishte hartuar sipas specifikimeve teknike të kërkuar në | **2.5** | | QKUM, në të ardhmen në përllogaritjen e fondit limit të përdorin mënyrën më efektive të mundshme, si dhe në rastin kur merren oferta në treg nga O.E., të merren nga O.E. të cilët kanë eksperiencë në treg, në mënyrë që të shmangen aludimet mbi fryrjen e fondit limit si dhe në rastin e vlerësimit të ofertave të kryhet vlerësim i drejtë dhe transparent duke u bazuar në bazën ligjore dhe udhëzimet përkatëse si dhe duke i dhënë gjithmonë përparësi ofertave më të ulëta në rast se përmbushin dokumentacionin e plotë të kërkuar dhe në rastin kur oferta është anomalisht e ulët si më sipër, të vlerësohet me kujdes |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | fillim, të cilat nuk janë cituar në kontratat respektive, si më poshtë:<br>Kryerja e shërbimit dhe mirëmbajtjes profilaktike për pastrimin, larjen e filtrave të kondicionerëve dhe serpentinave të fankoilave çdo tre muaj. Kontrolli i presionit të gazit dhe mbushja me gaz sipas nivelit të kërkuar, do të jetë sipas nevojave<br>Kontrolli i chillerave dhe sistemit të tyre, shërbimet e mirëmbajtjes preventive të tyre janë parashikuar një herë në katër muaj.<br>Hapja e chillerave, pastrim me solucion, pastrim i filtrit të ujit dhe të gazit, kontroll i presionit të gazit çdo 4 muaj. | | | arsyetimi mbi dhënien e një oferte të tillë. |
| **14** | Në hartimin e Specifikimeve Teknike nuk janë detajuar zërat të cilët do të mbulohen nga siguracioni (ndërtesa, instalime teknike e makineri, inventari ekonomik), si minimum për përcaktimin e vlerës që mbulon çdo kategori si dhe dhënien e ofertave nga O.E. të interesuar.<br>Oferta e sjellë nga O.E. fitues është në shumën 4,427,000 lekë pa tvsh, shumë e cila ndryshon nga oferta e sjellë nga i njëjti O.E. në shumën 4,380,000 lekë pa tvsh gjatë përllogaritjes së fondit limit, me diferencë prej 47,000 lekë pa tvsh, duke mos dhënë arsyet përkatëse, gjë që fakton dhe gjetjen cituar nga grupi i auditimit mbi atë se çfarë përfshihet në kategoritë ndërtesa, zyra dhe pajisje mjekësore.<br>Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit se çfarë mbulojnë kategoritë (ndërtesa, instalime teknike e makineri, inventari ekonomik) rezultoi që në kategorinë instalime teknike e makineri që përkon me llogarinë 214 në pasqyrat financiare përfshihen software (program financiar; sistem virtualizimi; sistem operimi për server; firewall; software për back up; software për database; software për sistem kartografis; software aplikativ për urgjencë; instrumente përkthimi, konfigurimi, trajnimi; software për raport statistika; realizimi i faqe web) të cilat janë programe që në kategorinë e rrezikut nuk mbulohen nga siguracioni, gjë që konstatohet edhe në policen e sigurimit të operatorit fitues nr. serial 220904668 datë 06.04.2022. Vlera e software që është përfshirë në kategorinë pajisje mjekësore është në vlerën 102,934,464 lekë, ndërkohë vlera e sigurimit të saj është **1,235,213 lekë** (102,934,464 lekë X 0.012), që përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit. | **2.5** | | QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke krijuar hapësirë për zhvillimin e një gare të ndershme dhe konkurruese QKUM, si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllogaritet drejtë fondi limit dhe ofertat e dhëna, ku duke u nisur nga kjo i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm në vlerën prej **1,235,213 lekë** dhe të bëhet e mundur alokimi i kësaj shume. |
| **15** | Gjatë zhvillimit të Procedurës së Prokurimit me objekt "Mirëmbajtje objekti ndërtimor viti 2022". Për sa i përket kryerjes së shërbimit është kryer në datën 19.12.2022, ndërkohë që shpallja fitues e O.E. është bërë me datë 09.12.2022. Sipas specifikimeve teknike dhe kritereve të | **2.6** | | QKUM, të bëjë të mundur llogaritjen dhe alokimin e penalitetit sipas kushteve të kontratës mbi ditët jashtë afatit të lëvrimit të mallit dhe në të ardhmen të kryejë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | veçanta lëvrimi i mallit duhej bërë brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (njoftimi i fituesit).<br>Procesverbali i mbajtur mbi realizimin e shërbimit nuk është i shoqëruar me foto që të dokumentohet procesi dhe realizimi i plotë i shërbimit.<br>Realizimi për 5 ditë i zërave të mësipërm dhe me dy punonjës është i pamundur. | | | lëvrimin e mallit/shërbimit sipas kushteve të kontratës. |
| **16** | Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se një pjesë e madhe e specifikimeve të uniformave janë tejet të detajuara, duke cituar një sërë variablash të cilat janë të ekzagjeruara për funksionin që do të kryejnë uniformat, të paargumentuara si dhe të vështira në momentin e vlerësimit nga Komisioni i vlerësimit të Ofertave dhe Grupi i marrjes në dorëzim.<br>Gjithashtu gjatë hulumtive në internet dhe në treg mbi produktet me të njëjtat karakteristika, vihet re që cmimet e ofruara gjatë testimit të tregut janë të fryra, të ilustruara me foto. | **2.5** | | QKUM, në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. |
| **17** | Ngjyra e uniformave nuk korrespondon me ngjyrën e caktuar në Specifikimet Teknike me kod HV EN 20471, ku pas verifikimit nga grupi i auditimit dhe mostrat e sjella, ngjyra është në portokalli dhe jo e kuqe sipas kodit. I njëjti kod ngjyre është dhe për këpucët të cila nga mostrat e sjellë kanë një ngjyrë tjetër nga uniformat (Lejla) dhe përsëri jo të kuq sipas kodit.<br>Gjatë verifikimit të mostrave të sjellë për produktin "Këpucë", viti i prodhimit të tyre të shënuar ishte viti 2020, ndërkohë që procedura e prokurimit është realizuar në vitin 2021 ndërkohë ato supozohet që të prodhohen sipas specifikimet teknike dhe ekzistenca e tyre (viti 2020), përbën fakt për paracaktimin e O.E. fitues.<br>Nga dokumentacioni rezulton një deklaratë e datës 20.09.2021 nga OE "U. P." sh.p.k për dorëzim malli. Nga grupi i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbal në datë 20.09.2021, pa nr. protokolli, gjithashtu dhe për vitin 2022.<br>QKUM, nuk ka përmbushur misionin e tij mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve ashtu sic i ka kërkuar në specifikimet teknike, kryesisht ngjyrën dhe cilësinë, ku i gjithë fondi në total prej **63,250,000 lekë** pa tvsh (11,350,000 këpucët + 51,900,000 uniformat), përbën fond të përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet. | **2.5** | | QKUM, të marrë masat për ngritjen e një grupi të posacëm për ndjekjen dhe zëvendësimin e produkteve të marra në mospërputhje me specifikimet teknike të kërkuara me ato që duhet të ishin dorëzuar nga O.E. fitues. |
| **18** | Copëzim i fondeve në 2 raste, në vitin 2022, duke shmangur procedurën e prokurimit, si më poshtë: | **2.5** | | QKUM, të marrë të gjitha masat që në hartimin e regjistrit të prokurimeve të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 1. Shërbim telefonik EI PRI ISDN - me vlerë 985.000 lekë pa tvsh.<br>2. Shërbim interneti 2023 - me vlerë 470.000 lekë pa tvsh.<br>Sa më sipër, shërbimi i ngjashëm “Shërbim telefonie dhe interneti”, me të njëjtin operator ekonomik “A.”. Të dy procedurat së bashku rezultojnë në vlerën 1.455.000 Lekë pa TVSH, që tejkalojnë me 455.000 Lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Me tejkalimin e pragut të prokurimit në vlerë të vogël, QKUM duhet të kalojë në procedurën e kufijve të ulët monetar prokurimit.<br>Materialet e sipërcituara janë pjesë e linjave teknologjike në ushtrimin e veprimtarisë.<br>Për arsyen e mësipërme procedurat e sipërcituara të prokurimit konsiderohen tejkalim i pragut të prokurimit në vlerë të vogël dhe QKUM duhej të kalonte në procedurën kufijve të ulët monetar të prokurimit, me qëllim ruajtjen e konkurrencës në prokurim. | | | parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike. |

## Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, në përgjithësi ka zbatuar kuadrin rregullator, por janë konstatuar edhe shmangie të cilat kanë ndikuar në performancën financiare të shoqërisë. Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit specifikimet teknike janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës dhe si dhe zbatimi dhe ndjekja e kontratës nuk kryhet si duhet nga grupet e marrrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratave.
Në hartimin e kërkesave buxhetore janë konstatuar se QUKM, ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës. Gjithashtu QKUM nuk përmbush misionin e tij të plotë përsa kohë Ambulancat dhe Stafi mbështetës nuk janë në varësi të tyre, duke pasur rolin e vetëm të monitoruesit.

## Opinioni i Auditimit

***I. Opinion për auditimin e përputhshmërisë:***

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të QKUM, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.
*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Qendrës Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë.”*

***II. Baza për opinionin e përputhshmërinë.***

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit "Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore" në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" , ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet ISSAI-P1, "Deklarata e Limës"; ISSAI P-10, "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI P-12, ISSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga QKUM dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, në besojmë së dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Gjithashtu shoqëria ka përdorur pa Ekonomicitet, Eficence dhe Efektivitet Fondet Publike në shumën **65,125,210** lekë pa TVSH.

Gjatë realizimit të procedurave të auditimit janë konstatuar veprime me dëm ekonomik me vlerë **1,235,213** lekë pa TVSH.

***III. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:***

Menaxhimi i QKUM-së. është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e buxhetit dhe të pasqyrave të llogaridhënies vjetore në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm efektiv, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

***IV. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:***

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë *siguri të arsyeshme*, që veprimtaria e QKUM-së., në të gjitha aspektet, është pa gabime dhe anomali materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), Objektivi ynë lidhet me *dhënien e sigurisë së arsyeshme* mbi përputhshmërinë e aktivitetit të QKUM-së, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe efecient të burimeve financiare e administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Për këtë audituesit e KLSH, aplikojnë gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese nëpërmjet të cilës, audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme që trajtohen në Projekt Raportin e auditimit.

# I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e KLSH"*, në zbatim të projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së nr.1200/1 Prot., datë 17.01.2023, për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021 si dhe zhvillimin e auditimit "Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë" nga data 16.01.2023 deri më datë 16.03.2023 në subjektin Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore. ( Këtu e tutje QKUM).

**Titulli:** Raport Përfundimtar auditimi "Mbi përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë" në QKUM për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021.
Raporti Përfundimtar i auditimit është i strukturuar në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve, etj. Në vijim është përshkrimi i auditimit, në të cilin trajtohet një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit. Në kreun e tretë jepet konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit, bazuar në rezultatet e auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuara sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt. Raporti Përfundimtar ka në kreun e pestë anekse dhe mbyllet me kreun VI-Lista e dokumenteve të auditimit.

**Marrësi:** Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, z. S. B. me detyrë Administrator.

**Objektivat dhe qëllimi**: Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse QKUM në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.
Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie dhe rregullshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.
Auditimi i përputhshmërisë dhe i rregullshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë *(sipas ISSAI 400, p 18).*
Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e proceseve dhe aktiviteteve të institucionit.

**Identifikimi i çështjes:** Raporti Përfundimtar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të QKUM-së për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:
Rregullshmëria e shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative për automjetet, udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).
Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen e zbatimin e kontratave.
**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:** Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për

garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.
Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.
Strukturat drejtuese, duhet të orientojnë strukturat e institucionit, për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.

**Përgjegjësitë e audituesve**: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikes me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

**Kriteret e vlerësimit:** Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:
Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH.
Ligji nr. 147/2014 "Për shërbimin e Urgjencës Mjekësore".
Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar;
Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";
Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve";
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar" me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020.
Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", i ndryshuar;
Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;
Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë".
Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar;
Ligji nr. 9106, datë 17.07.2003, "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë";
VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar;
VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar;
Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik";
VKM nr.933 datë 29.12.2014 "Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore", e ndryshuar.

**Standardet e auditimit:** Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti Përfundimtar i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme;
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

**Metodat e auditimit:** Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e QKUM-së., kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

**Dokumentimi i auditimit:** Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

# II.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### II.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore është një sistem i bashkërenduar i burimeve njerëzore, i infrastrukturës dhe i pajisjeve mjekësore, përmes të cilave mundësohet ndihmë dhe kujdes mjekësor i shpejtë dhe i sigurt për personat që pësojnë përkeqësim të menjëhershëm të gjendjes shëndetësore, dëmtime apo sëmundje të papritura. Gjithashtu subjekti në misionin e tij merret dhe me punën bashkërenduese të të gjithë urgjencave mjekësore të lokalizuara në pika të ndryshme në Shqipëri.

### II.2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

**II.2.1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimi i tyre.**

**II.2.2 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore**

Në zbatim të **Pikës 1** të Programit të Auditimit "Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, bazueshmërinë` ligjore të vendimeve të marra dhe realizimi i tyre" dhe **Pikës 2** "Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore" nuk u konstatuan shkelje pasi rekrutimi në punë për punonjësit bëhet me anë të APP dhe për infermierët behët me anë të portalit. Në sondazhin e kryer në dosjet e personelit nuk u gjendën anomali dhe mungesa dokumentacioni.

**II.2.3 Mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit si dhe shpenzimet administrative**

Në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e buxhetit si dhe shpenzimet administrative, sipas ligjeve dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet vjetore "Për buxhetin e shtetit" të vitit 2021 dhe 2022, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Rregullorja e brendshme e institucionit.
-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.
-Dokumentacioni i PBA-ve të miratuara gjatë periudhës objekt auditimi.
-Buxheti i miratuar dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit.
-Realizimi i shpenzimeve me planifikimet.
-Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:***

***A. Projekt Buxheti***
-Kërkesa buxhetore sipas **PBA 2021-2023**, në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 28.02.2012 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm" Urgjenca Kombëtare me shkresën nr. 391/2 prot, datë 07.07.2020, nr. 391/3 prot, datë 07.07.2020, nr. 391/4 prot, datë 07.07.2020 ka dërguar në Drejtorinë e Financave në MSH Pasqyrat e PBA 2021-2023 së bashku me relacionin përkatës dhe Formularët e Projekt Investimeve 2021-2023, hartuar nga Komisioni i Hartimit të PBA, ngritur me Urdhër të Drejtorit nr.149, datë 24.06.2020, prot 391 Planifikimi i fondeve sipas PBA 2021-2023.
-Kërkesa buxhetore sipas **PBA 2022-2024**, në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit

buxhetor afatmesëm", si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.10, datë 28.02.2017 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023", Urgjenca Kombëtare me shkresën nr. 350/3prot, datë 06.07.2021, nr. 350/4 prot , datë 06.07.2021, 350/6 prot, datë 06.07.2021 etj, ka dërguar në Drejtorinë e Financave në MSH Pasqyrat e PBA 2022-2024 së bashku me relacionin përkatës dhe Formularët e Projekt Investimeve, hartuar nga Komisioni i Hartimit të PBA 2022-2024.

Planifikimi i fondeve sipas PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024; në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Kërkesa buxhetore sipas PBA *(në mijë lekë)*

| Emërtimi | Kërkesa PBA 2022-2024 | Kërkesa PBA 2021-2023 |
|---|---|---|
| -Paga | 144,554 | 85,240 |
| -Sigurime shoqërore & shëndetësore | 24,137 | 14,277 |
| -Shërbime | 248,654 | 222,600 |
| **Shp. Operative (A)** | **417,345** | **322,117** |
| -Investime | 686,865 | 925,047 |
| **Shpenzime kapitale (B)** | **686,865** | **925,047** |
| **II. Total shpenzime (A)+(B)** | **1,104,210** | **1,267,164** |
| **Numri punonjësve** | **135** | **86** |

*Burimi: QUKM*

Parashikimi i *"**shpenzimeve për personelin**"* përfshin pagat bruto për punonjësit e përhershëm dhe të përkohshëm, (punonjësit e përkohshëm, janë kërkuar personel mjekësor shtesë për shkak të pandemisë), shtesat mujore mbi pagë si orët për turnet e dyta dhe të treta. Përveç shpenzimeve për paga, parashikohen edhe shpenzimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat janë planifikuar në masën 16.7% të nivelit të bazës së pagës bruto.

Punonjësit e përhershëm i përkasin strukturës së QKUM pra 86 punonjës (punonjësit e përkohshëm janë kërkuar për shtesë 49 punonjës (personel mjekësor për shkak të pandemisë mjekë, infermierë, dhe shoferë),

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për përballimin e fluksit të urgjencave mjekësore si dhe dinamikës në rritje (për shkak të tërmetit, pandemisë) në Vitet 2020-2021-2022 ka parashikuar rritje të burimeve njerëzore, numrit të punonjësve të QKUM-së i janë shtuar 10 mjekë, 20 infermierë dhe 15 shoferë me VKM nr.215, datë 12.03.2020 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.47, datë 22.01.2020 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*", VKM nr.234, datë 19.03.2020 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.47, datë 22.01.2020 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në Njësitë e Qeverisjes Qendrore" të ndryshuar* dhe VKM nr.369, datë 06.05.2020 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.47, datë 22.01.2020 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në Njësitë e Qeverisjes Qendrore", të ndryshuar,* VKM nr. 700, datë 09.09.2020 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.47, datë 22.01.2020 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në Njësitë e Qeverisjes Qendrore"* të ndryshuar.

Me VKM nr.1151, datë 24.12.2020 *"Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkoshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore"* si dhe VKM nr.35, datë 19.01.2022 *"Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkoshme për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore".*

Parashikimi i shpenzimeve për paga sipas tabelës së mësipërme ka ndryshim të fondit të pagave në PBA e viteve 2021-2023 dhe 2022-2024, është më i lartë për arsye të kërkesës për shtim personeli me kontratë të përkohshme si dhe zbatimit të vendimit nr. 207, datë 10.03.2020 “Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe Punonjës të tjerë”.
Parashikimi i shpenzimeve “***për mallra dhe shërbime***”, përfshin:
-zërin “*materiale dhe shërbime të përgjithshme*” ku parashikohen shpenzime për kancelari, materiale pastrimi, blerje dokumentacioni, blerje detergjentë, etj. Shërbime speciale janë parashikuar blerje tonera materiale të ndryshme, hidraulike, vegla pune, materiale promocioni, e aksesorë. Po kështu, përfshihen parashikimet për blerje uniforma e këpucë, dhe materiale mjekësore.
-zërin *“shërbime”* për shërbimet që realizohen nga të tretët si energji elektrike, shpenzim për ngrohje, posta, telefon, etj.
-zërin “*shpenzime transporti*” janë parashikuar shpenzime për blerje karburanti për gjeneratorin dhe për mjetet e transportit, pjesë këmbimi të mjeteve të transportit, siguracione të mjeteve të transportit.
-zërin “*udhëtime dhe dieta*” janë parashikuar shpenzimet për dieta brenda dhe jashtë vendit.
-zërin “*shërbime të sigurimit dhe ruajtjes*” janë parashikuar për ruajtjen me roje private të godinës së QKUM-së, përkatësisht me 2 vendroje 16&24 orëshe, kjo për të minimizuar riskun e sigurisë së godinës ku punohet 24 orë në 7 ditë të javës.
-zërin “*të tjera shërbime*” është parashikuar shërbimi me GPS për monitorimin e autoambulancave.
-zërin “*shpenzime për mirëmbajtje*” janë parashikuar mirëmbajtjet e mjeteve të transportit, mirëmbajtje ndërtese, mirëmbajtje e pajisjeve teknologjike, pajisjeve të zyrave, etj.
-Zërin për “*shpenzime detyrime dhe kompensime*”, janë parashikuar shpenzime gjyqësore sepse QKUM është në proces gjyqësor me dy operatorë, për të cilët nuk ka ende vendim të formës së prerë (vendim Gj.Apelit).
-Shpenzime “*të tjera operative*” janë parashikuar shpenzimet për pagesën e taksave vendore, honorare për bashkëpunëtor të jashtëm, (rastet e trajnerëve ose specialist fushe të jashtëm që marrin pjesë në procedura të ndryshme në QKUM).
-zërin “*shpenzime per sigurimin e ndertesës*” është parashikimi i siguracionit 1(një) vjeçar të ndërtesës.
-zërin “*të tjera materiale dhe shërbime*” është vendosur për të parashikuar shpenzime të ndryshme maksiemergjence (përmbytje, tërmete, pandemi, etj).

<u>Në planifikimin e shpenzimeve janë parashikuar zërat</u>:
-Shpenzime për anëtarët e Parlamentit në shumën 960 mijë lekë.
-Shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna” në shumën 900 mijë lekë.
-Pajisje për përdorim policor në shumën 960 mijë lekë.
-Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulike në shumën 2,700 mijë lekë.
-Shpenzime për mirëmbajtjen e rezervës shtetërore në shumën 960 mijë lekë.
-Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore në shumën 1,500 mijë lekë.
-Shpenzime gjyqësore në shumën 960 mijë lekë.
QUKM, ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës, në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 neni 29 dhe ligjin 137/2020 “Për Buxhetin e vitit 2021” dhe udhëzimin nr.4, datë 25.01.2021.
(*Sipas tabeles nr.1 bashkëlidhur*)

Burimi i të ardhurave për funksionimin e institucionit është buxheti i shtetit.
Gjatë hartimit të projekt buxhetit janë marrë parasysh objektivat e QKUM-së, kërkesa buxhetore në PBA 2022-2024 krahasuar me PBA 2021-2023, është rritur në shumën 143,207 mijë lekë.

**B. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.**

***Viti 2021***

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzuese është bërë mbështetur në ligjin nr. 137/2020 "*Për buxhetin e vitit 2021*", UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit*", UMF nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit*", SHMF nr.23724/85, datë 18.01.2020 "*Pasqyra e planit buxhetor për vitin 2021*", SHMSHMS nr.320/1, datë 20.01.2021 "Plani buxhetor për vitin 2021".

| Emërtimi | Kërkesa PBA 2021-2023 | Plani fillestar | Plani rishikuar Maj Investimet | Plani rishikuar Qershor | Plani rishikuar Tetor | Plani rishikuar Dhjetor/ Investime | Plani rishikuar Dhjetor | Ndryshimi (Plani Rishikuar / Plani Fillestarne total | Ndryshimi (Plani Rishikuar/ Kërkesë Buxhetore) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzime (A)+(B)** | **1.247.417** | **343.500** | **+9000** | **0** | **-300** | | **-19150** | **-10.450** | **333.050** |
| Paga | 85.493 | 85.215 | +8.000 | +16.000 | +37.000 | | | | 146.215 |
| Sigurime | 14.277 | 14.231 | +1.000 | +4.000 | +3.500 | | | | 22.731 |
| Shërbime | 222.600 | 228.654 | | -20.000 | -40.500 | | -18.150 | | 150.004 |
| Transferta | 400 | 400 | | | -300 | | | | 100 |
| **Total Shp. Operative (A)** | **322.370** | **328.500** | **+9000** | **0** | **-300** | | **-18150** | **-9.450** | **319.050** |
| **Shpenzime kapitale Total (B)** | **925.047** | **15.000** | **0** | | | **600** | **608** | **-1.000** | **14.000** |
| Numri punonjësve total | **110** | **88** | | | | | | **+49** | **137** |
| -Me kontrate te përhershme | **86** | **88** | | | | | | **0** | **88** |
| -Me kohe te pjesshme | **24** | | | | | | | **+25** | **49** |

Fondet e alokuara në raport me fondet e kerkuara janë:
Për (Art. 600) Fondet e kerkuara janë 85,493 mijë lekë fondet e alokuara ne fillim të vitit janë 85,215 mijë lekë, pra 100% .
Për (Art. 601) Fondet e kërkuara janë 14,277 mijë lekë, fondet e alokuara ishin 14,231 mijë lekë - 100%.
Për (Art 602) Fondet e kërkuara janë 222.600 mijë lekë dhe fondet e alokuara janë 228.654 mijë lekë, pra 100% .
Për (Art 231) Fondet e kërkuara 925,047 mijë lekë ndërsa fondet e alokuara 15,000 mijë lekë, rreth 1.6% .
Me shkresën nr.320/1, datë 20.01.2021 "Plani buxhetor për vitin 2021", MSHMS ka dërguar buxhetin e vitit 2021 në limite vjetore dhe mujore në shumën vjetore 328,100 mijë lekë dhe numrin e punonjësve gjithësej 88 punonjës. Plani investimeve me shkresën nr. 142/3, dt 02.02.2021 në vlerën 15,000 mijë lekë. Plani fillestar ka ndryshuar me shkresat e MSH:
- nr. 500/3 dt 15.02.2021 dt 02.02.2021 duke shtuar shpenzimet për paga në shumën 8.000 mijë lekë dhe 1.000 mijë sigurime shoqërore, për rritjen e pagave në zbatim të VKM nr.1076, dt 24.12.2020.

- nr.2385 dt.14.06.2021 duke pakësuar shpenzimet operative me -20.000 mije lekë dhe shtuar shpenzimet për paga +16.000 mijë lekë dhe sigurime shoqërore +4.000 mijë leke, për shkak të kalimit të fondit nga "shpenzime operative" në "shpenzime për paga" në zbatim të VKM nr. 1151, datë 24.12.2020 " Për punonjësit me kontrate të përkohshme".
Me shkresën nr.17140/1, dt 26.10.2021 pakësohet Shpenzimet operative per vleren 40.500 mije leke dhe shtohen shpenzimet per paga 37.000 mije leke dhe sigurime shoqerore 3.500 mije lekë në zbatim të VKM nr. 207, datë 20.03.2020" "shpërblim personeli mjekësor dhe mbështetës", dhe vkm nr 1151,dt 24.12.2020 " Për punonjësit me kontrate të përkohshme".
Me shkresën nr.1438, datë 11.05.2021 ka ndryshuar zëri "investime" përkatësisht në programet "Fv Paisje teknologjike Buck up" i cili pakësohet ne vleren -10.000 mije lekë dhe shtohet projekt preventiv në vlerën +3.000 mije lekë dhe 7.000 mije lekë paisje mjekësore.
Me shkresën nr.4656/2, datë 01.12.2021 ndryshuar në programin "blerje paisje mjekesore ne programin tvsh e pajisjeve mjekesore" ne vlerën 992 mijë lekë.
Pakësohet në programin e "back up" vlera -1,600 mije lekë dhe shtohet +600 mijë lekë ne programin "pajisje mjekësore".
Ndryshimet në investime sipas programeve të cituara më sipër janë kryer për shkak të anulimit të investimit të "Fv Pajisje teknologjike Buck up" dhe përdorimit të fondeve për nevoja të tjera të QKUM-së, "Blerja e paisjeve Mjekësore"
Fondi i alokuar "Projekt preventiv zbatimi për krijimin e një godine të re për realizimin e back up" prej 1,400 mijë lekë nuk është përdorur , pasi nuk është miratuar nga MSHMS.

Pra, nga krahasimi i kërkesës buxhetore 2021-2023 dhe buxhetit të miratuar për QUKM, rezulton se plani i rishikuar ka pësuar ulje prej -10,450 mije lekë, kundrejt planit fillestar të vitit 2021, (343,500 mijë - 333,050)
Realizimi i buxhetit për Vitin 2021 i rakorduar me Degën e Thesarit rezulton si më poshtë:
Art .600 ( Paga) 134.670.725 lekë -92%
Art .601 ( Sigurime shoqërore 17,499,223 lekë -77%
Art. 602( Shpenzime operative) 129,036,223 lekë -86%
Art. 231 (Shpenzime kapitale) 11,618,236 lekë - 83%
Fondi për sigurimet shoqërore, rezulton i parealizuar (77%) por nuk eshtë real për shkak sepse në fondin e pagave janë përfshire edhe fondet e shpërblimit për personelin mjekësor dhe mbështetës, në zbatim të VKM nr.207, datë 20.03.2020.
Realizimi në total i buxhetit të QKUM është në masën 88%.
Disa nga zërat nuk janë realizuar për shkak të gjendjes së pandemisë, pasi janë rivlerësuar si procedura të panevojshme.

Buxheti i akorduar nga MSH për vitin 2021 në shumën 333,050 mijë lekë rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit, Tiranë, plani në vlerën 333,050 mijë lekë dhe Fakti 289,775 mijë lekë.
***Për QUKM kërkesa buxhetore për Investimet për Vitin 2021-2023 është 925,047 mije lekë dhe alokimi i fondeve është 15,000 mijë pra 1.6% e fondit të kërkuar.***

***Viti 2022***
Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësise shpenzuese është bërë mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit", Ligjit 115/2021 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2022" UMF nr. 1, datë 10.01.2022 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022*".

| Emërtimi | Kërkesa PBA 2022-2024 | Plani fillestar i miratuar janar 2022 | Plani rishikuar prill 2022 | Plani rishikuar korrik 2022 | Plani rishikuar dhjetor 2022 | Ndryshimi Plani rishikuar/ Planit Fillestar | Ndryshimi Plani rishikuar / Kërkesë Buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzime (A)+(B)** | **1.104.330** | **334.462** | **-24.002** | **-85** | **-68.680** | **-92.767** | **241.695** |
| Paga | 144.654 | 110.410 | -2.760. | | | | 107.650 |
| Sigurime | 24.157 | 15.098 | -377 | 3.500 | | | 18.221 |
| Shpenzime operative | 248.654 | 208.654 | -20.865 | -3.500 | -70.000 | | 114.289 |
| Transferta (606) F .Vecante | | 300 | | -85 | +1.320 | | 1.535 |
| **Shp.Operative (A)** | **417.465** | **334.462** | **-24.002** | **-85** | **-68.680** | **-92.767** | **241.695** |
| **Shpenzime kapitale (B)** | **686.865** | | | | | | |
| **Nr. punonjesve total** | **137** | | | | | | |
| **Nr.punonjes perhershem** | **88** | | | | | | |
| **Nr.punonjesish kontrate te perkohshme** | **49** | | | | | | |

Për Vitin 2022, Fondet e alokuara krahasuar me fondet e kërkuara janë si më poshtë:
Për (Art. 600) Fondet e kërkuara janë 144,654 mijë lekë fondet e alokuara ne fillim të vitit ishin 110.410 mijë lekë, pra 76% .
Për ( Art. 601) Fondet e kërkuara janë 24,157 mijë lekë, fondet e alokuara janë 15,098 mijë lekë - 62 %.
Për (Art 602) Fondet e kërkuara ishin 248,654 mijë lekë dhe fondet e alokuara janë 208,654 mijë lekë, pra 84% .
Për (Art 606) Fondi i Veçante fondet e alokuara ishin 400 mijë lekë.
Për (Art 231) Fondet e kërkuara 686,865 mijë lekë por nuk janë alokuar nga MSHMS fonde për Investime.
MSHMS me shkresën nr.5256/4, datë 11.01.2022 ka dërguar plan buxhetin e vitit 2022 në limit vjetor dhe mujor në shumën vjetore 334,462 mijë lekë dhe nr i punonjësve 88 per punonjesit e perhershem sipas struktures dhe 49 punonjes me kontrate te perkohshme.
Plani fillestar ka ndryshuar me shkresat e MSHMS1333/4, datë 06.04.2022 duke pakësuar shpenzimet operative në shumën -20.865 mijë lekë, shpenzime për paga -2.760mije lekë dhe shpenzimet për sigurime shoqërore në shumën -377 mije lekë, rishikim i planit buxhetor.
Me shkresën e MSHMS nr. 12815/1, datë 05.07.2022 është dërguar shtesë fondi për shpenzime për sigurime shoqërore në shumën +3.500 mije lekë, duke pakësuar shpenzimet operative në shumën -3.500 mijë lekë.
Me shkresëm e MSHMS nr.4205/4, datë 01.12.2022 pakësohet fondi vecantë per shumen -85 mije lekë dhe me shkresën nr. 4642/3, datë 15.12.2022 pakësohen shpenzimet operative në shumën - 70.000 mijë lekë, rishikim i planit buxhetor.
**Me shkresen nr. 396 date 24.01.2023 (për llogari të Vitit 2022)**, është shtuar fondi veçantë Art 606 me shumen +**1.320 leke**, për arsye të zbatimit të VKM nr.898, datë 29.12.2022 " Mbështetje financiare për punonjesit e njësive të qeverisjes së përgjithshme".
Buxheti i akorduar nga MSH për vitin 2022 është në shumën 334,462 mijë lekë, me shtesat dhe pakësimet përgjate vitit 2022 të përshkruara më sipër plani buxhetit është 241.695 mijë lekë e cila rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë, pra shpenzimet faktike 232,995 mijë lekë.

Pra, rezulton se alokimi i fondeve në planin vjetor në fillim të vitit 2022 është 334,462 mijë dhe plani në fund të vitit 2022 është 241,695 me nje ndryshim në pakësim prej -92.767 mije lekë.

Ndërsa realizimi i buxhetit për Vitin 2022 i rakorduar me Degën e Thesarit rezulton si më poshtë:
Art. 600 ( Paga) 105,980,345 lekë -98%
Art. 601 ( Sigurime shoqërore 17,536,823 lekë -96%
Art. 602( Shpenzime operative) 107,942,750 lekë -94%
Realizimi i buxhetit për Vitin 2022 ështe 97 %.

Kërkesa buxhetore për Investimet për Vitin 2022-2024 është 686,865 mijë lekë, por nuk është alokuar fond investimi në Vitin 2022.

## C. Realizimi i planit të buxhetit.

***Viti 2021***

Realizimi i buxhetit të QKUM për vitin 2021, krahasuar me kërkesat e vitit 2021, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2021-2023, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Buxheti i vitit 2021 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2021-2023 *(ne mije leke)*

| Emërtimi | Kërkesa PBA 2021-2023 | Plani fillestar | Plani rishikuar Maj Investimet | Plani rishikuar Qershor | Plani rishikuar Tetor | Plani rishikuar Dhjetor/ Investime | Plani rishikuar Dhjetor | Ndryshimi (Plani Rishikuar/ Plani Fillestarne total | Ndryshimi (Plani Rishikuar / Kërkesë Buxhetore) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzime (A)+(B)** | **1.247.417** | **343.500** | **+9000** | **0** | **-300** | | **-19150** | **-10.450** | **333.050** |
| Paga | 85.493 | 85.215 | +8.000 | +16.000 | +37.000 | | | | 146.215 |
| Sigurime | 14.277 | 14.231 | +1.000 | +4.000 | +3.500 | | | | 22.731 |
| Shërbime | 222.600 | 228.654 | | -20.000 | -40.500 | | -18.150 | | 150.004 |
| Transferta | 400 | 400 | | | -300 | | | | 100 |
| **Total Shp. Operative (A)** | **322.370** | **328.500** | **+9000** | **0** | **-300** | | **-18150** | **-9.450** | **319.050** |
| | | | | | | | | | |
| **Shpenzime kapitale Total (B)** | **925.047** | **15.000** | **0** | | | **600** | **608** | **-1.000** | **14.000** |
| Numri punonjësve total | **110** | **88** | | | | | | **+49** | **137** |
| -Me kontrate te përhershme | **86** | **88** | | | | | | **0** | **88** |
| -Me kohe te pjesshme | **24** | | | | | | | **+25** | **49** |

Fondet e alokuara në raport me fondet e kerkuara janë:
Për (Art. 600) Fondet e kërkuara janë 85,493mijë lekë fondet e alokuara në fillim të vitit ishin 85,215 mijë lekë, pra 100% .
Për ( Art. 601) Fondet e kerkuara ishin 14,277 mijë lekë, fondet e alokuara ishin 14,231 mijë lekë - 100%.
Për (Art 602) Fondet e kërkuara ishin 222,600 mijë lekë dhe fondet e alokuara ishin 228,654 mijë lekë, pra 100% .
Për (Art 231) Fondet e kerkuara 925,047 mijë lekë dhe fondet e alokuara ishin 15,000 mijë lekë, rreth 1.6% .
Me shkresën nr. nr.320/1 datë 20.01.2021 “Plani buxhetor per V 2021”, MSHMS ka dërguar buxhetin e vitit 2021 në limite vjetore dhe mujor në shumën vjetore 328,100 mijë lekë dhe numrin e punonjësve gjithsej 88 punonjës. Dhe plani investimeve me shkresen nr. 142/3, dt 02.02.2021 ne vlerën 15.000 mijë leke. Plani fillestar ka ndryshuar me shkresae e MSH:

- nr. 500/3 dt 15.02.2021 dt 02.02.2021 duke shtuar shpenzimet për paga në shumën 8.000 mijë lekë dhe 1.000 mijë sigurime shoqërore, per rritjen e pagave ne zbatim te VKM nr.1076, dt 24.12.2020.
- nr.2385 dt.14.06.2021 duke pakësuar shpenzimet operative -20,000 mije leke dhe shtuar shpenzimet per paga +16.000 mije leke dhe sigurime +4,000 mije leke, per shkak te kalimit te fondit nga "shpenzime operative" ne "shpenzime per pagat" ne zbatim te VKM nr. 1151, datë 24.12.2020 " Per punonjësit me kontrate të perkohshme".

Me shkresen nr.17140/1, dt 26.10.2021 pakesohen Shpenzimet operative per vleren -40,500 mije leke dhe shtohen shpenzimet per paga +37.000 mije leke dhe sigurime shoqerore +3.500 mije leke ne zbatim te VKM nr. 207 date 20.03.2020 "shpërblim personeli mjekësor dhe mbeshtetës", dhe vkm nr 1151,dt 24.12.2020 " Per punonjesit me kontrate te perkohshme".

Me shkresen 1438 datë 11.05.2021 ka bere ndryshime ne zerin investime perkatesisht ne programet "Fv Paisje teknologjike Buck up" i cili pakesohet ne vleren 10.000 mije lekë dhe shtohet projekt prev ne vlerën 3.000 mije lekë dhe 7.000 mije lekë paisje mjekësore.

Me pas me shkresën 4656/2 datë 01.12.2021 ka bere ndryshime ne programin blerje paisje mjekesore ne programin tvsh e paisjeve mjekesore ne vlerën 992 mije lekë.

Pakesohet ne programin e back up vlera 1.600 mije lekë dhe shtohet 600 mijë lekë ne programin paisje mjekësore.

Ndryshimet në investime sipas programeve të cituara më sipër janë kryer për shkak të anullimit të investimit të "Fv Paisje teknologjike Buck up" dhe përdorimit të fondeve për nevojat e tjera të QKUM-së sic janë "Blerja e paisjeve Mjekësore".

Fondi i alokuar " Projekt preventiv zbatimi për krijimin e një godine të re për realizimin e back up" prej 1.400 mije lekë nuk u përdor , pasi nuk na u miratua përdorimi nga MSHMS.

Po kështu mbetën 982 mije leke nga realizimi i proçedurave të Investimeve: "Paisje Mjekesore", "TVSH e Paisjeve Mjekesore", dhe "Blerje Paisje Kompjuterike".

Pra, rezulton se alokimi i fondeve në planin vjetor në fillim të vitit 2021është 343,500 mijë dhe plani ne fund të vitit 2021 është 333,050 me një ndryshim në pakësim prej -10.450 mije lekë.

Ndërsa realizimi i buxhetit për Vitin 2021 i rakorduar me Degën e Thesarit rezulton si më poshtë:
Art .600 ( Paga) 134.670.725 lekë -92%
Art .601 ( Sigurime shoqërore 17.499.223 lekë -77%
Art. 602( Shpenzime operative) 129.036.223 lekë -86%
Art. 231 (Shpenzime kapitale) 11.618.236 lekë - 83%

Konstatohet se fondi për sigurimet shoqërore, rezulton i parealizuar (77%) por nuk eshtë real për shkak se ne fondin e pagave janë përfshire fondet e shpërblimit "për personelin mjekësor dhe mbështetës" në zbatim të VKM nr.207, datë 20.03.2020.

Realizimi në total i buxhetit të QKUM është në masën 88%.

Buxheti i akorduar nga MSH për vitin 2021 në shumën 333,050. mijë lekë rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë Plani me vlerën 333.050 mijë lekë dhe Fakti 289,775 mijë lekë.

***Viti 2022***

Realizimi i buxhetit të QKUM për vitin 2022, krahasuar me kërkesat e vitit 2022, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2022-2024, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024 *(ne mije leke)*

| Emërtimi | Kërkesa PBA 2022-2024 | Plani fillestar i miratuar janar 2022 | Plani rishikuar prill 2022 | Plani rishikuar korrik 2022 | Plani rishikuar dhjetor 2022 | Ndryshimi Plani rishikuar/ Planit Fillestar | Ndryshimi Plani rishikuar/ Kërkesë Buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzime (A)+(B)** | **1.104.330** | **334,462** | **-24.002** | **-85** | **-68.680** | **-92.767** | **241.695** |
| Paga | 144.654 | 110.410 | -2.760. | | | | 107.650 |
| Sigurime | 24.157 | 15,098 | -377 | 3.500 | | | 18.221 |
| Shpenzime operative | 248.654 | 208.654 | -20.865 | -3.500 | -70.000 | | 114.289 |
| Transferta (606) F .Vecante | | 300 | | -85 | +1.320 | | 1.535 |
| **Shp.Operative (A)** | **417,465** | **334,462** | **-24.002** | **-85** | **-68.680** | **-92.767** | **241.695** |
| **Shpenzime kapitale (B)** | **686.865** | | | | | | |
| **Nr. punonjesve total** | **137** | | | | | | |
| **Nr.punonjesperhershem** | **88** | | | | | | |
| **Nr.punonjesish kontrate te perkohshme** | **49** | | | | | | |

*Burimi: QKUM*

Për Vitin 2022, Fondet e alokuara perkundrejt fondeve te kërkuara ishin si më poshtë:
Për (Art. 600) Fondet e kerkuara ishin 144.654 mijë lekë fondet e alokuara ne fillim te Vitit ishin 110.410 mijë lekë , pra 76%.
Për (Art. 601) Fondet e kerkuara ishin 24.157 mijë lekë, fondet e alokuara ishin 15.098 mijë lekë - 62 %.
Për (Art 602) Fondet e kërkuara ishin 248.654 mijë lekë dhe fondet e alokuara ishin 208.654 mijë lekë, pra 84% .
Për (Art 606) Fondi i Vecante fondet e alokuara ishin 400 mijë lekë.
Për (Art 231) Fondet e kerkuara 686.865 mijë lekë por nuk u alokuan nga MSHMS fonde Investimi.
MSHMS me shkresën nr.5256/4, datë 11.01.2022 ka dërguar plan buxhetin e vitit 2022 në limit vjetor dhe mujor në shumën vjetore 334.462 mijë lekë dhe nr i punonjësve 88 per punonjesit e perhershem sipas struktures dhe 49 punonjes me kontrate te perkohshme. Plani fillestar ka ndryshuar me shkresa të MSHMS1333/4 date 06.04.2022 duke pakësuar shpenzimet operative në shumën 20.865 mijë lekë, shpenzime për paga 2.760.mije lekë dhe shpenzimet për sigurime shoqërore në shumen 377 mije lekë, rishikim i planit buxhetor.
Me shkresën e MSHMS nr 12815/1 datë 05.07.2022 dërgohet shtesë fondi për shpenzime për sigurime shoqërore në shumën 3.500 mije lekë duke pakësuar shpenzimet operative në shumën 3.500 mije lekë.
Me shkresëm e MSHMS nr.4205/4 datë 01.12.2022 pakësohet fondi vecantë per shumen 85 mije lekë dhe me shkresën nr. 4642/3 datë 15.12.2022 pakësohen shpenzimet operative në shumën 70.000 mijë lekë, rishikim i planit buxhetor.
**Me shkresen nr. 396 date 24.01.2023 ( për llogari të Vitit 2022)**, shtohet fondi vecante Art 606 me shumen **1.320 leke**, kjo per arsye të zbatimit të VKM nr.898, datë 29.12.2022 “Mbeshtetje financiare per punonjesit e njesive të qeverisjes së përgjithshme”.
Buxheti i akorduar nga MSH për vitin 2022 është në shumën 334.462 mijë lekë, me shtesat dhe pakësimet përgjate vitit 2022 të përshkruara më sipër plani buxhetit behet 241.695 mijë lekë e cila rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë, pra shpenzimet faktike 232.995 mijë lekë.

Pra Rezulton se alokimi i fondeve ne planin vjetor në fillim të vitit 2022 ështe 334.462 mijë dhe plani ne fund të vitit 2022 është 241.695 me nje ndryshim në pakësim prej 92.767 mije lekë.

Ndërsa realizimi i buxhetit për Vitin 2022 i rakorduar me Degën e Thesarit rezulton si më poshtë:
Art. 600 ( Paga) 105.980.345 lekë -98%
Art. 601 ( Sigurime shoqërore 17.536.823 lekë -96%
Art. 602( Shpenzime operative) 107.942.750lekë -94%
Realizimi i buxhetit per vitin 2022 ështe 97 %

**Zbatimi i buxhetit për shpenzimet:**
Rakordimi shpenzimeve me Degën e Thesarit është bërë mujor e progresiv për çdo muaj deri në dhjetor te vitit kalendarik. Një kopje e situacionit dërgohet çdo muaj në MSHMS. Regjistrimi shpenzimeve behet sipas Urdhër Pagesës dhe sipas rendit kronologjik.
Për vitet 2021 dhe 2022, bazuar në situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore llogaria 600, llogaria 601 dhe llogaria 602, paraqitet:

Situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore *(ne mijë lekë)*

| Artikulli | Emërtimi | 2021 | | 2022 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Plan | Fakt | Plan | Fakt |
| **600** | **Shpenzime paga** | **146.215** | **131.671** | **107.650** | **105.980** |
| **601** | **Kont. për sig. shoq dhe shend** | **22.731** | **17.449** | **18.221** | **17.537** |
| **602** | **Shpenzime operative** | **150.004** | **129.037** | **114.289** | **107.943** |
| **602** | **Materiale zyre** | **3.820** | **2.450** | **3.900** | **3.358** |
| 60201 | Kancelari. printim | 1.000 | 998 | 1.000 | 733 |
| 60202 | Materiale pastrimi dezinfektim | 1.860 | 900 | 900 | 810 |
| 6020300 | Materiale | 960 | 552 | 1.100 | 1001 |
| 60290900 | Te tjera materiale zyre te pergjithshme | | | | |
| **6021** | **Materiale shërbim social** | **75.784** | **67.854** | **43.450** | **41.240** |
| 602101 | Veshje uniform | 40.000 | 38.631 | 24.500 | 22.770 |
| 602102 | Medikamente | | | | |
| 6021003 | Ilaçe dhe materiale mjekësore | 30.000 | 26.625 | 16.000 | 15.558 |
| 6021010 | Shpenzime per prodhim dokumentacion specifik | 700 | 420 | 950 | 900 |
| 6021099 | Te tjera | 3.084 | 2.177 | 2000 | 1.982 |
| **6022** | **Shërbime nga të tretë** | **34.600** | **30.546** | **36.450** | **33.550** |
| 602201 | Energji | 5.000 | 4.261 | 5.100 | 4.029 |
| 602202 | Ujë | 400 | 239 | 300 | 235 |
| 602203 | Telefon. internet | 5.000 | 4.077 | 4.500 | 3.477 |
| 602204 | Poste | 200 | 12 | 50 | 24 |
| 602207 | Shërbim ruajtjes së sigurisë | 15.000 | 12.869 | 17.000 | 16.363 |
| 602099 | Të tjera | 9.100 | 9.088 | 9.500 | 9.422 |
| **6023** | **Shpenzime transporti** | **6.000** | **4.500** | **16.100** | **16.098** |
| 602301 | Karburant. vaj | 5.000 | 3.600 | 15.000 | 15.000 |
| **602** | **Pjesë këmbimi** | | | | |
| 602302 | Siguracion. taksa | 1.000 | 900 | 1.100 | 1.098 |
| **6024** | **Udhëtim i brendshëm** | **4.500** | **3.776** | **4.800** | **4.712** |
| **6025** | **Shpenzime per mirembajtje te zakonshme** | **18.800** | **14.956** | **4.539** | **4.073** |
| 6025300 | Shpenzime per mirembajtje obj ndertimor | 1.200 | 1.079 | 1.000 | 941 |
| 602550 | Shpenzime per mirembajtje aparateve paisje teknike | 3.500 | 1.842 | 2.139 | 1.908 |
| 6025600 | Shpenzime per mirembajtje mjete transporti | 1.100 | 936 | 1.200 | 1.104 |
| 6025800 | Shpenzime per mirembajtje paisjeve te zyrave | 13.000 | 11.099 | 200 | 120 |
| | | | | | |
| **6029** | **Te tjera operative** | **6.500** | **4.954** | **5.050** | **4.912** |
| 602903 | Shpenzime gjyqësore | | | | |
| 6029004 | Shpenzime per sigurimin e ndertesave | 4.500 | 3.498 | 4.500 | 4.427 |
| 6029005 | Shpenzime per honorare | 1.500 | 1.385 | 350 | 326 |
| 602908 | Tatime taksa | 500 | 71 | 200 | 159 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **606** | **Transferta për buxhetet familjare** | **100** | | **1.535** | **1.535** |
| | **Totali shpenzimeve** | **319.050** | **278.157** | **241.695** | **232.995** |
| | **Realizimi (Fakt/Plan)** | **333.050** | **289.775** | **241.695** | **232.995** |
| 231 | Blerje pajisje | 14.000 | 11.618 | 0 | 0 |
| 602 | shpenzime | 319.050 | 278.157 | 114.289 | 107.943 |

*Burimi: QKUM , situacioni për realizim shpenzimesh*

***Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore*** shoqërohen me dokument justifikues si listë pagesa e firmosur nga NZ, nga NA dhe firmosur dhe vulosur nga punonjësi Degës së Thesarit. Në strukturë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore zënë **rreth 45% të shpenzimeve** korrente të vitit buxhetor.

**Shpenzimet operative** shoqërohen me dokument justifikues si urdhër-shpenzimi, fature blerje, flete hyrje ne magazine, urdhër prokurimi, kontrate furnizimi, proces verbal, etj. Në strukturë shpenzimet operative zënë 46% të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor.

-***Shpenzime për materiale zyre*** zënë rreth **1%** të shpenzimeve operative, justifikohen me urdhër shpenzim, faturën e shitësit, flete hyrje në magazinë, etj.

-***Shpenzime për materiale dhe shërbime sociale*** zënë rreth **18 %** të shpenzimeve operative, dhe këtu përfshihen shpenzimet për veshje uniforme, ilaçe,materiale mjekesore etj, mbështet ne dokumentacion vërtetues si: kontrata e shpallur fituese me OK, fature tatimore shitje, flete hyrje në magazine, etj.

-***Shpenzime nga të tretët*** zënë rreth **14 %** të shpenzimeve korrente. Shpenzimet përfshijnë pagesa për energji elektrike, ujë, telefon, internet, shërbim i ruajtjes se sigurisë, etj.. Shpenzimet bazohen në urdhër shpenzim, faturë shitje, urdhër prokurimi, kontrate shërbimi, etj.

-***Shpenzimet e transportit*** përbëjnë **6%** te shpenzimeve operative. Ato paraqesin shpenzime për blerje karburanti dhe për automjetet e institucionit dhe autoambulancat. Dokument vërtetues urdhër prokurimi, fatura e shitjes, flete hyrje në magazinë, etj.

-***Shpenzime për udhëtim*** përbëjnë **1- 2 %** të shpenzimeve korrente të vitit 2021-2022, dhe më pas ka pak ngritje të këtij shpenzimi. Ai paraqet shpenzimeve për udhëtime brenda dhe jashte vendit, jashtë qendrës se punës, për trajnime te stafit te urgjences paraspitalore per S.R, S.B, Q.SH si dhe monitoruar sherbimin e urgjences paraspitalor ne te gjithe Shqiperine ne zbatim te Ligjit 147/2014" Per sherbimin e Urgjences Mjekesore", mbështetur në dokumente vërtetues autorizim nga NA, Urdhër Shërbimi për punonjësin udhëtues.

-***Të tjera shpenzime operative***, janë për shpenzime te sigurimit te nderteses, dhe mirembajtje te ndryshme te paisjeve, nderteses dhe mjeteve te transportit te cilat zene rreth 4% te shpenzimeve operative.

-**Shpenzime Transferta per buxhetet familjare (Art 606)** janë shpenzimet që janë kryer për rastet e ndihmes financiare për personelin që ka dalë në pension, raste fatkeqësie dhe ndihma financiare për punonjesit ne zbatim te VKM nr.898, datë 29.12.2022 " Mbështetje financiare për punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme".

| **1. Titulli i Gjetjes:** | Planifikim i gabuar i zërave të shpenzimeve. |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi i kërkesave buxhetore të vitit 2021, është konstatuar se kërkesat e mëposhtme nuk janë të mire argumentuara si:<br>-shpenzime për anëtarët e parlamentit në shumën 960 mijë lekë.<br>-shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna" në shumën 900 mijë lekë.<br>-Pajisje për përdorim policor në shumën 960 mijë lekë.<br>-Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulike në shumën 2,700 mijë lekë. |

| | |
|---|---|
| | -Shpenzime për mirëmbajtjen e rezervës shtetërore në shumën 960 mijë lekë.<br>-Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore në shumën 1,500 mijë lekë.<br>-Shpenzime gjyqësore në shumën 960 mijë lekë.<br>QUKM,ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktin konkret të projektit dhe programit buxhetor, si edhe një analizë e detajuar prioritarizmi duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, duke cënuar kështu përdorimin me eficencë, efektivitet dhe produktivitet të fondeve në dispozicion të institucionit. |
| **Kriteri:** | Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 neni 29, ligji 137/2020 "Për Buxhetin e vitit 2021" dhe udhëzimi nr.4, datë 25.01.2021. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Planifikim i fondeve dhe zërave buxhetorë jo në funksion të punës. |
| **Shkaku:** | Mos zbatim i legjislacionit. |
| **Rëndësia:** | E mesme. |
| **Rekomandim:** | QKUM, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm dhe të nevojshëm të kërkesave buxhetore duke targumentuar të gjitha kërkesat, lidhjen e objektivave të tyre me produktin e programit buxhetor, bazuar në një analizë buxhetore prioritarizmi të dokumentuar, me qëllim parandalimin e keq planifikimit të fondeve të institucionit. |

| **2. Titulli i Gjetjes:** | Struktura e QKUM me 57% të stafit, punonjës me kontrata 1 vjeçare. |
|---|---|
| **Situata:** | Parashikimi i *"shpenzimeve për personelin"* përfshin pagat bruto për punonjësit e përhershëm dhe të përkohshëm, (punonjësit e përkohshëm, janë kërkuar personel mjekësor shtesë për shkak të pandemisë), shtesat mujore mbi pagë si orët për turnet e dyta dhe të treta. Përveç shpenzimeve për paga, parashikohen edhe shpenzimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat janë planifikuar në masën 16.7% të nivelit të bazës së pagës bruto.<br>Punonjësit e përhershëm i përkasin strukturës së QKUM pra 86 punonjës (punonjësit e përkohshëm janë kërkuar për shtesë 49 punonjës (personel mjekësor për shkak të pandemisë mjekë, infermierë, dhe shoferë),<br>Parashikimi i shpenzimeve për paga, ka ndryshim të fondit të pagave në PBA e viteve 2021-2023 dhe 2022-2024, është më i lartë për arsye të kërkesës për shtim personeli me kontratë të përkohshme si dhe zbatimit të vendimit nr. 207, datë 10.03.2020 "Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe Punonjës të tjerë".<br>Megjithëse kërkesa buxhetore për vitin 2021 është për 86 punonjës, MSHMS ka miratuar 88 punonjës.<br>Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për përballimin e fluksit të urgjencave mjekësore si edhe dinamikës në rritje (për shkak të tërmetit, pandemisë) në vitet 2020-2021-2022, ka parashikuar rritje të burimeve njerëzore, numrit të punonjësve të QKUM-së i janë shtuar 10 mjekë, 20 |

| | |
|---|---|
| | infermierë dhe 15 shoferë sipas VKM nr.215, datë 12.03.2020 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.47, datë 22.01.2020 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*", VKM nr.234, datë 19.03.2020 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.47, datë 22.01.2020* dhe VKM nr.369, datë 06.05.2020, VKM nr.1151, datë 24.12.2020 *"Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkoshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore"* si dhe VKM nr.35, datë 19.01.2022 *"Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkoshme për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore"*. Pra, konstatohen ndryshime të shpeshta të stafit mjekësor të cilat sjellin mangësi në kryerjen e detyrës dhe investimi që kryhet nga QKUM për përgatitjen profesionale të kësaj kategorie punonjësish, nuk është i qendrueshëm dhe ndikon në shërbimin cilësor ndaj qytetarëve. |
| **Kriteri:** | Ligji 147/2014 "Për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore", nenet 5 "Organizimi i Shërbimit të Urgjencës" dhe 8 "Përgjegjësitë e QKUM", VKM nr.933, datë 29.12.2014 "Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore" i ndryshuar. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Ndryshime të shpeshta të planit buxhetor dhe ulje e shërbimit cilësor ndaj qytetarëve. |
| **Shkaku:** | Mos zbatim i legjislacionit. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandim:** | QKUM, të adresojë pranë MSHMS kërkesën për rishikim të menjëhershëm të strukturës organizative të institucionit, shoqëruar me relacionin përkatës argumentues mbi domosdoshmërinë e limitimit të pozicioneve të punës me kontratë afatshkurtër (aktualisht 57% e stafit) në një institucion me rëndësi jetike për qytetarët dhe pa natyrë pune me karakter sezonal, me qëllim që investimi i kryer për përgatitjen profesionale të kësaj kategorie punonjësish, të jetë i qendrueshëm dhe afatgjatë për shërbim profesional dhe cilësor ndaj qytetarëve. |

**Për sa më sipër**, *ngarkohet me përgjegjësi znj. G. V., me detyrë Drejtor i Financës/Buxhetit dhe Investimeve.*

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimin Nr. 4* datë 16.03.2023.

### II.2.4 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve.

Në lidhje me auditimin e pikës së mësipërme të programit, grupit të auditimit ju vunë në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat e pozicionit financiar
- Pasqyrat e performancës financiare
- Pasqyrat e flukseve monetare (Cash flow)
- Pasqyrat e Ndryshimeve ne Aktivet Neto/ Fondet Neto

Më poshtë paraqiten të përmbledhura në një tabelë pasqyrat e pozicionit financiar, në mënyrë krahasuese:

| Reshti | Referenca e Llogarive | E M E R T I M I | 2022 | 2021 | 2020 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **A** | **A K T I V E T** | **347,405,060** | **404,929,755** | **422,906,502** |
| 2 | | **I.Aktivet Afat shkurtra** | **103,661,722** | **140,532,394** | **129,932,759** |
| 3 | | **1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre** | **0** | **0** | **0** |
| 4 | 531 | Mjete monetare ne Arke | | | |
| 5 | 512,56 | Mjete monetare ne Banke | | | |
| 6 | 520 | Disponibilitete ne Thesar | | | |
| 7 | 50 | Letra me vlere | | | |
| 8 | 532 | Vlera te tjera | | | |
| 9 | 54 | Akreditiva dhe paradhënie | | | |
| 10 | 59 | Provigjone zhvlerësimi letra me vlere (-) | | | |
| 11 | | **2.Gjendje Inventari qarkullues** | **88,317,497** | **123,242,648** | **119,494,617** |
| 12 | 31 | Materiale | 45,815,677 | 43,974,496 | 38,609,837 |
| 13 | 32 | Inventar I imët | 42,501,820 | 79,268,152 | 80,884,780 |
| 14 | 33 | Prodhim nre proces | | | |
| 15 | 34 | Produkte | | | |
| 16 | 35 | Mallra | | | |
| 17 | 36 | Kafshe ne rritje e majmëri | | | |
| 18 | 37 | Gjendje te pa mbritura,ose pranë te tretëve | | | |
| 19 | 38 | Diferenca nga çmimet e magazinimit | | | |
| 20 | 39 | Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-) | | | |
| 21 | | **3.Llogari te Arketushme** | **15,344,225** | **17,289,746** | **10,438,142** |
| 22 | 411 | Kliente e llogari te ngjashme | | | |
| 23 | 423,429 | Personeli, paradhënie, deficite, gjoba | 1,803,928 | 3,529,735 | 78,404 |
| 24 | 431 | Tatim e Taksa | | | |
| 25 | 432 | Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal | | | |
| 26 | 433 | Fatkeqësi natyrore qe mbulohen nga shteti | | | |
| 27 | 435 | Sigurime Shoqërore | | | |
| 28 | 436 | Sigurime Shëndetësore | | | |
| 29 | 437,438, | Organizma te tjerë shtetërore | | | |
| 30 | 44 | Institucione te tjera publike | | | |
| 31 | 465 | Efekte per tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlere | | | |
| 32 | 468 | Debitore te ndryshëm | | | |
| 33 | 4342 | Operacione me shtetin (Te drejta) | 13,540,297 | 13,760,011 | 10,359,738 |
| 34 | 45 | Mardhenie midis institucioneve apo njësive ekonomike | | | |
| 35 | 49 | Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-) | | | |
| 36 | | **4.Te tjera aktive afatshkurtra** | **0** | **0** | **0** |
| 37 | 409 | Parapagime | | | |
| 38 | 473 | Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin | | | |
| 39 | 477 | Diferenca konvertimi aktive | | | |
| 40 | 481 | Shpenzime per t'u shpërndare ne disa ushtrime | | | |
| 41 | 486 | Shpenzime te periudhave te ardhshme | | | |
| 42 | | **II.Aktivet Afat gjata** | **243,743,338** | **264,397,361** | **292,973,743** |
| 43 | **20** | **1.Aktive Afatgjata jo materiale** | **0** | **0** | **0** |
| 44 | 201 | Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave | | | |
| 45 | 202 | Studime dhe kërkime | | | |
| 46 | 203 | Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme | | | |
| 47 | **21** | **2.Aktive Afatgjata materiale** | **243,743,338** | **264,397,361** | **292,973,743** |
| 48 | 210 | Toka, T,roje, Terrene | | 0 | 0 |
| 49 | 211 | Pyje, Plantacione | | 0 | 0 |
| 50 | 212 | Ndërtesa e Konstruksione | 101,993,173 | 107,677,069 | 113,660,117 |
| 51 | 213 | Rruge, rrjete, vepra ujore | | 0 | 0 |
| 52 | 214 | Instalime teknike, makineri e pajisje | 122,130,439 | 152,221,103 | 157,558,379 |
| 53 | 215 | Mjete Transporti | 17,905,545 | 0 | 19,794,447 |
| 54 | 216 | Rezerva Shtetërore | | 0 | 0 |
| 55 | 217 | Kafshe pune e prodhimi | | 0 | 0 |
| 56 | 218 | Inventar ekonomik | 1,714,181 | 4,499,189 | 1,960,800 |
| 57 | 24 | Aktive afatgjata te dëmtuara | | 0 | 0 |
| 58 | 28 | Caktime te Aktiveve Afatgjata | | 0 | 0 |
| 59 | 25-26 | **3.Aktive Afatgjata Financiare** | **0** | **0** | **0** |
| 60 | 25 | Huadhënie e Nenhuadhenie | | | |
| 61 | 26 | Pjesëmarrje ne kapitalin e vet | | | |
| 62 | | **4.Investime** | **0** | **0** | **0** |
| 63 | 230 | Per Aktive Afatgjata jo materiale | | | |
| 64 | 231 | Per Aktive Afatgjata materiale | | | 0 |
| **65** | **B** | **PASIVET(DETYRIMET)** | **23,387,957** | **23,711,503** | **28,224,004** |
| 66 | | **I.Pasivet Afat shkurtra** | **23,387,957** | **23,711,503** | **28,224,004** |
| 67 | | **1. Llogari te Pagueshme** | **23,387,957** | **23,711,503** | **28,224,004** |
| 68 | 401-408 | Furnitorë e llogari te lidhura me to | 2,765,068 | 3,457,971 | 1,550,167 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 69 | 42 | Detyrime ndaj personelit | 9,240,613 | 8,859,433 | 6,141,617 |
| 70 | 16,17,18 | Hua Afat shkurtra | | | 576,988 |
| 71 | 460 | Huadhënës | | | |
| 72 | 431 | Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa | | | |
| 73 | 432 | Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal | | | |
| 74 | 433 | Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore | | | |
| 75 | 435 | Sigurime Shoqërore | 1,377,526 | 1,290,751 | |
| 76 | 436 | Sigurime Shëndetësore | 157,090 | 151,856 | 2,090,966 |
| 77 | 437,438, | Organizma te tjerë shtetërore | | | |
| 78 | 44 | Institucione te tjera publike | | | |
| 79 | 45 | Mardhenie midis institucioneve apo njësive ekonomike | | | |
| 80 | 464 | Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere | | | |
| 81 | 466 | Kreditore per mjete ne ruajtje | 9,847,660 | 9,951,492 | 17,864,266 |
| 82 | 467 | Kreditore te ndryshëm | | | |
| 83 | 4341 | Operacione me shtetin( detyrime | | | |
| 84 | 49 | Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-) | | | |
| 85 | | **2.Te tjera pasive afatshkurtra** | **0** | **0** | **0** |
| 86 | 419 | Kreditore, Parapagime | | | |
| 87 | 475 | Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhëse | | | |
| 88 | 478 | Diferenca konvertimi pasive | | | |
| 89 | 480 | Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar | | | |
| 90 | 487 | Te ardhura te arkëtuara para nxjerrjes se titullit | | | |
| 91 | | **II.Pasivet Afat Gjata** | **0** | **0** | **0** |
| 92 | Klase 4 | Llogari te pagueshme | | | |
| 93 | 16.17,18 | Huate Afat gjata | | | |
| 94 | | Provigjonet afatgjata | | | |
| 95 | Klasa 4 | Te tjera | | | |
| 96 | **C** | **AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)** | **324,017,103** | **381,218,252** | **394,682,498** |
| 97 | **D** | **FONDI I KONSOLIDUAR :** | **324,017,103** | **381,218,252** | **394,682,498** |
| 98 | 101 | Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar | 358,942,254 | 377,470,221 | 332,682,915 |
| 99 | 12 | Rezultatet e mbartura | | | |
| 100 | 85 | Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore | -34,925,151 | 3,748,031 | 61,999,583 |
| 101 | 111 | Rezerva | | | |
| 102 | 115 | Nga Fondet e veta te investimeve | | | |
| | 15 | Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvlerësime | | | |
| 103 | 105 | Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmen | | | |
| 104 | 106 | Teprica e Granteve kapitale Te Huaja | | | |
| 105 | 107 | Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim | | | |
| 106 | 109 | Rezerva nga Rivlerësimi I Aktiveve Afatgjata | | | |
| 107 | | Te Tjera | | | |
| 108 | **E** | **TOTALI I PASIVEVE(B+C)** | **347,405,060** | **404,929,755** | **422,906,502** |

| | |
|---|---|
| **3. Titulli i gjetjes:** | Anomali në përmbajtjen, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare. |
| **Situata:** | · Në pasqyrën e flukseve monetare (Cash Flow) deklarohen të hyra nga të ardhurat jotatimore në vlerën 16,542 lekë për vitin 2021, të cilat nuk janë pasqyruar në Pasqyrën e performancës financiare.<br>· Në llogarinë 423,429 (Personeli, paradhenie, deficite, gjoba) e cila paraqitet në vlerën 3,529,735 për vitin 2021 dhe 78,404 për vitin 2020, si vlera të cilat duhet të arkëtohen nga punonjës të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, vlerë e cila pas konsultimeve duket e vështirë për tu arkëtuar.<br>· Në llogarinë 215 (Mjete transporti), për vitin 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë, e cila paraqitet si vlerë negative nga amortizimi i akumuluar i aktivit, por nga historiku i llogarisë, ka nxjerrje jashtë përdorimi të aktivi përfundimisht dhe shuma në llogarinë e akumuluar të amortizimit që lidhet me atë aktiv kthehet mbrapsht. E njëjta gjë ndodh dhe me llogarinë 218 (Inventarë ekonomik).<br>· Përsa i përket llogarisë 466 (Kreditorë në mjete në ruajtje) nuk pasqyrohet si vlerë në Pasqyrën e flukseve monetare (Cash flow)<br>· Përsa i përket kreditorëve, nuk shfaqen anomali si dhe likudimi i tyre ndodh në kohë dhe sipas një rradhe të caktuar. |
| **Kriteri:** | Standardet Kombëtare të Kontabilitetit SKK |

| | |
|---|---|
| | Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"<br>Ligj Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare<br>Nr. 9920, Datë 19.5.2008 Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i Ndryshuar. |
| **Efekti/Ndikimi:** | Pengon në arritjen e qëllimit dhe objektivave të shoqërisë. |
| **Shkaku** | Neglizhenca e krijuar nga ana e përgjegjësve. |
| **Rëndësia:** | E Lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, të marrë masat të bëjë korrigjimet dhe rregullimet përkatëse në pasqyrat financiare të llogarive të sipërpërmendura si dhe të bëjë të mundur arkëtimin e vlerës prej 3,529,735 për vitin 2021 dhe vlerën prej 78,404 për vitin 2020 nga punonjësit të cilët nuk janë më në marrëdhënie pune. |

***Për sa me sipër**, ngarkohen me përgjegjësi znj. G. V., me detyrë Drejtor i Financës/Buxhetit dhe Investimeve.*

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimin Nr. 4* datë 16.03.2023.

### II.2.5. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimi i punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

Në zbatim të **Pikës 5** të Programit të Auditimit, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore bazuar në Regjistrin e Realizimeve vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit në Sistemin e Prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, për gjatë vitit 2021 ka realizuar 25 procedura prokurimi, nga të cilat 19 Procedura prokurimi me blerje të vogël dhe 6 procedura prokurimi me vlerë të lartë. Gjatë vitit 2022 ka realizuar 19 procedura prokurimi, nga të cilat 15 procedura prokurimi me vlerë të vogël dhe 4 procedura prokurimi me vlerë të lartë.

Bazuar në një analizë risku dhe në metodat e përzgjedhjes për auditim të procedurave të prokuruara u vendos për auditimin e procedurave të mëposhtme:

2021

| | | Procedura e Prokurimit | Fondi Limit | Vlera e kontratës | Operatori Ekonomik | Data e lidhjes së kontratës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2021** | **1** | Blerje pajisje mjekësore | 5,780,000 | **5,452,000** | EUROMED | 26.11.2021 |
| | **2** | Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi te sistemit te pajisjeve teknologjike te QKUM | 1,985,400 | 1,620,170 | Mirjan Nico | 06.07.2021 |
| | **3** | Blerje Set urgjence | 21,876,033 | **21,473,500** | Gen-Alb Farma | 14.10.2021 |
| **2022** | **4** | Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat | 19,516,800 | | I.S.S | |
| | **5** | Siguracioni i ndërtesës, zyrave dhe pajisjeve te QKUM | 4,460,000 | **4,427,500** | Albsig | 06.04.2022 |
| | **6** | Blerje Set urgjence | 13,120,500 | **12,990,000** | Gen-Alb Farma | 07.10.2022 |

- **“Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat” 2022**

## Përshkrimi i procedurës

Me shkresë datë 14.03.2022 të Z. K. C., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Njësisë së Koordinimit, është bërë kërkesë për shërbimin e monitorimit të autoambulancave me GPS, ku ndër të tjera bën me dije se: “kontrata për shërbimin e monitorimit të autoambulancave në territorin e RSH, përfundon më datë 23.03.2023, ndaj duhet të zhvillohet procedura e prokurimit për shërbimin e monitorimit të autoambulancave me GPS, duke shtuar edhe monitorimin me GPS për autoambulancat e reja që i janë shtuar flotës së autoambulancave. Numri i GPS deri vitin e kaluar ka qenë 360. Gjithashtu, është sugjeruar që për shkak të ndryshimit të numrit të autoambulancave (blerje, dhurimi, etj) dhe për shkak të domosdoshmërisë së monitorimit të tyre me GPS, për rritjen e eficencës së këtij shërbimi, të mbahet parasysh edhe një numër autoambulancash të cilave mund t’iu vendoset GPS gjatë vitit në vazhdim. Për këtë arsye, është sugjeruar prokurimi për një numër prej 380 autoambulancash.

## Fondi Limit

Fondi limit në vlerën 19,516,800 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

## Përmbledhja e procedurës në tabelë

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt** *“Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat” 2022* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 76, datë 16.03.2022 | | |
| **1. Lloji i procedurës së Prokurimit**<br>Procedurë e Hapur | **2. Njësia e Prokurimit**<br>Znj. L. Zh.<br>Z. K. C.<br>Z. K. R. | **3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike**:<br>znj. L. Zh.<br>Z. K. C.<br>z. K. R. |
| **4. Fondi limit (pa tvsh)**<br>19, 516, 800 lekë | **5. Burimi i Financimit**<br>Buxheti i shtetit | **6. Data e hapjes së tenderit**<br>25.03.2022(publikimi) 11.04.2022 (zhv) |
| **7. Operatorët Ekonomikë**<br>**a) Pjesëmarrës**<br>I.S.S 19,152,000 lekë<br>Vodafone 0 lekë<br>• **b) kualifikuar:**<br>I.S.S 19,152,000 lekë | **8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**<br>Znj. G. V.<br>Z. I. J.<br>Z. B. A. | **9. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>19,152,000 lekë |
| **10. Data e lidhjes së kontratës**<br>Marrëveshje kuadër datë 09.05.2022 | **11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>364,800 lekë | **12. Ankimime**<br>S’ka |
| **13.Struktura për ndjekjen e kontratës**<br>Z. K. R.<br>Zj. J. R.<br>Zj. J. H. | **14. Fletë hyrja** | **15. Afati i kontratës**<br>24 muaj |
| **16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi**<br>Nr. 8/2022 dt. 18.07.2022<br>Nr. 20/2022 dt. 12.08.2022<br>Nr. 39/2022 dt. 13.09.2022<br>Nr. 76/2022, dt. 12.10.2022<br>Nr. 102/2022 dt. 14.11.2022<br>Nr. 126/2022 dt. 12.12.2022 | 17. Likuiduar deri dt<br>U.SH. nr. 177 dt. 09.08.2022 874,440 lekë<br>U.SH. Nr. 186 dt. 08.09.2022 874,440 lekë<br>U.SH. nr. 214 dt. 04.10.2022 874,440 lekë<br>U.SH. nr. 234 dt. 03.11.2022 874,440 lekë<br>U.SH. nr. 255 dt. 03.12.2022 874,440 lekë<br>U.SH. nr. 265 dt. 13.12.2022 874,440 lekë | |

Përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 19,516,800 lekë, pas çmimit mesatar të ofruar nga tre operatorët ekonomik (çmimi për 380 GPS për 24 muaj), përkatësisht:
“S.A.S” sh.p.k në vlerën 19,790,400 lekë pa tvsh (çmimi 2,170/njësi lekë pa tvsh në muaj);

"ATD" shpk në vlerën 18,696,000 lekë pa tvsh (çmimi 2,050/njësi lekë pa tvsh në muaj);
"G. S." shpk në vlerën 20,064,000 lekë pa TVSH (çmimi 2,200/njësi lekë pa tvsh në muaj).
Me relacionin protokolluar më datë 23.03.2022, komisioni i NJ.P. dhe përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar vlerën 19,516,800 lekë pa tvsh. Fondi limit është 2,140/njësi lekë për një muaj pa tvsh.

***Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatua që:***

- Gjatë verifikimit të testimit të tregut dhe ofertave të marra në treg, vihet re që formati i marrjes së ofertave është i njëjtë për të gjithë operatorët dhe nuk mund të merret oferta në treg duke u nisur vetëm nga objekti i kontratës "Shërbim GPS dhe monitorim për Autoambulancat", duke mos qenë në dijeni se në përshkrimin e mallrave përfshihen GPS për automjete, sistemi audio-video, kamera, software, PC për monitorimin të cilat kanë specifikime të veçanta teknike. Pra, nga NJ.P. nuk është për bërë përshkrim i plotë i procedurës së prokurimit përpara marrjes së ofertave. Gjithashtu, nga NJ.P., njëkohësisht grupi për llogaritjen e fondit limit të kontratës, nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë Institucioni sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
- Specifikimet teknike për GPS dhe kamera të vendosura nga A.K. kanë një ngjashmëri të theksuar me specifikimet e katalogut të OE fitues. Gjithashtu një pjesë e specifikimeve teknike janë të ekzagjeruara dhe nuk mund të verifikohen nga anëtarët e KVO-së dhe të atyre të marrjes në dorëzim si dhe kanë një vlerë fikse duke mos përdorur termat ekuivalente, si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Specifikimet teknike për GPS<br>bateri rezerve (400 mAh/1.5 V)<br>konsumi i Energjisë 8mA<br>orët e punës-47 orë në opsionin e ruajtjes së energjisë dhe 4.7 orë në gjendje pune normale<br>memorie 8M byte<br>sensitiviteti -161Db<br>saktësia e pozicionit 2.5m | Specifikmite tenike të kamerës<br>Konsumi i Energjisë 25mA<br>Rezistenca e Brendshme 3.6R<br>Baud Rate 115200bps |

- Në hartimin e specifikimeve teknike nga A.K. në një pikë citohet "Në çdo qendër spitalore kompania do të krijojë mundësinë e monitorimit të ambulancave që i përkasin çdo drejtorie" dhe nuk jepen shpjegime më të detajuara se si do të krijohet ky monitorim në çdo qendër spitalore.
- Në hartimin e specifikimeve teknike për suportin, konstatohet se afati për implementimin e shërbimit të GPS është brenda **5** ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Duke u nisur nga numri i lartë i autoambulancave, i qendrave spitalore dhe vendodhjes së tyre, grupi i auditimit mendon që është e vështirë realizimi i shërbimit brenda 5 ditëve, duke e konsideruar si kriter diskriminues për O.E. të tjerë.
- Përsa i përket dokumentacionit për marrjen në dorëzim të GPS dhe vendosjes së tyre, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni origjinal i procesverbaleve mbi instalimin e pajisjeve por ishin kopje të tyre si dhe këto të fundit rezultuan me korrigjime për sa i përket datës së mbajtjes së tyre.
- A.K. ka lidhur kontratë shërbimi nr. 193/9 dt. 11.05.2022 për 12 muaj për 347 GPS në vlerën 8,744,400 lekë pa tvsh, në të cilën nuk cilësohet afati prej 5 ditësh për implementimin e shërbimit sipas procesverbalit të hartimit të specifikimeve teknike.
- Me qëllim verifikimin mbi funksionimin e sistemit dhe kohën e implementimit të tij, grupi i auditimit kërkoi nga A.K. t'i vihet në dispozicion sistemi i databazës për dy vitet, 2021 dhe 2022. Nga A.K. është vënë në dispozicion databaza për vitin 2022 në formatin Excel, i cili është një format mbi të cilin mund të bëhen ndryshime dhe nuk lihen gjurmë gjatë këtyre ndryshimeve, duke

u konsideruar nga grupi i auditimit si një burim jo i besueshëm për të provuar funksionimin e tij. Problematika e tillë i ka fillesat që në hartimin e specifikimeve teknike dhe në lidhjen e kontratës, që për të garantuar vazhdimin e shërbimit duhej të ishte përpiluar në formën e një SLA, Marrëveshje në Nivel Shërbimi.

- Gjatë analizimi të databazës së mësipërme vihet re që edhe pse janë mbajtur procesverbalet në data 12, 13, 14, 15 dhe 16 Maj, shërbimi me GPS për Autoambulancat ka rekorde që datojnë nga 11 Maj, O.E. fitues të ketë përdorur të njëjtët GPS të huazuar nga O.E. i mëparshëm.
- Gjatë analizimit të databazës vihet re që ½ e autoambulancave gjatë periudhës nën shërbim nuk kanë lëvizur ose kanë rekorde lëvizjeje disa metra në muaj, ku pas intervistimit me komisionin e ndjekjes së kontratës, pjesa më e madhe shprehen se janë në servis dhe është e vështire kontrolli i tyre pasi nuk janë në pronësinë e QKUM-së, gjë që vështirëson ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe pagesat e kryera për ambulancat të cilat nuk janë në funksion, ku pagesa mujore për një autoambulancë është në vlerën 2,100 lekë pa TVSH.

| **4. Titulli i gjetjes:** | Anomali në zhvillimin e procedurës së prokurimit “Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat” 2022. |
|---|---|
| **Situata:** | Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat” 2022, gjatë verifikimit të testimit të tregut dhe ofertave të marra në treg, vihet re që formati i marrjes së ofertave është i njëjtë për të gjithë operatorët dhe nuk mund të merret oferta në treg duke u nisur vetëm nga objekti i kontratës “Shërbim GPS dhe monitorim për Autoambulancat”, duke mos qenë në dijeni se në përshkrimin e mallrave përfshihen GPS për automjete, sistemi audio-video, kamera, software, PC për monitorimin të cilat kanë specifikime të veçanta teknike. Pra, nga NJ.P. nuk është për bërë përshkrim i plotë i procedurës së prokurimit përpara marrjes së ofertave. Gjithashtu, nga NJ.P., njëkohësisht grupi për llogaritjen e fondit limit të kontratës, nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë Institucioni sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.<br>Specifikimet teknike për GPS dhe kamera të vendosura nga A.K. kanë një ngjashmëri të theksuar me specifikimet e katalogut të OE fitues. Gjithashtu një pjesë e specifikimeve teknike janë të ekzagjeruara dhe nuk mund të verifikohen nga anëtarët e KVO-së dhe të atyre të marrjes në dorëzim si dhe kanë një vlerë fikse duke mos përdorur termat ekuivalente, si më poshtë:<br><br>Specifikimet teknike për GPS: bateri rezerve (400 mAh/1.5 V); konsumi i Energjisë 8mA; orët e punës-47 orë në opsionin e ruajtjes së energjisë dhe 4.7 orë në gjendje pune normale; memorie 8M byte; sensitiviteti -161Db; saktësia e pozicionit 2.5m<br>Specifikmite tenike të kamerës: Konsumi i Energjisë 25mA; Rezistenca e Brendshme 3.6R; Baud Rate 115200bps<br><br>Në hartimin e specifikimeve teknike nga A.K. në një pikë citohet “Në çdo qendër spitalore kompania do të krijojë mundësinë e monitorimit të |

Nested table inside the cell above:

| Specifikimet teknike për GPS | Specifikmite tenike të kamerës |
|---|---|
| bateri rezerve (400 mAh/1.5 V) | Konsumi i Energjisë 25mA |
| konsumi i Energjisë 8mA | Rezistenca e Brendshme 3.6R |
| orët e punës-47 orë në opsionin e ruajtjes së energjisë dhe 4.7 orë në gjendje pune normale | Baud Rate 115200bps |
| memorie 8M byte | |
| sensitiviteti -161Db | |
| saktësia e pozicionit 2.5m | |

| | |
|---|---|
| | ambulancave që i përkasin çdo drejtorie" dhe nuk jepen shpjegime më të detajuara se si do të krijohet ky monitorim në çdo qendër spitalore.<br>Në hartimin e specifikimeve teknike për suportin, konstatohet se afati për implementimin e shërbimit të GPS është brenda **5** ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Duke u nisur nga numri i lartë i autoambulancave, i qendrave spitalore dhe vendodhjes së tyre, grupi i auditimit mendon që është e vështirë realizimi i shërbimit brenda 5 ditëve, duke e konsideruar si kriter diskriminues për O.E. të tjerë. |
| **Kriteri:** | Nenin 36 "Specifikimet Teknike", Ligji nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Pengon konkurrencën e drejtë. |
| **Shkaku:** | Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta diskriminuese. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllogaritet drejtë fondi limit. |

**Për sa më sipër**, ngarkohen me përgjegjësi:
Z. K. R., Znj. J. R. dhe Znj. J. H. në cilësinë e komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike

| | |
|---|---|
| **5. Titulli i gjetjes:** | Anomali gjatë marrjes në dorëzim të procedurës së prokurimit "Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat" 2022. |
| **Situata:** | Përsa i përket dokumentacionit për marrjen në dorëzim të GPS dhe vendosjes së tyre, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni origjinal i procesverbaleve mbi instalimin e pajisjeve por ishin kopje të tyre si dhe këto të fundit rezultuan me korrigjime për sa i përket datës së mbajtjes së tyre.<br>A.K. ka lidhur kontratë shërbimi nr. 193/9 dt. 11.05.2022 për 12 muaj për 347 GPS në vlerën 8,744,400 lekë pa tvsh, në të cilën nuk cilësohet afati prej 5 ditësh për implementimin e shërbimit sipas procesverbalit të hartimit të specifikimeve teknike.<br>Me qëllim verifikimin mbi funksionimin e sistemit dhe kohën e implementimit të tij, grupi i auditimit kërkoi nga A.K. t'i vihet në dispozicion sistemi i databazës për dy vitet, 2021 dhe 2022. Nga A.K. është vënë në dispozicion databaza për vitin 2022 në formatin Excel, i cili është një format mbi të cilin mund të bëhen ndryshime dhe nuk lihen gjurmë gjatë këtyre ndryshimeve, duke u konsideruar nga grupi i auditimit si një burim jo i besueshëm për të provuar funksionimin e tij. Problematika e tillë i ka fillesat që në hartimin e specifikimeve teknike dhe në lidhjen e kontratës, që për të garantuar vazhdimin e shërbimit duhej të ishte përpiluar në formën e një SLA, Marrëveshje në Nivel Shërbimi.<br>Gjatë analizimi të databazës së mësipërme vihet re që edhe pse janë mbajtur procesverbalet në data 12, 13, 14, 15 dhe 16 Maj, shërbimi me |

| | |
|---|---|
| | GPS për Autoambulancat ka rekorde që datojnë nga 11 Maj, O.E. fitues të ketë përdorur të njëjtët GPS të huazuar nga O.E. i mëparshëm.<br>Gjatë analizimit të databazës vihet re që ½ e autoambulancave gjatë periudhës nën shërbim nuk kanë lëvizur ose kanë rekorde lëvizjeje disa metra në muaj, ku pas intervistimit me komisionin e ndjekjes së kontratës, pjesa më e madhe shprehen se janë në servis dhe është e vështire kontrolli i tyre pasi nuk janë në pronësinë e QKUM-së, gjë që vështirëson ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe pagesat e kryera për ambulancat të cilat nuk janë në funksion, ku pagesa mujore për një autoambulancë është në vlerën 2,100 lekë pa TVSH. |
| **Kriteri:** | Nenin 107 "Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Ndikim në cilësinë dhe zbatimin e shërbimit. |
| **Shkaku:** | Koha e shkurtër për implementimin e një shërbimi të shtrirë në qytete të ndryshme. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, në rastet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, përvec hartimit të procesverbale dhe firmosjes së tyre, të bëjnë të mundur verifikimin e detajuar të mallrave/shërbimeve nëse janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe brenda datës së kërkuar për implementimin e shërbimit në këtë rast. Gjithashtu, përsa i përket funksionimit të ambulancave duke mos krijuar hapësira për përdorim të fondeve pa 3E (efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet), për një menaxhim sa më të mirë dhe më efektiv, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të bëjnë të mundur alokimin e urgjencave mjekësore (Staf + Ambulanca) në pronësi dhe menaxhim të QKUM. |

**Për sa më sipër**, ngarkohen me përgjegjësi:
Z.K. R., Zj. J. R. dhe Zj. J. H. në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratës për mallrat

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.05* , datë 16.03.2023

- **"Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi te sistemit te pajisjeve teknologjike te QKUM"**

**Përshkrimi i procedurës**
Kërkesë për shërbimin e mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të pajisjeve teknologjike të QKUM-së duke përfshirë disa zëra. A.K. do të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes profilaktike për pastrimin, larjen e filtrave të kondicionerëve dhe serpentinave të fankolinave çdo tre muaj. Kontrolli i presionit të gazit dhe mbushja me gaz sipas nivelit të kërkuar, do të jetë sipas nevojave. Kontrolli i chilerave dhe sistemit të tyre, shërbimet e mirëmbajtjes preventive të tyre janë parashikuar një herë në katër muaj. Riparimet e tjera dhe zëvendësimi i pjesëve të këmbimit do të kryhet sipas nevojave, vetëm në rast defekti, sipas zërit dhe sasisë së nevojshme.

**Fondi Limit**

Fondi limit në vlerën 19,516,800 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

**Përmbledhja e procedurës në tabelë**

| | | |
|---|---|---|
| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt** *"Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi te sistemit te pajisjeve teknologjike te QKUM"* | | |
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 90, datë 10.05.2021 | | |
| **1. Lloji i procedurës së Prokurimit**<br>Procedurë e Hapur e thjeshtuar<br>Marrëveshje kuadër | **2. Njësia e Prokurimit**<br>Urdhër nr. 89 Prot., dt. 06.05.2021<br>Znj. L. M.<br>Znj. A. R.<br>z. B. A. | **3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike**:<br>Znj. L. M.<br>Znj. A. R.<br>z. B. A. |
| **4. Fondi limit (pa tvsh)**<br>1,985,400 lekë | **5. Burimi i Financimit**<br>Buxheti i shtetit | **6. Data e hapjes së tenderit**<br>24.05.2021 |
| **7. Operatorët Ekonomikë**<br>**a) Pjesëmarrës**<br>"A.." sh.p.k me ofertë 1,199,960 lekë pa tvsh<br>"S.. K..." sh.p.k. me ofertë 1,470,800 lekë pa tvsh<br>"M. N." P.F. me ofertë 1,620,170 lekë pa tvsh.<br>• b) kualifikuar:<br>"M. N." P.F. me ofertë 1,620,170 lekë pa tvsh. | **8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**<br>Urdhër nr 91 Prot., datë 10.05.2021<br>Znj. G. V.<br>Z. K. R.<br>Znj. N. D. | **9. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>1,620,170 lekë |
| **10. Data e lidhjes së kontratës**<br><br>Marrëveshje kuadër nr. 264/6 dt. 06.07.2021<br>Kontratë shërbimi nr. 264/8 dt. 09.07.2021<br>Kontratë shërbimi nr. 264/11 dt. 14.10.2021 | **11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>365,230 lekë | **12. Ankimime**<br>S... K... shpk me nr. 212 Prot., dt. 08.06.2021<br>Kthim përgjigje:<br>Nr. 312/4 Prot., dt. 09.06.2021 |
| **13.Struktura për ndjekjen e kontratës**<br>**Urdhër nr. 125 Prot., datë 28.07.2021**<br>Z. D. H.<br>z. E. Gj.<br>z. E. A. | **14. Fletë hyrja** | **15. Afati i kontratës**<br>24 muaj |
| **16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi**<br>15/2021 dt. 04.08.2021<br>30/2021 dt. 19.10.2021 | **17. Likuiduar deri dt**<br>Nr. 209 Prot., dt. 16.08.2021 1,169,364 lekë me tvsh.<br>Nr. 282 Prot. Dt. 28.10.2021 672,660 lekë me tvsh | |

Përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 1,985,400 lekë, pas çmimit mesatar të ofruar nga tre operatorët ekonomik (çmimi për 380 GPS për 24 muaj), përkatësisht:
"I.S.T" sh.p.k në vlerën 1,982,000 lekë pa tvsh;
"P. L." shpk në vlerën 1,975,200 lekë pa tvsh;
"D. R." shpk në vlerën 1,999,000 lekë pa TVSH.
Me relacionin protokolluar me nr. 264/1 Prot., datë 10.05.2021, komisioni i NJ.P. dhe përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar vlerën 1,985,400 lekë pa tvsh.

Sipas procesverbalit për vlerësimin e ofertave, O.E. pjesëmarrës në garë ishin:
"A." sh.p.k me ofertë 1,199,960 lekë pa tvsh
"S. K." sh.p.k. me ofertë 1,470,800 lekë pa tvsh
"M. N." P.F. me ofertë 1,620,170 lekë pa tvsh.

| | |
|---|---|
| **6. Titulli i gjetjes:** | Anomali në zhvillimin e procedurës së prokurimit “Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi te sistemit te pajisjeve teknologjike te QKUM”. |
| **Situata:** | Nga ofertat e sjella nga O.E. garues, oferta e sjellë nga O.E. “A.” sh.p.k., prej 1,199,960 lekë pa tvsh, u shpall ofertë anomalisht e ulët dhe me anë të kërkesës nr. 26.05.2021 nga K.V.O, u kërkuar sqarim për çmimet dhe koston e propozuar në ofertë. O.E. “A..” sh.p.k. me anë të shkresës nr. 2905 Prot., datë 29.05.2021 ka paraqitur shpjegimin përkatës me të gjithë dokumentacionin e plotë mbi arsyet e dhënies së ofertës si më poshtë:<br>- Analiza çmimesh<br>- Fatura materialesh<br>- Autorizime distributori<br>- Deklaratë konformiteti<br>- Leje mjedisore<br>- Deklaratë nr i pun. + list pagesash<br>- Certifikatë e sigurisë në kantier<br>- Certifikatë auditor për sistemet e menaxhimit të energjisë<br>- Drejtues teknik<br>- Certifikata ISO-A.. sh.p.k.<br>- Licensa e shoqërisë.<br>Nga ana e K.V.O. nuk ka dokumentacion në lidhje me analizimin e shkresës së sjellë nga O.E.<br>Pas analizimeve të dokumentacionit të sjellë nga O.E. i mësipërm, grupi i auditimit mendon që oferta e sjellë nga O.E. duhej të ishte marrë për bazë pas shpjegimit të saj dhe O.E. i mësipërm duhej të ishte shpallur fitues. Nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, vlera prej **420,210 lekë pa tvsh**, si diferencë midis O.E. fitues dhe këtij të fundit që duhej të ishte shpallur fitues, është përdorur pa 3E.<br>Gjatë analizimit mbi mënyrën e likuidimit dhe zbatimit të kontratës vihet re që vlera e kontratës është likuiduar nga dy pagesa, ku pagesa e fundit mban datën 28.10.2021, që nënkupton që për periudhën e mbetur deri në 06.07.2022 mbetet e pa mbuluar me shërbim.<br>Kjo vjen për arsye se mënyra e likuidimit dhe procesverbaleve duhej të ishte hartuar sipas specifikimeve teknike të kërkuar në fillim, të cilat nuk janë cituar në kontratat respektive, si më poshtë:<br>Kryerja e shërbimit dhe mirëmbajtjes profilaktike për pastrimin, larjen e filtrave të kondicionerëve dhe serpentinave të fankoilave çdo tre muaj. Kontrolli i presionit të gazit dhe mbushja me gaz sipas nivelit të kërkuar, do të jetë sipas nevojave.<br>Kontrolli i chillerave dhe sistemit të tyre, shërbimet e mirëmbajtjes preventive të tyre janë parashikuar një herë në katër muaj.<br>Hapja e chillerave, pastrim me solucion, pastrim i filtrit të ujit dhe të gazit, kontroll i presionit të gazit çdo 4 muaj. |
| **Kriteri:** | Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Pengon konkurrencën e drejtë. |
| **Shkaku:** | Moszbatimi i legjislacionit në fuqi. |

| | |
|---|---|
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, në të ardhmen në përllogaritjen e fondit limit të përdorin mënyrën më efektive të mundshme, si dhe në rastin kur merren oferta në treg nga O.E., të merren nga O.E. të cilët kanë eksperiencë në treg, në mënyrë që të shmangen aludimet mbi fryrjen e fondit limit si dhe në rastin e vlerësimit të ofertave të kryhet vlerësim i drejtë dhe transparent duke u bazuar në bazën ligjore dhe udhëzimet përkatëse si dhe duke i dhënë gjithmonë përparësi ofertave më të ulëta në rast se përmbushin dokumentacionin e plotë të kërkuar dhe në rastin kur oferta është anomalisht e ulët si më sipër, të vlerësohet me kujdes arsyetimi mbi dhënien e një oferte të tillë. |

**Për sa më sipër** ngarkohen me përgjegjësi:
znj. L. M., znj. A. R. dhe z. B. A., në cilësinë e Njësisë e Prokurimit
Znj. G. V., z. K. R., znj. N. D., në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.06* , datë 16.03.2023

- **"Siguracioni i godinës, zyrave dhe pajisjeve të QKUM-së"**

**Përshkrimi i procedurës**
Me shkresë datë 08.03.2022 të Z. B. A., me detyrë specialist investimesh, është bërë kërkesë për për sigurimin e ndërtesës, zyrave e pajisjeve mjekësore.
Asete të paluajtshme, shuma e sigurimit 141,628,963 lekë
Instalime teknike dhe makineri, shuma e sigurimit 182,172,187 lekë
Inventari ekonomik, shuma e sigurimit 40,307,723
**Fondi Limit**
Fondi limit në vlerën 4,460,000 (katër milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

**Përmbledhja e procedurës në tabelë**

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zhvillmi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Siguracion i godinës, zyrave, dhe pajisjeve" 2022</td></tr>
<tr><td colspan="3">1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 72, datë 10.03.2022</td></tr>
<tr><td>1. Lloji i procedurës së Prokurimit<br>Procedurë e Hapur e thjeshtuar</td><td>2. Njësia e Prokurimit<br>znj. L. Zh.<br>Znj. N. D.<br>z. K. R.</td><td>3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike:<br>znj. L. Zh.<br>Znj. N. D.<br>z. K. R.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi limit (pa tvsh)<br>4,460,000 lekë</td><td>5. Burimi i Financimit<br>Buxheti i shtetit</td><td>6. Data e hapjes së tenderit<br>16.03.2022(publikimi) 28.03.2022 (zhv)</td></tr>
<tr><td>7. Operatorët Ekonomikë<br>a) Pjesëmarrës<br>Albasig sh.a 4,427,500 lekë<br>• b) kualifikuar:<br>Albsig sh.a 4,427,500 lekë</td><td>8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave<br>Znj. G. V.<br>Z. K. C.<br>zj. A. Xh.</td><td>9. Oferta fituese (pa tvsh)<br>4,427,500 lekë</td></tr>
<tr><td>10. Data e lidhjes së kontratës<br>Kontratë shërbimi nr. 186/7 datë 06.04.2022</td><td>11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)<br>32,500 lekë</td><td>12. Ankimime<br>S'ka</td></tr>
<tr><td>13.Struktura për ndjekjen e kontratës<br>Z.B. A.<br>Zj. M. D.<br>Zj. R. Sh.</td><td>14. Fletë hyrja<br><br>Shërbim</td><td>15. Afati i kontratës<br>12 muaj (06.04.2023)</td></tr>
</table>

| 16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi 39369/2022 dt. 06.04.2022 | 17. Likuiduar deri dt Nr. 90 Datë 12.04.2022 Vlera 4,427,500 lekë pa tvsh | |
|---|---|---|

Për përllogaritjen e fondit limit, nga ana e Autoriteti Kontraktor (këtu e tutje A.K.) është kryer testimi i tregut pas marrjes së ofertave nga tre operatorët ekonomikë (këtu e tutje O.E.):
“A.” sh.a. në vlerën 4,380,000 lekë pa tvsh;
“S. I. Vi. Insurance Group” sh.a. në vlerën 4,550,000 lekë pa TVSH dhe “E.” sh.a. në vlerën 4,450,000 lekë pa tvsh.
Me relacionin protokolluar më datë 11.03.2022, Komisioni i NJP dhe përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar vlerën 4,460,000 lekë pa tvsh.
Pas zhvillimit të procedurës së mësipërme të prokurimit, ku pjesëmarrës ishte vetëm një O.E. “A.” sh.a., me anë të formularit të njoftimit të fituesit me nr. 186/6 Prot., datë 29.03.2022, u shpall fitues O.E. i sipërcituar me ofertë 4,427,500 lekë pa tvsh.

| **7. Titulli i gjetjes:** | Anomali gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Siguracion i godinës, zyrave, dhe pajisjeve” 2022. |
|---|---|
| **Situata:** | **Në pikën 2.2** të procesverbalit të Hartimit të Specifikimeve Teknike, nga A.K., kërkohet që O.E. duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3(tre) viteve të fundit, ku vlera e xhiros mesatare vjetore për tre vitet e fundit duhet **të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit** të kontratës që po prokurohet në mospërputhje me shkronjën c[3], pika 2, Neni 43 dhe pikën 4[4], Neni 55, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu për kapacitetin teknik, nga A.K. kërkohet që O.E. të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë ***sa 20%*** të vlerës së përllogaritur të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit në mospërputhje me shkronjën ”b”[5], pika 4, Neni 55, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.<br>Në hartimin e Specifikimeve Teknike nuk janë detajuar zërat të cilët do të mbulohen nga siguracioni (ndërtesa, instalime teknike e makineri, inventari ekonomik), si minimum për përcaktimin e vlerës që mbulon çdo kategori si dhe dhënien e ofertave nga O.E. të interesuar.<br>Oferta e sjellë nga O.E. fitues është në shumën 4,427,000 lekë pa tvsh, shumë e cila ndryshon nga oferta e sjellë nga i njëjti O.E. në shumën 4,380,000 lekë pa tvsh gjatë përllogaritjes së fondit limit, me diferencë prej 47,000 lekë pa tvsh, duke mos dhënë arsyet përkatëse, gjë që fakton dhe gjetjen cituar nga grupi i auditimit mbi atë se çfarë përfshihet në kategoritë ndërtesa, zyra dhe pajisje mjekësore.<br>Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit se çfarë mbulojnë kategoritë (ndërtesa, instalime teknike e makineri, inventari ekonomik) rezultoi që në kategorinë instalime teknike e makineri që përkon me llogarinë 214 në |

[3] vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

[4] Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

[5] vlera totatle e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

| | |
|---|---|
| | pasqyrat financiare përfshihen software (program financiar; sistem virtualizimi; sistem operimi për server; firewall; software për back up; software për database; software për sistem kartografis; software aplikativ për urgjencë; instrumente përkthimi, konfigurimi, trajnimi; software për raport statistika; realizimi i faqe web) të cilat janë programe që në kategorinë e rrezikut nuk mbulohen nga siguracioni, gjë që konstatohet edhe në policen e sigurimit të operatorit fitues nr. serial 220904668 datë 06.04.2022. Vlera e software që është përfshirë në kategorinë pajisje mjekësore është në vlerën 102,934,464 lekë, ndërkohë vlera e sigurimit të saj është **1,235,213 lekë** (102,934,464 lekë X 0.012), që përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit. |
| **Kriteri:** | Neni 23 *"Specifikimet Teknike"*, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Dëm në buxhetin e shtetit. |
| **Shkaku:** | Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta jo në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke krijuar hapësirë për zhvillimin e një gare të ndershme dhe konkurruese QKUM, si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllogaritet drejtë fondi limit dhe ofertat e dhëna, ku duke u nisur nga kjo i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm në vlerën prej **1,235,213 lekë** dhe të bëhet e mundur alokimi i kësaj shume. |

**Për sa më sipër**, ngarkohen me përgjegjësi:

Njësia e hartimit e specifikimeve teknike dhe e përllogaritjes së fondit limit znj. L. Zh., Znj. N. D., z. K. R..

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.07* , datë 16.03.2023

- **Blerje Set urgjence 2021**

**Përshkrimi i procedurës**
Me shkresë datë 21.07.2021 të njësisë së koordinimit (Z. K. C. dhe Z. I. J.), është bërë kërkesë për blerje set urgjence për shërbimin e urgjencës mjekësore për nevojat e shërbimit të urgjencës mjekësore, përfshirë arsyen e përhapjes së Covid-19 dhe nevojave të urgjencës referuar verifikimit në terren të autoambulancave në vitin 2018.

**Fondi Limit**
Fondi limit në vlerën 21,876,033 (njëzet e një milion e tetëqind shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tridhjete e tre) lekë pa TVSH.

## Përmbledhja e procedurës në tabelë

| a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt *"Blerje Set Urgjence" 2021* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr.123, datë 26.07.2021 | | |
| **1. Lloji i procedurës së Prokurimit**<br>Procedurë e Hapur | **2. Njësia e Prokurimit**<br>Znj. L. M.<br>z. K. C.<br>znj. A. R. | **3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike**:<br>Znj. L. M.<br>z. K. C.<br>znj. A. R. |
| **4. Fondi limit (pa tvsh)**<br>21,876,033 lekë | **5. Burimi i Financimit**<br>Buxheti i shtetit | **6. Data e hapjes së tenderit**<br>26.08.2021 |
| **7. Operatorët Ekonomikë**<br>**a) Pjesëmarrës**<br>F..F.. shpk 750,000 lekë<br>G..-Al... shpk 21,473,500 lekë<br>• **b) kualifikuar:**<br>G..-A.... shpk 21,473,500 lekë | **8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**<br>Znj. G. V.<br>Zj. J. H.<br>Z. I. J. | **9. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>21,473,500 lekë |
| **10. Data e lidhjes së kontratës**<br>Kontratë Nr. 415/5 datë 14.10.2021 | **11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>402,533 lekë | **12. Ankimime**<br>Nuk Ka |
| **13.Komisioni i marrjes në dorëzim**<br>Zj. A. Xh.<br>Z.Ll. K.<br>Z. K. I. | **14. Fletë hyrja**<br>34 dt 26.11.2021<br>34/1 dt. 26.11.2021<br>34/2 dt. 26.11.2021<br>34/3 dt. 26.11.2021<br>34/3 dt. 26.11.2021<br>34/5 dt. 26.11.2021<br>34/6 dt. 26.11.2021 | **15. Afati i kontratës**<br>45 ditë |
| **16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi**<br>348/2021 dt. 26.11.2021 | **17. Likuiduar deri dt**<br>Nr. 336 dt. 21.12.2021<br>për vlerën 25,768,200 lekë me tvsh | |

Përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 21,876,033 lekë, pas çmimit mesatar të ofruar nga tre operatorët ekonomik:
"G.-A." Shpk në vlerën 21,718,000 lekë pa tvsh;
"E." Shpk në vlerën 20,300,600 lekë pa tvsh;
"OES D." Shpk në vlerën 23,609,500 lekë lekë pa tvsh.
Me relacionin protokolluar më datë 15.10.2021, komisioni i NJ.P. dhe përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar vlerën 21,876,033 lekë pa TVSH për fondin limit të procedurës së mësipërme.

| | |
|---|---|
| **8. Titulli i gjetjes:** | Anomali në zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Set urgjence". |
| **Situata:** | Bashkëlidhur kërkesës për zhvillimin e procedurës së prokurimit, nuk ka asnjë procesverbal të mbajtur, lidhur me nevojat e ambulancave për sete urgjence.<br>Për disa nga artikujt, mungojnë certifikatat e ISO 9001:2015 apo ISO 13485:2016 ose ekuivalente e prodhuesit. Konkretisht nga prodhuesi Romed mungon certifikata për artikullin fasho autoadezive, ndërsa nga Gima mungon certifikata për artikujt paketa dizifektuese dhe chlorhexidine. Gjithashtu, në certifikatat e paraqitura nga OE për produktet e prodhuesit Romed, mungon përkthimi në gjuhën shqipe të emrit të artikullit, gjë që e vështirëson identifikimin korrekt të artikullit të certifikuar. |
| **Kriteri:** | Nenin 36 "Specifikimet Teknike", Ligji nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". |

| | |
|---|---|
| **Ndikimi/Efekti:** | Pengon konkurrencën e drejtë. |
| **Shkaku:** | Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta diskriminuese. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, në të ardhmen të marrë parasysh që zhvillimi i procedurave të prokurimit iniciohet fillimisht nga një nevojë që i lind institucionit e cila hartohet në mënyrë të detajuar dhe regjistrohet në regjistrin e parashikimeve ku në bazë të fondeve dhe rëndësisë që ka kjo nevojë zhvillohet nga ana e institucioni si dhe në rastin e vlerësimit të ofertave të tregohet kujdes që mallrat/shërbimet e ofruara nga O.E. pjesëmarrës të përkojnë me ato të kërkuara në specifikimet teknike nga ana e A.K. |

**Për sa më sipër** ngarkohen me përgjegjësi:
Njësia e hartimit e specifikimeve teknike dhe e përllogaritjes së fondit limit znj. L. M., Znj. K. C., znj. A. R.

| | |
|---|---|
| **9. Titulli i gjetjes:** | Anomali në zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Set urgjence". |
| **Situata:** | Disa nga specifikimet teknike nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës. Konkretisht, në katalogun e paraqitur nga fituesi, nuk përcaktohet përqindja e kërkuar në specifikimet teknike të AK të artikullit klorhexidin 5%. Nuk gjenden në katalogun e paraqitur nga OE fitues artikujt piastra adulte dhe piastra pediatrike të përputhshme për defibrilatorët Primedic dhe Rescue Life. Për artikullin maska silikoni, nga AK janë kërkuar 6 përmasa të ndryshme, ndërkohë në katalog janë paraqitur vetëm 4 përmasa. Për artikullin maskë oksigjeni me rezervuar, është kërkuar nga AK me përqindje të mesme, ndërkohë në katalogun e OE fitues është paraqitur maskë silikoni me përqindje të lartë. Për artikullin mushama (telo) janë kërkuar nga AK Përmasat 200X150cm, ndërkohë në katalogun e fituesit është paraqitur mushama telo me përmasa 180X76 cm. Nga AK, për artikullin doreza sterile janë kërkuar në përmasa të ndryshme, ndërsa në katalog është paraqitur vetëm në masën S (masë e vogël). |
| **Kriteri:** | Nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Pengon konkurrencën e drejtë. |
| **Shkaku:** | Mospërputhja e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara nga ana e A.K. me atë që ka ofruar O.E. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, në të ardhmen të marrë parasysh që zhvillimi i procedurave të prokurimit iniciohet fillimisht nga një nevojë që i lind institucionit e cila hartohet në mënyrë të detajuar dhe regjistrohet në regjistrin e parashikimeve ku në bazë të fondeve dhe rëndësisë që ka kjo nevojë zhvillohet nga ana e institucioni si dhe në rastin e vlerësimit të ofertave të tregohet kujdes që mallrat/shërbimet e ofruara nga O.E. pjesëmarrës të përkojnë me ato të kërkuara në specifikimet teknike nga ana e A.K. |

**Për sa më sipër** ngarkohen me përgjegjësi:
Znj. G. V., Znj. J. H. dhe Z. I. J. në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.08* , datë 16.03.2023.

- **"Blerje Set urgjence" 2022**

**Përshkrimi i procedurës**
Me shkresë datë 26.08.2022 të Z. K. C. dhe Z. I. J., është bërë kërkesë për blerje set urgjence për shërbimin e urgjencës mjekësore për nevojat e shërbimit të urgjencës mjekësore. Ku ndër të tjera bëhet me dije edhe se: "nevojat e konkrete të shërbimit të urgjencës mjekësore në terren, pas verifikimit të nevojave të autoambulancave që ishin pothuajse të paplotësuara me elementet bazike për funksionimin e tyre dhe shpëtimin e jetës së qytetarit, si edhe pas blerjes së seteve të urgjencës mjekësore në vitin 2018, ka autoambulanca të paplotësuara me sete, si dhe konsumimi i këtyre seteve".

**Fondi Limit**
Fondi limit në vlerën 13,120,500 (trembëdhjetë milionë e njëqind e njëzet mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

**Përmbledhja e procedurës në tabelë**

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt *"Blerje Set Urgjence" 2022*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr.239, datë 29.08.2022 | | |
| **1. Lloji i procedurës së Prokurimit**<br>Procedurë e Hapur | **2. Njësia e Prokurimit**<br>Znj. L. M.<br>Z. K. C.<br>Znj. J. R. | **3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike**:<br>Znj. L. M.<br>Z. K. C.<br>Znj. J. R. |
| **4. Fondi limit (pa tvsh)**<br>13,120,500 lekë | **5. Burimi i Financimit**<br>Buxheti i shtetit | **6. Data e hapjes së tenderit**<br>26.08.2021 |
| **7. Operatorët Ekonomikë**<br>**a) Pjesëmarrës**<br>G..-A... shpk 12,990,000 lekë<br>• **b) kualifikuar:**<br>G..-A.... shpk 12,990,000 lekë | **8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**<br>Znj. G. V.<br>Zj. J. H.<br>Z. I. J. | **9. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>12,990,000 lekë |
| **10. Data e lidhjes së kontratës**<br>Kontratë mallrash nr. 606/7 datë 07.10.2022 | **11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>130,500 lekë | **12. Ankimime**<br>Nuk ka |
| **13.Komisioni i marrjes në dorëzim**<br>Zj. V. F.<br>Z. Ll. K.<br>Znj. A. K. | **14. Fletë hyrja** | **15. Afati i kontratës**<br>45 ditë |
| **16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi** | **17. Likuiduar deri dt** | |

Përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 13,120,500 lekë, pas çmimit mesatar të ofruar nga tre operatorët ekonomik "G.-A." sh.p.k në vlerën 12,990,000 lekë pa TVSH, "E." sh.p.k në vlerën 11,850,750 lekë pa TVSH, "M." sh.p.k në vlerën 14,520,750 lekë lekë pa TVSH. Me relacionin protokolluar më datë 31.08.2022, komisioni i NJP dhe përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar vlerën 13,120,500 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit së mësipërme u konstatua:

· Me shkresë datë 26.08.2022 të Z. K. C. dhe Z. I. J., është bërë kërkesë për blerje set urgjence për shërbimin e urgjencës mjekësore për nevojat e shërbimit të urgjencës mjekësore, ku ndër të tjera bëhet me dije edhe se: "nevojat e konkrete të shërbimit të urgjencës mjekësore në terren, pas verifikimit të nevojave të autoambulancave që ishin pothuajse të paplotësuara me elementet bazike për funksionimin e tyre dhe shpëtimin e jetës së qytetarit, si edhe pas blerjes së seteve të urgjencës mjekësore në vitin 2018, ka autoambulanca të paplotësuara me sete, si dhe konsumimi i këtyre seteve". Në kërkesën e të dyja procedurave të prokurimit "Blerje sete urgjence 2021" dhe "Blerje sete urgjence 2022" konstatohet e njëjta përmbajtje sa i takon nevojave të urgjencës referuar verifikimit në terren të autoambulancave në vitin 2018. Bashkëlidhur kërkesës, nuk ka asnjë dokument të mbajtur në terren (proces verbale të mbajtur konkretisht në çdo qendër spitalore) në vitin 2018, lidhur me nevojat e ambulancave për sete urgjence, si edhe fakt është që në vitin 2021 është prokuruar dhe lidhur kontratë publike mallrash për këto sete, në vlerën 21,876,033 lekë pa tvsh. Referuar kësaj të fundit, nuk është bërë argumentim për vitin 2022, sa i takon numrit të autoambulancave që janë të pajisura me sete urgjence nga viti i kaluar, sa janë konsumuar dhe sa prej tyre nuk i kanë.

| **10. Titulli i gjetjes:** | Anomali në zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Set urgjence" 2022. |
|---|---|
| **Situata:** | **Në pikën 2.3.1** për të provuar përvojën e mëparshme, nga AK kërkohet që OE të paraqesë dëshmi për furnizimet të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **sa 40%** të vlerës së përllogaritur të fondit limit të kësaj kontrate, në mospërputhje me *pikën 4*[6] *të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*<br>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në hartimin e specifikimeve teknike një pjesë e madhe e artikujve të ilustruara me foto ka ngjashmëri absolute me artikujt e paraqitur në katalogun e sjellë nga O.E. fitues.<br>Për artikujt të paraqitur në katalogun e OE fitues të Kompanisë T. (artikujt 67-68) mungon përkthimi në gjuhën shqipe, për të cilat mungojnë certifikatat e ISO 9001:2015 apo ISO. Gjithashtu, nga prodhuesi Romed mungon certifikata për artikullin fasho autoadezive, ndërsa nga Gima mungon certifikata për artikujt paketa dizifektuese dhe chlorhexidine.<br>Disa nga specifikimet teknike nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës. Konkretisht, në katalogun e paraqitur nga fituesi, nuk përcaktohet përqindja e kërkuar në specifikimet teknike të AK të artikullit klorhexidin 5%. Nuk gjenden në katalogun e paraqitur nga OE fitues artikujt piastra adulte dhe piastra pediatrike të përputhshme për defibrilatorët Primedic dhe Rescue Life. Për artikullin maska silikoni, nga AK janë kërkuar 6 përmasa të ndryshme, ndërkohë në katalog janë paraqitur vetëm 4 përmasa. Për artikullin maskë oksigjeni me rezervuar, është kërkuar nga AK me përqindje të mesme, ndërkohë në katalogun e |

[6] vlera totale e kërkuar nga AK duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

| | |
|---|---|
| | OE fitues është paraqitur maskë silikoni me përqindje të lartë. Për artikullin mushama (telo) janë kërkuar nga AK Përmasat 200X150cm, ndërkohë në katalogun e fituesit është paraqitur mushama telo me përmasa 180X76 cm. Nga AK, për artikullin doreza sterile janë kërkuar në përmasa të ndryshme, ndërsa në katalog është paraqitur vetëm në masën S (masë e vogël). |
| **Kriteri:** | Nenin 36 "Specifikimet Teknike", Ligji nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Pengon konkurrencën e drejtë. |
| **Shkaku:** | Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta diskriminuese. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke krijuar hapësirë për zhvillimin e një gare të ndershme dhe konkurruese. |

**Për sa më sipër** ngarkohen me përgjegjësi:
Njësia e hartimit e specifikimeve teknike dhe e përllogaritjes së fondit limit znj. L. M., Znj. K. C., znj. J. R.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.08* , datë 16.03.2023.

- **Blerje pajisje mjekësore 2021**

**Përshkrimi i procedurës**
Me shkresë datë 08.10.20021 të njësisë së koordinimit (Z. K. C. dhe Z. I. J.), është bërë kërkesë për blerje pajisjesh mjekësore për shërbimin e urgjencës mjekësore (për standartizuar dhe uniformuar pajisjet që duhen për urgjencat mjekësore), si dhe pas inspektimit që QKUM ka bërë në Spitalet Universitare, Rajonale, Bashkiake dhe Qendrat Shëndetësore me Urgjencë Pritëse.

**Fondi Limit**
Fondi limit në vlerën 5,780,000 (pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH

**Përmbledhja e procedurës në tabelë**

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt** *"Blerje pajisje mjekësore" 2021* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 149, datë 11.10.2021 | | |
| **1. Lloji i procedurës së Prokurimit**<br>Procedurë e Hapur e thjeshtuar | **2. Njësia e Prokurimit**<br>Znj. N. D.<br>z. K. C.<br>znj. F. S. | **3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike**:<br>Znj. N. D<br>z. K. C.<br>znj. F. S. |
| **4. Fondi limit (pa tvsh)**<br>5,780,000 lekë | **5. Burimi i Financimit**<br>Buxheti i shtetit | **6. Data e hapjes së tenderit**<br>08.11.2021 (zhv) 29.10.2021(publikimi) |
| **7. Operatorët Ekonomikë**<br>**a) Pjesëmarrës**<br>E... 5,452,000 lekë<br>• **b) kualifikuar:**<br>E... 5,452,000 lekë | **8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**<br>Znj. G. V.<br>Z. I. J.<br>z. A. Q. | **9. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>5,452,000 lekë |
| **10. Data e lidhjes së kontratës**<br>**Kontratë nr. 479/13 datë 26.11.2021** | **11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>328,000 lekë | **12. Ankimime**<br>Ka |

| Marrëveshje kuadër | | |
|---|---|---|
| **13.Komisioni i marrjes në dorëzim** | **14. Fletë hyrja**<br>Nr. 40 dt. 23.12.2021<br>Nr. 43 dt. 29.12.2021 | **15. Afati i kontratës**<br>30 ditë |
| **16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi**<br>2504/2021 dt. 23.12.2021 | **17. Likuiduar deri dt**<br>Nr. 343 Prot., dt. 24.12.2021 në vlerën 4,552,000 lekë pa tvsh<br>Nr. 349 Prot., dt. 29.12.2021 në vlerën 900,000 lekë pa tvsh | |

Përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 5,780,000 lekë, pas çmimit mesatar për çdo artikull të ofruar nga tre operatorët ekonomik:
"M." Shpk në vlerën 6,018.000 lekë pa TVSH,
"E." Shpk në vlerën 5,810,000 lekë pa TVSH,
"G.A." Shpk në vlerën 5,512,000 lekë pa TVSH.
Me relacionin protokolluar më datë 15.10.2021, komisioni i NJ.P. dhe përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar vlerën 5,780,000 lekë pa TVSH si fond limit i procedurës së mësipërme.

· Në kërkesat për kualifikim "Specifikimet teknike" për pajisjet mjekësore, konkretisht pika II.5 dhe II.6 për manekin PCR infant/perdiatrik dhe ventilator për autoambulanca rezulton se ka një ngjashmëri absolute midis specifikimeve teknike të pajisjeve mjekësore të hartuara nga A.K., me specifikimet teknike të katalogut të sjellë nga Operatori Ekonomik fitues.
· **Në pikën 2.2** nga AK kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3(tre) viteve të fundit, ku vlera e xhiros mesatare vjetore për tre vitet e fundit duhet **të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit** të kontratës që po prokurohet në mospërputhje me shkronjën c[7] të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
· **Në pikën 2.3.** nga AK kërkohet kërkohet që OE të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë ***sa 20%*** të vlerës së përllogaritur të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit në mospërputhje me shkronjën b[8] të pikës 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
· Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:
Për disa nga pajisjet mjekësore, disa nga specifikimet teknike të karrocës me katër rrota me zinxhir dhe fluksometrit nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës

| |
|---|
| **Karrocë transporti me zinxhir per shkalle**<br>Ndenjësja dhe mbështetësja e shpinës të jenë të përbëra nga material rezin termoplastik kundër rreshqitjes.<br>**Përmasat e karrocës:**<br>Gjatësia e hapur me doreza të mbyllura: jo më pak se 900 mm<br>Gjatësia e hapur me doreza të hapura: jo më pak se 1300 mm<br>Gjerësia me dorezat e pasme të hapura: jo më pak se 540 mm<br>Gjerësia me dorezat e pasme të mbyllura: jo më pak se 510 mm<br>Lartësia me dorezat e mbyllura: jo më pak se 940 mm |
| **Fluksimetër**<br>Pesha jo më shumë se 160 g. |

[7] vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës** së parashikuar të kontratës. Ky kriter i cili barazon vlerën e xhiros vjetore me vlerën e fondit limtit ul pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.
[8] vlera totatle e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

· Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohen dy kontrata individuale pune, konkretisht kontrata nr. 465 Prot., datë 29.09.2021 (Zj. F. S. si inxhinier klinik) si dhe kontrata Nr. 479/7 Prot., datë 25.10.2021(Z. A. Q. si inxhinier biomjekësor), për pjesëmarrjen në komisionet e ngritura për procedurën e mësipërme. Punonjësit në fjalë janë punonjës me ngarkesë të plotë në institucionet e tyre përkatëse, atë të Ministrisë së Shëndetësisë. Për lidhjen e kontratave në fjalë dhe pagesave të tyre si ekspertë të fushës është përdorur si referencë ligjore VKM nr.720, datë 29.11.1995, "Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore", vendim i cili më 01.06.2012 është shfuqizuar me VKM nr. 418, datë 27.6.2012 *"Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore",* e shfuqizuar me VKM nr. 656 datë 31.10.2018 *"Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore".*

| **11. Titulli i gjetjes:** | Anomali në zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje pajisje mjekësore". |
|---|---|
| **Situata:** | Në kërkesat për kualifikim "Specifikimet teknike" për pajisjet mjekësore, konkretisht pika II.5 dhe II.6 për manekin PCR infant/perdiatrik dhe ventilator për autoambulanca rezulton se ka një ngjashmëri absolute midis specifikimeve teknike të pajisjeve mjekësore të hartuara nga A.K., me specifikimet teknike të katalogut të sjellë nga Operatori Ekonomik fitues.<br>**Në pikën 2.2** nga AK kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3(tre) viteve të fundit, ku vlera e xhiros mesatare vjetore për tre vitet e fundit duhet **të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit** të kontratës që po prokurohet në mospërputhje me shkronjën c[9] të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>**Në pikën 2.3.** nga AK kërkohet kërkohet që OE të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë ***sa 20%*** të vlerës së përllogaritur të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit në mospërputhje me shkronjën b[10] të pikës 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se: |
| **Kriteri:** | Nenin 36 "Specifikimet Teknike", Ligji nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Pengon konkurrencën e drejtë. |
| **Shkaku:** | Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta diskriminuese. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |

[9] vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës** së parashikuar të kontratës. Ky kriter i cili barazon vlerën e xhiros vjetore me vlerën e fondit limtit ul pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

[10] vlera totatle e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

| | |
|---|---|
| **Rekomandimi:** | QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke krijuar hapësirë për zhvillimin e një gare të ndershme dhe konkurruese. |

**Për sa më sipër** ngarkohen me përgjegjësi:
Njësia e hartimit e specifikimeve teknike dhe e përllogaritjes së fondit limit znj. N. D., z. K. C., znj. F. S.

| | |
|---|---|
| **12. Titulli i gjetjes:** | Mospërputhje e mallrave të marrë në dorëzim me atë të kërkuar nga ana e A.K. |
| **Situata:** | Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:<br>Për disa nga pajisjet mjekësore, disa nga specifikimet teknike të karrocës me katër rrota me zinxhir dhe fluksometrit nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës.<br><br>**Karrocë transporti me zinxhir per shkalle**<br>Ndenjësja dhe mbështetësja e shpinës të jenë të përbëra nga material rezin termoplastik kundër rreshqitjes.<br>**Përmasat e karrocës:**<br>Gjatësia e hapur me doreza të mbyllura: jo më pak se 900 mm<br>Gjatësia e hapur me doreza të hapura: jo më pak se 1300 mm<br>Gjerësia me dorezat e pasme të hapura: jo më pak se 540 mm<br>Gjerësia me dorezat e pasme të mbyllura: jo më pak se 510 mm<br>Lartësia me dorezat e mbyllura: jo më pak se 940 mm<br>**Fluksimetër**<br>Pesha jo më shumë se 160 g. |
| **Kriteri:** | Nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Mallra të cilët nuk plotësojnë kushtet. |
| **Shkaku:** | Nuk janë marrë parasysh specifikimet e kërkuara nga ana e AK. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, në rastet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, përvec hartimit të procesverbale dhe firmosjes së tyre, të bëjnë të mundur verifikimin e detajuar të mallrave/shërbimeve nëse janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. |

**Për sa më sipër** ngarkohen me përgjegjësi:
Znj. G. V., z. I. J. dhe z. A. Q. në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.02* , datë 13.01.2023.

- **"Blerje set uniforme dhe elementë përbërëse të tyre" për urgjencën mjekësore** Marrëveshje Kuadër 2021-2022.

**Fondi Limit**
Fondi limit në vlerën 79,290,000 lekë pa TVSH.

## Përmbledhja e procedurës në tabelë

| **a. Zhvilimi i Procedurës së Prokurimit me objekt " Blerje set uniforme dhe elementë përbërëse të tyre" 2021 -2022** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 22 datë 03.03.2021 | | |
| **1. Lloji i procedurës së Prokurimit**<br>Procedurë e Hapur | **2. Njësia e Prokurimit (ABP)**<br>Znj. S. H.<br>Znj. E. Z.<br>Znj. Xh. T. | **3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike dhe llogaritjes së fondit limit:**<br>Znj. L. M.<br>Znj. A. R.<br>Z. G. G. |
| **4. Fondi limit (pa tvsh)**<br>79,290,000 lekë | **5. Burimi i Financimit**<br>Buxheti i shtetit | **6. Data e hapjes së tenderit**<br>19.04.2021 |
| **7. Operatorët Ekonomikë**<br>**a) Pjesëmarrës**<br>A.. 48,500,000 lekë<br>U. P... sh.p.k 51,900,000 lekë<br>B&B F. shpk 58,040.000 lekë<br>M. &A. sh.p.k 61,800,000 lekë<br>Ë-C.. sh.p.k 64,200,000 lekë<br>EN-AD 65,250,000 lekë<br>**G. S. 66,000,000 lekë**<br>**b) kualifikuar:**<br>U... P... sh.p.k 51,900,000 lekë | **8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**<br><br>ABP | **9. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>51,900,000 lekë |
| **10. Data e lidhjes së kontratës**<br>Marrëveshje Kuadër Nr. 22/7 Prot., datë 02.06.2021 | **11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>27,390,000 lekë | **12. Ankimime**<br>Po |
| **13.Komisioni i marrjes në dorëzim**<br>Z. K. C.<br>Z. J. H.<br>Z. K. I. ndryshyar në 2022 me Znj. A.K. | **14. Fletë hyrja** | **15. Afati i kontratës**<br>90 ditë |
| **16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi**<br>Nr. 604/2021 dt. 17.09.2021<br>Nr. 726/2021 dt. 30.09.2021<br>Nr. 2129 dt. 22.07.22 | **17. Likuiduar deri dt + TVSH**<br>U.SH. nr. 247 dt. 05.10.2021 **31,140,000 ALL**<br>U.SH. nr. 162 dt. 27.07.2022 **18,684,000 ALL** | |

Me relacionin Nr. 42/4 protokolluar më datë 25.02.2021, komisioni i përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar vlerën 79,290,000 lekë pa TVSH.

Përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 79,290,000 lekë, pas çmimit mesatar të ofruar nga tre operatorët ekonomik (çmimi për 1000 copë)

"E. B." në vlerën 81,800,000 lekë pa TVSH;

"G. S." në vlerën 74,070,000 lekë pa TVSH;

"D. C." sh.p.k në vlerën 82,000,000 lekë pa TVSH.

Nga hulumtimet në internet dhe në treg nga grupi i auditimit, konstatoi dhe fryrje të fondit limit, duke marrë për bazë cmimet për një palë pantollona dhe xhup, duke përfshirë dhe TVSH, të ilustruara me foto si më poshtë:






- **"Blerje këpucë uniforme për urgjencën mjekësore" 2021**

## Fondi Limit

Fondi limit në vlerën 11,983,333 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

## Përmbledhja e procedurës në tabelë

| **a. Zhvilimi i Procedurës së Prokurimit me objekt *"Blerje këpucë uniforme" 2021*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>**Nr. , datë .03.2021** | | |
| **1. Lloji i procedurës së Prokurimit**<br>Kërkesë për propozim | **2. Njësia e Prokurimit**<br><br>**(ABP)** | **3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike dhe llogaritjes së fondit limit**:<br>Znj. L. M.<br>Znj. A. R.<br>Z. G. G. |
| **4. Fondi limit (pa tvsh)**<br>11,983,333 lekë | **5. Burimi i Financimit**<br>Buxheti i shtetit | **6. Data e hapjes së tenderit**<br>19.04.2021 |
| **7. Operatorët Ekonomikë**<br>**a) Pjesëmarrës**<br>G. S. 7,970,000 lekë<br>Ë-C... sh.p.k 8,860,000 lekë<br>U.... P.... sh.p.k 11,350,000 lekë<br>**b) kualifikuar:**<br>**U. P. sh.p.k 11,350,000 lekë**<br>• | **8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**<br><br>ABP | **9. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>11,350,000 lekë |
| **10. Data e lidhjes së kontratës**<br>Marrëveshje Kuadër Nr. 20/7 Prot., datë 28.05.2021 | **11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>633,333 lekë | **12. Ankimime**<br>Po |
| **13.Komisioni i marrjes në dorëzim**<br>Z. K. C.<br>Z. J. H.<br>Z. K. I. | **14. Fletë hyrja** | **15. Afati i kontratës**<br>90 ditë |
| **16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi**<br>Nr. 622/2021 dt. 20.09.2021<br>Nr. 724/2021 dt. 30.09.2021<br>**Nr. 2128 dt. 22.07.2022** | **17. Likuiduar deri dt**<br>U.SH. nr. 248 dt 05.10.2021 **7,491,000 ALL**<br>U.SH. nr. 163 dt. 27.07.2022 **4,086,000 ALL** | |

Përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 11,983,333,33 lekë, pas çmimit mesatar të ofruar nga tre operatorët ekonomik (çmimi për 1000 palë këpucë) "A. & R." sh.p.k në vlerën 12,000,000 lekë pa TVSH, "G. S." në vlerën 11,500,000 lekë pa TVSH, "S.-E." sh.p.k në vlerën 12,450,000 lekë pa TVSH.
Me relacionin Nr. 42/9 protokolluar më datë 09.03.2021, komisioni i përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar vlerën 11,983,333,33 lekë pa TVSH.

Nga hulumtimet në internet dhe në treg nga grupi i auditimit, konstatoi dhe fryrje të fondit limit, gati dyfish duke marrë për bazë cmimet për një palë këpucë duke përfshirë dhe TVSH, të ilustruara me foto si më poshtë:




Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se një pjesë e madhe e specifikimeve për këpucët janë tejet të detajuara (duke mos pasur një variabël vlerash ) dhe jo të nevojshme për një një këpucë që është uniformë e stafit të shërbimit të urgjencës, gjë që kufizon pjesëmarrjen ne procedurën e tenderit. Të tilla si: qëndrueshmëria e shuallit deri në 200 $^{O}$ C nxehtësi, lëkurë me trashësi 1.8-2mm, përmbajtja e kromit < 3% (të cilat janë të vështira të vlerësohen edhe nga KVO në përzgjedhjen e OE fitues. Gjithashtu cilësohen 6 vende për kalimin e lidhëzave të cilat duhet të jenë jo metalike (pjesa jo metalike e lidhëzave bien ndesh me qëndrueshmërinë e shuallit ndaj nxehtësisë, sepse një material metal free i lidhëzave është jo i qëndrueshëm ndaj nxehtësisë). Këto kritere të vendosur nga AK ulin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke kufizuar konkurrencën në këtë procedurë. Pra duket qartë që specifikimet teknike të këpucëve janë kufizuese, që i drejtohen një O.E. fitues te paracaktuar.

Gjatë verifikimit të mostrave të sjellë për produktin "Këpucë", viti i prodhimit të tyre të shënuar ishte viti 2020, ndërkohë që procedura e prokurimit është realizuar në vitin 2021 ndërkohë ato supozohet që të prodhohen sipas specifikimet teknike dhe ekzistenca e tyre (viti 2020), përbën fakt për paracaktimin e O.E. fitues.

- Nga dokumentacioni rezulton një deklaratë e datës 20.09.2021 nga OE "U.P." sh.p.k për dorëzim malli. Nga grupi i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbal në datë 20.09.2021, pa nr. protokolli, gjithashtu dhe për vitin 2022.
- Rezulton një amendim kontrate nr. 434/1 datë 09.09.2021 për zgjatjen e afatit të kontratës nr. 42/13 datë 11.06.2021, për 10 ditë, nga data 09.09.2021 në 19.09.2021. Ndërkohë afati 90 ditor për përmbushjen e kontratës përfundon dt 10.09.2021. Shtyrja e afatit është bërë për shkak të kërkesës së bërë nga OE, kërkesë e cila nuk ka një arsyetim të detajuar.
- G. G. me detyrë Inxhinier Tekstil (specialist fushe), për të cilin është lidhur kontratë individuale pune Nr. 43 Prot., datë 19.01.2021, si specialist fushe në njësinë e prokurimit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjes së fondit limit për procedurat e prokurimit me objekt: "Blerje këpuce uniforme për personelin e urgjencës mjekësore" dhe "Blerje set uniformash dhe elementësh përbërës të tyre". Është paguar me dy paga mujore që merr në institucionin ku punon (Inxhinier tekstil - me detyrë Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike bazuar në VKM nr. 720 datë 29.11.1995 *"Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore",* vendim i cili më 01.06.2012 është shfuqizuar me VKM nr. 418, datë 27.6.2012 "*Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore*". e shfuqizuar me VKM nr. 656 datë 31.10.2018

*“Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore”.*

<table>
<tr><td>13. Titulli i gjetjes:</td><td>Vendosja e specifikimeve teknike të ekzagjeruara.</td></tr>
<tr><td>Situata:</td><td>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se një pjesë e madhe e specifikimeve të uniformave janë tejet të detajuara, duke cituar një sërë variablash të cilat janë të ekzagjeruara për funksionin që do të kryejnë uniformat, të paargumentuara si dhe të vështira në momentin e vlerësimin nga Komisioni i vlerësimit të Ofertave dhe Grupi i marrjes në dorëzim.
<table>
<tr><td>Xhup Dimëror</td><td>6 percina (2 në pjesën e qafës dhe 4 në pjesën e bustit<br>Dy xhepa vertikal të mbyllur me zinxhir në kraharor me gjatës 14-16 cm<br>Dy xhepa të pjerrët anësor të mbyllur me zinxhir me gjatësi 16-18 cm<br>Një xhep të brendshëm drejtkëndor në krahun e majtë me mbyllje me ngjitje, në lartësinë e gjoksit<br>Astari të jetë në formë rrjete i përbërë me material 94% PA dhe 6 % poliestër</td></tr>
<tr><td>Pantollona Verore</td><td>Dy xhepat anësorë përpara te prerë në forme të pjerrët, të mbyllur me zinxhir dhe të mbuluar me kapak, me gjatësi 17-19 cm (në madhësinë L).<br>Dy xhepa të mëdhenj, me hapje fizarmonike, të mbyllur me zinxhir përpara, në pjesën e kofshëve, me zinxhir me gjatësi 16-18 cm.<br>Një xhep i pestë në pjesën e mbrapme të djathtë horizontal, i mbyllur nga një fileto me zinxhir me gjatësi 14-16 cm.<br>Mbyllje qendrore me gjysëm zinxhiri me gjatësi 14-16 cm dhe me percina, 5 ylyqe në bel (lartësi prej 5 cm dhe një gjerësi 2 cm), prej të cilavë 2 në zonën e përparme dhe 3 në pjesën e pasme.<br>Të gjithë zinxhirët janë të pajisur me tërheqës me gjatësi 5-7 cm.</td></tr>
</table>
E njëjta që vazhdon dhe me artikujt e tjerë. Pra duket qartë që specifikimet teknike të uniformave janë diskriminuese, që i drejtohen një O.E. fitues te paracaktuar.<br>Ngjyra e uniformave nuk korrespondon me ngjyrën e caktuar në Specifikimet Teknike me kod HV EN 20471, ku pas verifikimit nga grupi i auditimit dhe mostrat e sjella, ngjyra është në portokalli dhe jo e kuqe sipas kodit. I njëjti kod ngjyre është dhe për këpucët të cila nga mostrat e sjellë kanë një ngjyrë tjetër nga uniformat (Lejla) dhe përsëri jo të kuqë sipas kodit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri:</td><td>Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.</td></tr>
<tr><td>Ndikimi/Efekti:</td><td>Pengon konkurrencën e drejtë.</td></tr>
<tr><td>Shkaku:</td><td>Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta diskriminuese.</td></tr>
<tr><td>Rëndësia:</td><td>E lartë.</td></tr>
<tr><td>Rekomandimi:</td><td>QKUM, në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.</td></tr>
</table>

**Për sa më sipër** mbajnë përgjegjësi:
z. G. G., me detyrë inxhinier tekstil, znj. L. M. dhe znj. A. R. në cilësinë e komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike.

| | |
|---|---|
| **14. Titulli i gjetjes:** | Marrja në dorëzim e mallrave të cilat nuk kanë karakteristikat e njëjta të kërkuara nga ana e specifikimeve teknike. |
| **Situata:** | Ngjyra e uniformave nuk korrespondon me ngjyrën e caktuar në Specifikimet Teknike me kod HV EN 20471, ku pas verifikimit nga grupi i auditimit dhe mostrat e sjella, ngjyra është në portokalli dhe jo e kuqe sipas kodit. I njëjti kod ngjyre është dhe për këpucët të cila nga mostrat e sjellë kanë një ngjyrë tjetër nga uniformat (Lejla) dhe përsëri jo të kuqë sipas kodit.<br>Gjatë verifikimit të mostrave të sjellë për produktin "Këpucë", viti i prodhimit të tyre të shënuar ishte viti 2020, ndërkohë që procedura e prokurimit është realizuar në vitin 2021 ndërkohë ato supozohet që të prodhohen sipas specifikimet teknike dhe ekzistenca e tyre (viti 2020), përbën fakt për paracaktimin e O.E. fitues.<br>Nga dokumentacioni rezulton një deklaratë e datës 20.09.2021 nga OE "U.P." sh.p.k për dorëzim malli. Nga grupi i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbal në datë 20.09.2021, pa nr. protokolli, gjithashtu dhe për vitin 2022. |
| **Kriteri:** | Nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Pengon konkurrencën e drejtë. |
| **Shkaku:** | Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta diskriminuese. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, nuk ka përmbushur misionin e tij mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve ashtu sic i ka kërkuar në specifikimet teknike, kryesisht ngjyrën dhe cilësinë, duke krijuar kushte për konkurrim të padrejtë ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. |

**Për sa më sipër** mbajnë përgjegjësi:
z. K. C., znj. J. H. dhe znj. A. K. në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratës për mallrat.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.10* , datë 16.03.2023.

### II.2.6 Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizimet etj.)

Për vitin 2021 janë realizuar 12 procedura prokurimi me vlera të vogla të publikuara në sistemin elektronik të APP-së me fond limit 10,025,182 lekë pa tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën 8,692,069 lekë pa tvsh si më poshtë:

| Viti 2021 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Objekt | Fondi limit | Vlera e kontratës | OE i shpallur fitues | Publikuar në APP |
| 1 | Siguracion automjetesh të QKUM | 800,000 | 800,000 | A... | 26.01.2021 |
| 2 | Shërbime dezinfektimi | 798,977 | 499,999 | A. Sh. P. | 12.02.2021 |
| 3 | Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh | 799,700 | 780,000 | K... | 08.03.2021 |
| 4 | Blerje Tonera për printime dhe fotokopje | 797,797 | 459,740 | P... Opport. | 17.03.2021 |
| 5 | Blerje bateri dhe riparim ups | 798,200 | 678,300 | I.. S.. T.. | 11.05.2021 |
| 6 | Blerje materiale pastrimi | 965,000 | 749,900 | M. H. | 05.08.2021 |
| 7 | Blerje materiale elektronike | 880,000 | 763,420 | I. S. T. | 21.10.2021 |
| 8 | Mirëmbajtje objekti ndërtimor | 906,613 | 899,000 | P.. S.. | 23.11.2021 |
| 9 | Blerje Kancelari | 987.000 | 832.310 | I.. S.. T.. | 03.12.2021 |
| 10 | Blerje materiale promocione dhe marketingu | 799.895 | 799.000 | F & M R... | 10.12.2021 |
| 11 | Shërbim telefonik E1 PRI ISDN me 2 linja hyrëse dhe një dalëse për vitin 2022 për QKUM | 1.000.000 | 985.400 | A... | 23.12.2021 |
| 12 | Shërbim interneti për QKUM për 2022 | 492.000 | 472.000 | A... | 29.12.2021 |
| **Totali** | | **10,025,182** | **8,692,069** | | |

Me shkresë nr. 8 prot., Urdhri nr.6, datë 06.01.2021, të Administratorit të QKUM z. S. B. është krijuar komisioni i prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga znj. G. V. (Kryetare), znj. L. M. dhe znj. A. R. (anëtarë).

- **“Mirëmbajtje Objekti Ndërtimor”**

Me shkresën e datës 15.11.2021 zoti B. A., me detyrë specialist investimesh ka kryer kërkesë për mirëmbajtjen e godinës së QKUM drejtuar drejtorit të QKUM z.S. B., **pa protokoll.**
Me procesverbalin e datës 18.11.2021, **pa protokoll** është përllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla duke marrë parasysh 3 oferta të tregut përkatësisht:
“P. Xh.” me çmim 907.280 lekë pa tvsh
“F.” me çmim 909.280 lekë pa tvsh
“P. S.” me çmim 903.280 lekë pa tvsh.
Duke llogaritur vlerën mesatare të 3 operatorëve ekonomikë (907.280+909.280 +903.280) /3 = **906.613**. lekë pa tvsh.
Me urdhrin Nr. 13 datës 19.11.2021 nr. 563 Prot, të Drejtorit të Përgjithshëm të QKUM z. S. B. në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor është urdhëruar komisioni i prokurimit me vlera të vogla të fillojë procedurën me objekt: **“Mirëmbajtje objekti ndërtimor”.**
Me procesverbalin e datës 22.11.2021 është mbajtur nga ana e komisionit të prokurimit me vlera të vogla argumentimi dhe miratimi i specifikimeve teknike si dhe kriteret e kualifikimit, **pa protokoll**.
Me shkresën me Nr. Prot 563/1 e datës 22.11.2021 është dërguar ftesa për ofertë.
Referuar klasifikimit përfundimtar operatorë ekonomik të kualifikuar janë:
1.L.-FM C. me fond limit 495.000 lekë pa tvsh.
2.C.-BS me fond limit 568.340 lekë pa tvsh.
3.Xh. S. me fond limit 588.340 lekë pa tvsh.
4.A. B. me fond limit 597.000 lekë pa tvsh.
5.A. me fond limit 637.500 lekë pa tvsh.
6.E. me fond limit 800.000 lekë pa tvsh.
7.M.BA me fond limit 832.000 lekë pa tvsh.
8.V. K. me fond limit 870.000 lekë pa tvsh.
9.P. S. me fond limit 899.000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin e datës 24.11.2021 nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të mosparaqitjes së OE "L.-FM C.".
**Në sistemin online të APP ndërkohë, konstatohet që ky operator ekonomik është tërhequr për arsye të paparashikuara dhe jo për arsye mosparaqitjeje.**
Në sistemin online të APP, konstatohet që OE i rradhës "C.-BS", i shpallur fitues për arsye të skualifikimit të OE "L.-FM C.", është tërhequr nga prokurimi. **Nuk është mbajtur një procesverbal për arsyen e tërheqjes së këtij OE-je.**
Me procesverbalin e datës 26.11.2021, **pa protokoll** nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, është deklaruar kalimi në operatorin ekonomik të radhës për arsye të mosparaqitjes së OE fituese "Xh. S.". Konstatohet gjithashtu edhe në sistemin online të APP.
Me procesverbalin e datës 01.12.2021, **pa protokoll** nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, është deklaruar kalimi në operatorin ekonomik të radhës pasi OE fitues "A. B." nuk ëshë paraqitur.
Me proceverbalin e datës 02.12.2021, **pa protokoll** OE fitues i radhës "A.." ka dorëzuar dokumentet për procedurën e prokurimit.
Me procesverbalin e datës 03.12.2021, **pa protokoll** nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, është deklaruar kalimi tek OE i radhës, pasi OE "A." skualifikohet për arsye të mosparaqitjes së çertifikatës për punimet në lartësi për dy punonjës, si dhe mospërputhje të vlerës së ofertës ekonomike në SPE me vlerën e ofertës ekonomike të dorëzuar pranë AK.
Më datë 03.12.2021, **pa protokoll** Administratori i "A." sh.p.k A. B. ka paraqitur ankesë drejtuar QKUM duke kërkuar arsyen e skualifikimit nga prokurimi.
Me urdhrin nr.187 i datës 06.12.2021 Nr.prot. 596 drejtori i QKUM S. B. ka pezulluar procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje objekti ndërtimor".
Me urdhrin nr.188 i datës 06.12.2021 Nr.prot 596/1 drejtori i QKUM S. B. ka kërkuar shqyrtimin e ankesës së OE "A." duke ngarkuar për zbatimin e urdhrit komisionin e blerjeve të vogla dhe znj. A. Xh..
Me shkresën nr.Prot. 596/2 i datës 06.12.2021 është mbajtur relacion për ankesën e OE "A." ku shtjellohet se arsyet e skualifikimit janë mungesa e çertifikatave për punimet në lartësi të punonjësve si dhe mospërputhja e vlerës së ofertës ekonomike në SPE ( 637.500 lekë) me vlerën e paraqitur në AK ( 636.500 lekë).
Me shkresë nr.Prot. 596/3 i datës 06.12.2021 drejtori i QKUM S. B. i është përgjigjur ankesës së OE "A." duke i sqaruar edhe arsyet e rrëzimit të ankimit.
Me urdhrin nr.189 me nr. Prot. 596/4 i datës 06.12.2021 drejtori i QKUM S. B. ka hequr pezullimin për procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje objekti ndërtimor".
Me procesverbalin e datës 07.12.2021, **pa protokoll** nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të mosparaqitjes së OE "E.".
Me procesverbalin e datës 09.12.2021, **pa protokoll** nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të mosparaqitjes së OE "M. BA".
Me procesverbalin e datës 09.12.2021, **pa protokoll** nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të tërheqjes së OE "V. K.", për shkak të përllogaritjes gabim të ofertës.
Për sa më sipër, komisioni i blerjeve me vlerë të vogël vendosi të shpallë fitues OE "P. S." për procedurën e prokurimit me objekt "Mirëmbajtje objekti ndërtimor".
Me shkresën nr. 563/2 Prot. e datës 17.12.2021, titullari i AK S. B. ka njoftuar si fitues OE " P. S." me vlerën 1.078.800 lekë me tvsh / 899.000 lekë pa tvsh.
Me datë 22.12.2021, nga Platforma Qendrore e Faturave është lëshuar Fatura Elektronike me nr. 1548/2021 me shitës OE "P. S." dhe blerës "QKUM" në vlerën tot. 899.000 lekë pa tvsh.

Për mbikëqyrjen e shërbimit të mirëmbajtjes së objektit ndërtimor të godinës së QKUM është mbajtur procesverbali i datës 22.12.2021,**pa protokoll** nga ana e komisionit të mbikëqyrjes me kryetar K. R. si drejtor i Komunikimit, Statistikës dhe Regjistrit të Urgjencës, E. A. anëtar teknik i mesëm dhe E. G. anëtar teknik i mesëm.
Më datë 24.12.2021 është mbajtur Urdhër-Shpenzimi nr. 340, me vlerën 1.078.800 lekë me tvsh pranë Degës së Thesarit.

| | |
|---|---|
| **15. Titulli i gjetjes:** | Anomali gjatë zhvillimi të procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje Objekti Ndërtimor". |
| **Situata:** | Është e pamundur që të studiohet tregu dhe të jepen oferta nga specifikimet teknike të hartuara nga A.K., pa të dhëna kryesore si nr., sasi, m2 etj... si më poshtë (me bold):<br><br>**Plintusa metalik për rrëshkitje 1**<br>**Mirëmbajtje dhe riparim i pompës thithëse 1**<br>**Piston për derën kryesore me presion vaji 1**<br>Suvatim, mermetim muresh 250 m2<br>Lyerje tavani kartonxhes 210 m2<br>Lyerje e murit të brendshëm 1850 m2<br>Pastrim i fasadës së ventiluar 900m2<br>Pastrim troutari dhe parkimit 345 m2<br>Patinim muresh 100m2<br>**Vijat e verdha të parkimit 1**<br><br>Realizimi i punimeve të mësipërme për afatin 5 ditor është i pamundur të realizohet me 5 punëtore të kërkuara në kriteret e veçanta që duhet të përmbushë O.E. sipas A.K.<br>Procesverbali i kryerjes së punimeve nuk është shoqëruar me foto që të tregohen qartë realizimi i zërave të mësipërm. |
| **Kriteri:** | Nenin 107 "Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Ndikim në kryerjen dhe cilësinë e punimeve. |
| **Shkaku:** | Njohuri të pakta në fushën e ndërtimit. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse, në përputhje me volumin e kontratës dhe të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllogaritet drejtë fondi limit dhe ofertat e dhëna si dhe të dokumentohet i gjithë zbatimi i kontratës. |

**Për sa më sipër** ngarkohen me përgjegjësi:
z. K. R.
znj. M. D.
znj. A. Xh., në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit dhe
znj. G. V.
znj. L. M.
znj. J. R. në cilësinë e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.01* , datë 16.03.2023.

Për vitin 2022 janë realizuar 13 procedura prokurimi me vlera të vogla të publikuara në sistemin elektronik të APP-së me fond limit 11,567,736 lekë pa tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën 10,102,339 lekë pa tvsh si më poshtë:

| Nr. | Objekt | Fondi limit | Vlera e kontratës | OE i shpallur fitues | Publikuar në APP |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Blerje bateri, materale të ndryshme dhe montim UPS | 888,320 | 763,450 | I. s. T. | 28.06.2022 |
| 2 | Blerje kancelari | 979.300 | 610.450 | I. s. T. | 04.10.2022 |
| 3 | Shërbim telefonik EI PRI ISDN | 998.400 | 985.000 | A... | 23.12.2022 |
| 4 | Shërbim interneti 2023 | 489.300 | 470.000 | A... | 23.12.2022 |
| 5 | Blerje tonera për printera dhe fotokopje | 939,200 | 834,570 | M. N. | 03.06.2022 |
| 6 | Mirëmbajtje dhe riparim impjanti teknologjik të QKUM-së | 988,500 | 939,999 | FB T... | 13.10.2022 |
| 7 | Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh | 994.550 | 920.000 | K... | 09.03.2022 |
| 8 | Siguracione automjetesh | 998.666 | 998.000 | A... | 25.01.2022 |
| 9 | Blerje materiale elektronike | 965.500 | 878.480 | E. M. | 27.10.2022 |
| 10 | Blerje materiale pastrimi | 945.800 | 674.780 | S. M. | 24.11.2022 |
| 11 | Mirëmbajtje objekti ndërtimor | 820.000 | 784.500 | P... S... | 17.11.2022 |
| 12 | Blerje materiale elektrike dhe hidraulike | 795.400 | 678.210 | G.-D | 02.08.2022 |
| 13 | Shërbim mirëmbajtje fikëse zjarri | 769.800 | 564.900 | I – F.. | 07.09.2022 |
| **Totali** | | **11,567.736** | **10,102.339** | | |

Me shkresë nr. 17 prot., Urdhri nr.11, datë 10.01.2022, të Administratorit të QKUM z. S. B. është krijuar komisioni i prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga znj. G. V. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. N. D., znj. A. R..
Me shkresë nr. 113 prot., Urdhri nr.37, datë 18.02.2022, të Administratorit të QKUM z. S. B.është zëvendësuar anëtari i komisionit të prokurimit me vlera të vogla znj. N. D. me znj. L. X..
Me shkresë nr. 213 prot., Urdhri nr.84, datë 29.03.2022, të Administratorit të QKUM z. S. B. është zëvendësuar anëtari i komisionit të prokurimit me vlera të vogla znj. A. R. me znj. J. R..
Me shkresë nr. 612 prot., Urdhri nr.247, datë 30.08.2022, të Administratorit të QKUM z. S. B. është zëvendësuar anëtari i komisionit të prokurimit me vlera të vogla znj. L. Xh. me znj. L. M..

- **“Shërbim telefonik EI PRI ISDN” & “Shërbim interneti 2023”**

**Nga auditimi i procedurave të prokurimit të mësipërme u konstatua:**

Copëzim i fondeve në 2 raste, në vitin 2022, duke shmangur procedurën e prokurimit, si më poshtë:

1. Shërbim telefonik EI PRI ISDN - me vlerë 985.000 lekë pa tvsh.
2. Shërbim interneti 2023 - me vlerë 470.000 lekë pa tvsh.

- Sa më sipër, shërbimi i ngjashëm “Shërbim telefonie dhe interneti”, me të njëjtin operator ekonomik “A.”. Të dy procedurat së bashku rezultojnë në vlerën 1.455.000 Lekë pa TVSH, që tejkalojnë me 455.000 Lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Me tejkalimin e pragut të prokurimit në vlerë të vogël, QKUM duhet të kalojë në procedurën e kufijve të ulët monetar prokurimit.
- QKUM në llogaritjen e fondeve për procedurën e prokurimit në vlerë të vogël, nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, të cilat zakonisht duhet të prokurohen

njëherësh dhe në asnjë rast, nuk duhet të ndahen gjatë përdorimit të kësaj procedure. Materialet e sipërcituara janë pjesë e linjave teknologjike në ushtrimin e veprimtarisë dhe veprimi i mësipërm është në mospërputhje me pikën 3 të Udhëzimit Nr.05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" si dhe nenin 56, pika 2 dhe pika 11, e Vendimit Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave për Prokurimin publik".
Për arsyen e mësipërme procedurat e sipërcituara të prokurimit konsiderohen tejkalim i pragut të prokurimit në vlerë të vogël dhe QKUM duhej të kalonte në procedurën kufijve të ulët monetar të prokurimit, me qëllim ruajtjen e konkurrencës në prokurim.

| **16. Titulli i gjetjes:** | Copëzim i fondeve në 2 raste, në vitin 2022. |
|---|---|
| **Situata:** | Copëzim i fondeve në 2 raste, në vitin 2022, duke shmangur procedurën e prokurimit, si më poshtë:<br>1. Shërbim telefonik EI PRI ISDN - me vlerë 985.000 lekë pa tvsh.<br>2. Shërbim interneti 2023 - me vlerë 470.000 lekë pa tvsh.<br>Sa më sipër, shërbimi i ngjashëm "Shërbim telefonie dhe interneti", me të njëjtin operator ekonomik "A". Të dy procedurat së bashku rezultojnë në vlerën 1.455.000 Lekë pa TVSH, që tejkalojnë me 455.000 Lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Me tejkalimin e pragut të prokurimit në vlerë të vogël, QKUM duhet të kalojë në procedurën e kufijve të ulët monetar prokurimit.<br>Materialet e sipërcituara janë pjesë e linjave teknologjike në ushtrimin e veprimtarisë.<br>Për arsyen e mësipërme procedurat e sipërcituara të prokurimit konsiderohen tejkalim i pragut të prokurimit në vlerë të vogël dhe QKUM duhej të kalonte në procedurën kufijve të ulët monetar të prokurimit, me qëllim ruajtjen e konkurrencës në prokurim. |
| **Kriteri:** | Pika 3 e Udhëzimit Nr.05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" si dhe nenin 56, pika 2 dhe pika 11, e Vendimit Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave për Prokurimin publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Copëzim të fondeve. |
| **Shkaku:** | Nuk kanë marrë parasysh grupin e mallrave/shërbimeve. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, të marrë të gjitha masat që në hartimin e regjistrit të prokurimeve të parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike. |

**Për sa më sipër** ngarkohen me përgjegjësi:
Znj. G. V.
Znj. J. R.
Znj. L. M.., në cilësinë e komisionit të blerjeve të vogla.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.01* , datë 16.03.2023.

- **“Mirëmbajtje Objekti Ndërtimor”**

Me shkresën e datës 11.11.2022 zoti B. A., me detyrë specialist investimesh ka kryer kërkesë për mirëmbajtjen dhe riparimin e impiantit teknologjik të QKUM drejtuar drejtorit të QKUM z. S. B., **pa protokoll.**
Me shkresën e datës 14.11.2022, **pa protokoll** është mbajtur procesverbali mbi vlerën e fondit limit të procedurës së prokurimit ku janë marrë parasysh 3 oferta të tregut:
“P. Xh.” me vlerë 805.500 lekë pa tvsh
“P.S.” me vlerë 784.500 lekë pa tvsh
“F.” sh.p.k. me vlerë 870.000 lekë pa tvsh.
Fondi limit për këtë procedurë është (805.500 + 784.500+870.000) – **820.000 lekë pa tvsh.**
Me urdhrin Nr. 15 datës 16.11.2022 nr. 814 Prot, të Drejtorit të Përgjithshëm të QKUM z. S.B. në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor është urdhëruar komisioni i prokurimit me vlera të vogla të fillojë procedurën me objekt: **“Mirëmbajtje objekti ndërtimor”.**
Me shkresën me Nr.Prot 814/1 e datës 16.11.2022 është dërguar ftesa për ofertë.
Me shkresën e datës 16.11.2022, **pa protokoll** është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.
Referuar klasifikimit përfundimtar operatorë ekonomik të kualifikuar janë:
1.Xh. S. me fond limit 468.140 lekë pa tvsh.
2.D. G me fond limit 468.500 lekë pa tvsh.
3.A. B. me fond limit 547.000 lekë pa tvsh.
4.4A C. me fond limit 548.000 lekë pa tvsh.
5.M. C. and real estate me fond limit 590.500 lekë pa tvsh.
6.S. R. me fond limit 768.000 lekë pa tvsh.
7.H.-2 F me fond limit 779.000 lekë pa tvsh.
8.P. S. me fond limit 784.500 lekë pa tvsh.
9.M. BA me fond limit 887.300 lekë pa tvsh.
Me procesverbalin e datës 18.11.2022 nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të tërheqjes prej mosparaqitjes në kohë të OE “Xh. S.”.
Me procesverbalin e datës 18.11.2022 nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të tërheqjes për gabim në përllogaritjen e kostos të OE “D.-G”.
Me procesverbalin e datës 21.11.2022 nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të tërheqjes për gabim në përllogaritjen e kostos të OE “A. B.”.
Me procesverbalin e datës 22.11.2022 nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të mosparaqitjes të OE “4A K.”.
Me procesverbalin e datës 23.11.2022 nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të mosparaqitjes të OE “M. K. and real estate”.
Me procesverbalin e datës 24.11.2022 nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të tërheqjes për arsye objektive të OE “S. Rr.”.
Me procesverbalin e datës 25.11.2022 nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ka deklaruar kalimin te operatori ekonomik i radhës për arsye të mosparaqitjes të OE “H.-2F”.
Me procesverbalin e datës 26.11.2022 OE “P. S.” ka dorëzuar dokumentet e tij.

Me shkresën nr. prot 814/2 e datës 09.12.2022, titullari i AK S. B. ka njoftuar si fitues OE " P.S." me vlerën 784.500 lekë pa tvsh.
Me shkresën nr. 876 prot, e datës 14.12.2022 drejtori i përgjithshëm i QKUM, S. B. ka lëshuar urdhrin nr. 340 për ngritjen e grupit të kolaudimit për shërbimin e mirëmbajtjes së objektit ndërtimor, të përbërë nga z. K. R. kryetar, znj. M. D. anëtare, znj.A. Xh. anëtare.
Me procesverbalin e mbajtur të datës 19.12.2022 grupi i kolaudimit shprehet se shërbimet e zërave u kryen sipas kushteve të kontratës.
Me datë 19.12.2022, nga Platforma Qendrore e Faturave është lëshuar Fatura Elektronike me nr. 1896/2022 me shitës OE "P. S." dhe blerës "QKUM" në vlerën tot. 784.500 lekë pa tvsh.
Më datë 21.12.2022 është mbajtur Urdhër-Shpenzimi nr. 278, me vlerën 941.400 lekë pranë Degës së Thesarit.

| **17. Titulli i gjetjes:** | Vonesa në kryerjen e shërbimit. |
|---|---|
| **Situata:** | Gjatë zhvillimit të Procedurës së Prokurimit me objekt "Mirëmbajtje objekti ndërtimor viti 2022", përsa i përket kryerjes së shërbimit është kryer në datën 19.12.2022, ndërkohë që shpallja fitues e O.E. është bërë me datë 09.12.2022. Sipas specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta lëvrimi i mallit duhej bërë brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (njoftimi i fituesit).<br>Procesverbali i mbajtur mbi realizimin e shërbimit nuk është i shoqëruar me foto që të dokumentohet procesi dhe realizimi i plotë i shërbimit.<br>Realizimi për 5 ditë i zërave të mësipërm dhe me dy punonjës është i pamundur. |
| **Kriteri:** | Nenin 107 "Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Vonesa në kryerjen e shërbimit. |
| **Shkaku:** | Neglizhenca e krijuar nga ana e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, të bëjë të mundur llogaritjen dhe alokimin e penalitetit sipas kushteve të kontratës mbi ditët jashtë afatit të lëvrimit të mallit dhe në të ardhmen të kryejë lëvrimin e mallit/shërbimit sipas kushteve të kontratës. |

**Për sa më sipër** ngarkohen me përgjegjësi:
z. K.R.
znj. M. D.
znj. A. X., në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit dhe
znj. G. V.
znj. L. M.
znj. J. R. në cilësinë e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.01* , datë 16.03.2023.

**II.2.7 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit (identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi, Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm).**

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në QKUM, grupi auditues kreu verifikimet mbi implementimin dhe plotësimin e kërkesave mbi funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të vendosura për komponentët e mëposhtëm:

- *Mjedisin e kontrollit*
- *Menaxhimin e riskut*
- *Aktivitetet e kontrollit*
- *Informimin dhe komunikimin*
- *Monitorimin*

**Mjedisi i Kontrollit**

Nga ana e Drejtuesve te QKUM me urdhrin nr.13 datë 12.01.2021 nr.prot. 24 është ngritur Këshilli Konsultues si organ konsultativ i drejtorit të përgjithshëm të QKUM, si dhe caktimi i Grupit për menaxhimin strategjik. Bazuar në këtë urdhër grupi i Këshillimit dhe grupi i menaxhimit strategjik përbëhen nga të njëjtët anëtarë dhe nga ku këtij grupi këshillimi i janë caktuar edhe kompetencat e GMS, përveç kompetencave të caktuara nga neni 17 i rregullores së brendshme.

Nga ana e drejtuesve të QKUM, për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit,janë kryer vlerësime vjetore të stafit administrativ, mbi performancën dhe realizimin e detyrave të punonjësve mbi bazën e përshkrimeve të detyrave në kontratën e punës dhe rregulloren e përgjithshme.
Nga auditimi evidentohet plan veprimi për vitet 2021-2022 sipas strategjisë së QKUM, në të cilat parashikohen organizimi i Qendrës së komandës dhe kontrollit për urgjencat, trajnimi i burimeve njerëzore për shërbimin kombëtar të Urgjencës Mjekësore, programimi i organizimit/shpërndarjes territoriale të mjeteve të urgjencës, nuk ka ende një program specifik trajnimi ndaj administratës në lidhje me njohjen dhe zbatimin e Ligjit të MFK në mospërputhje me Pikën 1[11], Neni 20 "Mjedisi i Kontrollit", Ligji 10 296 dt. 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit"*.

**Menaxhimi i riskut**

Me urdhrin nr.39 datë 25.01.2019 nr.prot.544 Ministri i Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu ka miratuar Rregulloren "Për funksionimin e shërbimit Kombëtar të Urgjencës Mjekësore".
Me urdhrin nr.35 datë 10.05.2018 nr.prot 302 Drejtori i Përgjithshëm QKUM Skënder Brataj ka miratuar Rregulloren e brendshme të QKUM.
Me shkresën nr.prot. 30 e datës 15.01.2021 është miratuar edhe relacioni i Këshillit Konsultues të QKUM ku paraqiten detyrat e menaxhimit të Riskut, strategjia, regjistri i riskut, menaxhimi.
Nga dokumentacioni i paraqitur, QKUM ende nuk ka caktuar një koordinator të riskut, në përputhje me Nenin 10/1[12], Ligji 10 296 dt. 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit"*.

[11] Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

[12] Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike.

**Aktivitetet e kontrollit**

QKUM ka një Kod etike dhe Manual Personeli, të cilat pasqyrohen edhe në faqen zyrtare të institucionit, pjesë e programit të transparencës.

Konstatohet nga auditimi që për vitin 2022 është mbajtur edhe një regjistër për masat disiplinore.

Me urdhrin nr.112 datë 22.06.2021 është miratuar programi i transparencës për QKUM dhe emëruar si person përgjegjës për zbatimin e saj z. K. R. me detyrë Drejtor i komunikimit, statistikës dhe regjistrit të urgjencës.

**Informimi dhe komunikimi**

QKUM nuk ka zhvilluar ende një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv.

Në Rregulloren e brendshme të QKUM, nuk është përcaktuar në formë eksplicite mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave në mospërputhje me nenin 23[13], Ligji 10 296 dt. 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit"*.

Sistemi i IT i QKUM aktualisht nuk është pajisur me një procedurë të përshtatshme rezervë (back-up) nga ku të mundësojë gjithashtu ri-përfitimin e të dhënave në rastin e një aksidenti në sistem ose ndaj rrezikut të një sulmi kibernetik.

**Monitorimi**

Monitorimi në QKUM kryhet nëpërmjet një monitorimi në vazhdimësi për të vlerësuar cilësinë e sistemit të performancës nëpër kohë. QKUM ka raporte me karakter statistikor (Drejtoria e Statistikës, Komunikimit dhe Regjistrit të Urgjencës), Raporte me karakter financiar ( Situacione evidenca etj të cilat paraqiten te Drejtori i Përgjithshëm në frekuenca 1( një) mujore).

| | |
|---|---|
| **18. Titulli i gjetjes:** | Vendosja e kritereve të veçanta jo në përputhje me objektin e kontratës dhe jo në përputhje me njëra-tjetrën. |
| **Situata:** | QKUM nuk ka zhvilluar ende një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv.<br>Në Rregulloren e brendshme të QKUM, nuk është përcaktuar në formë eksplicite mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave në mospërputhje me<br>Sistemi i IT i QKUM aktualisht nuk është pajisur me një procedurë të përshtatshme rezervë (back-up) nga ku të mundësojë gjithashtu ri-përfitimin e të dhënave në rastin e një aksidenti në sistem ose ndaj rrezikut të një sulmi kibernetik. |
| **Kriteri:** | Nenin 23 , Ligji 10 296 dt. 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Rast për një aksidenti në sistem ose ndaj rrezikut të një sulmi kibernetik. |
| **Shkaku:** | Mos njohja me risqet që mbartin mosfunksionimi i sistemit të komunikimit. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | QKUM, të marrë masat që të plotësojë rregulloren e brendshme me mënyrat e komunikimit dhe të informimit të informacionit, sipas niveleve të hierarkisë së institucionit. |

[13] Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë…

**Për sa më sipër** ngarkohen me përgjegjësi:
Z. S. B., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm.
Znj. G. V, në cilësinë e Drejtorit të Financës, Buxhetit dhe Investimeve.
z. K. R., në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Statistikës, komunikimit dhe Regjistrit të Urgjencës.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.07* , datë 16.03.2023

# IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

## B. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i kërkesave buxhetore të vitit 2021, u konstatua se QUKM, ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktin konkret të projektit dhe programit buxhetor, si edhe një analizë e detajuar prioritarizmi duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, duke cenuar kështu përdorimin me eficencë, efektivitet dhe produktivitet të fondeve në dispozicion të institucionit, të cilat nuk janë të mirë argumentuara si: kërkesat për shpenzime për anëtarët e Parlamentit në shumën 960 mijë lekë; për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna" në shumën 900 mijë lekë; pajisje për përdorim policor në shumën 960 mijë lekë; shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulike në shumën 2,700 mijë lekë; shpenzime për mirëmbajtjen e rezervës shtetërore në shumën 960 mijë lekë; shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore në shumën 1,500 mijë lekë; shpenzime gjyqësore në shumën 960 mijë lekë, të cilat janë në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 neni 29, ligji 137/2020 "Për Buxhetin e vitit 2021" dhe udhëzimi nr.4, datë 25.01.2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**1.1 Rekomandimi:** QKUM, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm dhe të nevojshëm të kërkesave buxhetore duke targumentuar të gjitha kërkesat, lidhjen e objektivave të tyre me produktin e programit buxhetor, bazuar në një analizë buxhetore prioritarizmi të dokumentuar, me qëllim parandalimin e keq planifikimit të fondeve të institucionit.

***Menjëherë***

**2. Gjetje nga auditimi**: Për periudhën objekt auditimi parashikimi i *"shpenzimeve për personelin*" përfshin pagat bruto për punonjësit e përhershëm dhe të përkohshëm, (punonjësit e përkohshëm, janë kërkuar personel mjekësor shtesë për shkak të pandemisë). Punonjësit e përhershëm i përkasin strukturës së QKUM pra 86 punonjës (punonjësit e përkohshëm janë kërkuar shtesë 45 punonjës (personel mjekësor për shkak të pandemisë 10 mjekë, 20 infermierë dhe 15 shoferë mjekë) janë miratuar 49 punonjës me kontratë nga MSHMS.
Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për përballimin e fluksit të urgjencave mjekësore si edhe dinamikës në rritje (për shkak të tërmetit, pandemisë) në vitet 2020-2021-2022, ka parashikuar rritje të burimeve njerëzore të cilët nuk janë miratuar në strukturën e QKUM, por çdo vit është shtuar me 49 punonjës me kontrata 1 vjeçare sipas VKM përkatëse të çdo viti.

Konstatohen ndryshime të shpeshta të stafit mjekësor me përfundimin e kontratës, të cilat sjellin mangësi në kryerjen e detyrës si edhe investimi që kryhet nga QKUM për përgatitjen profesionale të kësaj kategorie punonjësish, nuk është i qendrueshëm dhe ndikon në shërbimin cilësor ndaj qytetarëve. Parashikimi i shpenzimeve për paga, ka ndryshim të fondit të pagave në PBA e viteve 2021-2023 dhe 2022-2024, është më i lartë për arsye të kërkesës për shtim personeli me kontratë të përkohshme si dhe zbatimit të vendimit nr. 207, datë 10.03.2020 "Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe Punonjës të tjerë" Megjithëse kërkesa buxhetore për vitin 2021 është për 86 punonjës, MSHMS ka miratuar 88 punonjës, në kundërshtim me Ligjin 147/2014 "Për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore", nenet 5 "Organizimi i Shërbimit të Urgjencës" dhe 8 "Përgjegjësitë e QKUM", VKM nr.933, datë 29.12.2014 "Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore" i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 8-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**2.1 Rekomandimi:** QKUM, të adresojë pranë MSHMS kërkesën për rishikim të menjëhershëm të strukturës organizative të institucionit, shoqëruar me relacionin përkatës argumentues mbi domosdoshmërinë e limitimit të pozicioneve të punës me kontratë afatshkurtër (aktualisht 57% e stafit) në një institucion me rëndësi jetike për qytetarët dhe pa natyrë pune me karakter sezonal, me qëllim që investimi i kryer për përgatitjen profesionale të kësaj kategorie punonjësish, të jetë i qendrueshëm dhe afatgjatë për shërbim profesional dhe cilësor ndaj qytetarëve.

***Menjëherë***

**3. Gjetje nga auditimi**: Në pasqyrën e flukseve monetare (Cash Flow) deklarohen të hyra nga të ardhurat jotatimore në vlerën 16,542 lekë për vitin 2021, të cilat nuk janë pasqyruar në Pasqyrën e performancës financiare.
Në llogarinë 423,429 (Personeli, paradhenie, deficite, gjoba) e cila paraqitet në vlerën 3,529,735 për vitin 2021 dhe 78,404 për vitin 2020, si vlera të cilat duhet të arkëtohen nga punonjës të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, vlerë e cila pas konsultimeve duket e vështirë për tu arkëtuar.
Në llogarinë 215 (Mjete transporti), për vitin 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë, e cila paraqitet si vlerë negative nga amortizimi i akumuluar i aktivit, por nga historiku i llogarisë, ka nxjerrje jashtë përdorimi të aktivi përfundimisht dhe shuma në llogarinë e akumuluar të amortizimit që lidhet me atë aktiv kthehet mbrapsht. E njëjta gjë ndodh dhe me llogarinë 218 (Inventarë ekonomik).
Përsa i përket llogarisë 466 (Kreditorë në mjete në ruajtje) nuk pasqyrohet si vlerë në Pasqyrën e flukseve monetare (Cash flow), në mospërputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit SKK Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Ligjin Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe ligjin nr. 9920, Datë 19.5.2008 Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i Ndryshuar.
Përsa i përket kreditorëve, nuk shfaqen anomali si dhe likudimi i tyre ndodh në kohë dhe sipas një rradhe të caktuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**3.1 Rekomandimi:** QKUM, të marrë masat të bëjë korrigjimet dhe rregullimet përkatëse në pasqyrat financiare të llogarive të sipërpërmendura si dhe të bëjë të mundur arkëtimin e vlerës prej 3,529,735 për vitin 2021 dhe vlerën prej 78,404 për vitin 2020 nga punonjësit të cilët nuk janë më në marrëdhënie pune

***Menjëherë***

**4. Gjetje nga auditimi**: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit "Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat" 2022, gjatë verifikimit të testimit të tregut dhe ofertave të marra në treg, vihet re që formati i marrjes së ofertave është i njëjtë për të gjithë operatorët dhe nuk mund të merret oferta në treg duke u nisur vetëm nga objekti i kontratës "Shërbim GPS dhe monitorim për Autoambulancat", duke mos qenë në dijeni se në përshkrimin e mallrave përfshihen GPS për automjete, sistemi audio-video, kamera, software, PC për monitorimin të cilat kanë specifikime të veçanta teknike. Pra, nga NJ.P. nuk është për bërë përshkrim i plotë i procedurës së prokurimit përpara marrjes së ofertave. Gjithashtu, nga NJ.P., njëkohësisht grupi për llogaritjen e fondit limit të kontratës, nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë Institucioni sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Specifikimet teknike për GPS dhe kamera të vendosura nga A.K. kanë një ngjashmëri të theksuar me specifikimet e katalogut të OE fitues. Gjithashtu një pjesë e specifikimeve teknike janë të ekzagjeruara dhe nuk mund të verifikohen nga anëtarët e KVO-së dhe të atyre të marrjes në dorëzim si dhe kanë një vlerë fikse duke mos përdorur termat ekuivalente.
Në hartimin e specifikimeve teknike nga A.K. në një pikë citohet "Në çdo qendër spitalore kompania do të krijojë mundësinë e monitorimit të ambulancave që i përkasin çdo drejtorie" dhe nuk jepen shpjegime më të detajuara se si do të krijohet ky monitorim në çdo qendër spitalore.
Në hartimin e specifikimeve teknike për suportin, konstatohet se afati për implementimin e shërbimit të GPS është brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Duke u nisur nga numri i lartë i autoambulancave, i qendrave spitalore dhe vendodhjes së tyre, grupi i auditimit mendon që është e vështirë realizimi i shërbimit brenda 5 ditëve, duke e konsideruar si kriter diskriminues për O.E. të tjerë, në mospërputhje me Nenin 36 "Specifikimet Teknike", Ligji nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**4.1 Rekomandimi:** QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllogaritet drejtë fondi limit.

***Në vijimësi***

**5. Gjetje nga auditimi**: Përsa i përket dokumentacionit për marrjen në dorëzim të GPS dhe vendosjes së tyre, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni origjinal i procesverbaleve mbi instalimin e pajisjeve por ishin kopje të tyre si dhe këto të fundit rezultuan me korrigjime për sa i përket datës së mbajtjes së tyre.
A.K. ka lidhur kontratë shërbimi nr. 193/9 dt. 11.05.2022 për 12 muaj për 347 GPS në vlerën 8,744,400 lekë pa tvsh, në të cilën nuk cilësohet afati prej 5 ditësh për implementimin e shërbimit sipas procesverbalit të hartimit të specifikimeve teknike.
Me qëllim verifikimin mbi funksionimin e sistemit dhe kohën e implementimit të tij, grupi i auditimit kërkoi nga A.K. t'i vihet në dispozicion sistemi i databazës për dy vitet, 2021 dhe 2022. Nga A.K. është vënë në dispozicion databaza për vitin 2022 në formatin Excel, i cili është një format mbi të cilin mund të bëhen ndryshime dhe nuk lihen gjurmë gjatë këtyre ndryshimeve, duke u konsideruar nga grupi i auditimit si një burim jo i besueshëm për të provuar funksionimin e tij. Problematika e tillë i ka fillesat që në hartimin e specifikimeve teknike dhe në lidhjen e kontratës, që për të garantuar vazhdimin e shërbimit duhej të ishte përpiluar në formën e një SLA, Marrëveshje në Nivel Shërbimi.

Gjatë analizimi të databazës së mësipërme vihet re që edhe pse janë mbajtur procesverbalet në data 12, 13, 14, 15 dhe 16 Maj, shërbimi me GPS për Autoambulancat ka rekorde që datojnë nga 11 Maj, ku O.E. fitues ka përdorur të njëjtët GPS të huazuar nga O.E. i mëparshëm.
Gjatë analizimit të databazës vihet re që ½ e autoambulancave gjatë periudhës nën shërbim nuk kanë lëvizur ose kanë rekorde lëvizjeje disa metra në muaj, ku pas intervistimit me komisionin e ndjekjes së kontratës, pjesa më e madhe shprehen se janë në servis dhe është e vështire kontrolli i tyre pasi nuk janë në pronësinë e QKUM-së, gjë që vështirëson ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe pagesat e kryera për ambulancat të cilat nuk janë në funksion, ku pagesa mujore për një autoambulancë është në vlerën 2,100 lekë pa TVSH, në mospërputhje me nenin 107 "Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**5.1 Rekomandimi:** QKUM, në rastet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, përvec hartimit të procesverbale dhe firmosjes së tyre, të bëjnë të mundur verifikimin e detajuar të mallrave/shërbimeve nëse janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe brenda datës së kërkuar për implementimin e shërbimit në këtë rast. Gjithashtu, përsa i përket funksionimit të ambulancave duke mos krijuar hapësira për përdorim të fondeve pa 3E (efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet), për një menaxhim sa më të mirë dhe më efektiv, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të bëjnë të mundur alokimin e urgjencave mjekësore (Staf + Ambulanca) në pronësi dhe menaxhim të QKUM.

***Menjëherë***

**6. Gjetje nga auditimi**: Gjatë zhvillimi të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Set Urgjence" për vitin 2021 konstatohet se:
- Bashkëlidhur kërkesës për zhvillimin e procedurës së prokurimit, nuk ka asnjë procesverbal të mbajtur, lidhur me nevojat e ambulancave për sete urgjence. Për disa nga artikujt, mungojnë certifikatat e ISO 9001:2015 apo ISO 13485:2016 ose ekuivalente e prodhuesit. Konkretisht nga prodhuesi Romed mungon certifikata për artikullin fasho autoadezive, ndërsa nga Gima mungon certifikata për artikujt paketa dizifektuese dhe chlorhexidine. Gjithashtu, në certifikatat e paraqitura nga OE për produktet e prodhuesit Romed, mungon përkthimi në gjuhën shqipe të emrit të artikullit, gjë që e vështirëson identifikimin korrekt të artikullit të certifikuar, në mospërputhje me Nenin 36 "Specifikimet Teknike", Ligji nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".
- Në katalogun e paraqitur nga fituesi, nuk përcaktohet përqindja e kërkuar në specifikimet teknike të AK të artikullit klorhexidin 5%. Nuk gjenden në katalogun e paraqitur nga OE fitues artikujt piastra adulte dhe piastra pediatrike të përputhshme për defibrilatorët Primedic dhe Rescue Life. Për artikullin maska silikoni, nga AK janë kërkuar 6 përmasa të ndryshme, ndërkohë në katalog janë paraqitur vetëm 4 përmasa. Për artikullin maskë oksigjeni me rezervuar, është kërkuar nga AK me përqindje të mesme, ndërkohë në katalogun e OE fitues është paraqitur maskë silikoni me përqindje të lartë. Për artikullin mushama (telo) janë kërkuar nga AK Përmasat 200X150cm, ndërkohë në katalogun e fituesit është paraqitur mushama telo me përmasa 180X76 cm. Nga AK, për artikullin doreza sterile janë kërkuar në përmasa të ndryshme, ndërsa në katalog është paraqitur vetëm në masën S (masë e vogël), në mospërputhje me Nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**6.1 Rekomandimi:** QKUM, në të ardhmen të marrë parasysh që zhvillimi i procedurave të prokurimit iniciohet fillimisht nga një nevojë që i lind institucionit e cila hartohet në mënyrë të

detajuar dhe regjistrohet në regjistrin e parashikimeve ku në bazë të fondeve dhe rëndësisë që ka kjo nevojë zhvillohet nga ana e institucioni si dhe në rastin e vlerësimit të ofertave të tregohet kujdes që mallrat/shërbimet e ofruara nga O.E. pjesëmarrës të përkojnë me ato të kërkuara në specifikimet teknike nga ana e A.K.

***Në vijimësi***

**7. Gjetje nga auditimi**: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Set urgjence" për vitin 2022, nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në hartimin e specifikimeve teknike një pjesë e madhe e artikujve të ilustruara me foto ka ngjashmëri absolute me artikujt e paraqitur në katalogun e sjellë nga O.E. fitues.
Për artikujt të paraqitur në katalogun e OE fitues të Kompanisë Teleflex (artikujt 67-68) mungon përkthimi në gjuhën shqipe, për të cilat mungojnë certifikatat e ISO 9001:2015 apo ISO. Gjithashtu, nga prodhuesi Romed mungon certifikata për artikullin fasho autoadezive, ndërsa nga Gima mungon certifikata për artikujt paketa dizifektuese dhe chlorhexidine.
Disa nga specifikimet teknike nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës. Konkretisht, në katalogun e paraqitur nga fituesi, nuk përcaktohet përqindja e kërkuar në specifikimet teknike të AK të artikullit klorhexidin 5%. Nuk gjenden në katalogun e paraqitur nga OE fitues artikujt piastra adulte dhe piastra pediatrike të përputhshme për defibrilatorët Primedic dhe Rescue Life. Për artikullin maska silikoni, nga AK janë kërkuar 6 përmasa të ndryshme, ndërkohë në katalog janë paraqitur vetëm 4 përmasa. Për artikullin maskë oksigjeni me rezervuar, është kërkuar nga AK me përqindje të mesme, ndërkohë në katalogun e OE fitues është paraqitur maskë silikoni me përqindje të lartë. Për artikullin mushama (telo) janë kërkuar nga AK Përmasat 200X150cm, ndërkohë në katalogun e fituesit është paraqitur mushama telo me përmasa 180X76 cm. Nga AK, për artikullin doreza sterile janë kërkuar në përmasa të ndryshme, ndërsa në katalog është paraqitur vetëm në masën S (masë e vogël), në mospërputhje me nenin 36 "Specifikimet Teknike", Ligji nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"
Gjatë zhvillimit të procedurës së auditimit me objekt "Blerje Pajisje mjekësore", në kërkesat për kualifikim"Specifikimet teknike" për pajisjet mjekësore, konkretisht pika II.5 dhe II.6 për manekin PCR infant/perdiatrik dhe ventilator për autoambulanca rezulton se ka një ngjashmëri absolute midis specifikimeve teknike të pajisjeve mjekësore të hartuara nga A.K., me specifikimet teknike të katalogut të sjellë nga Operatori Ekonomik fitues.
**Në pikën 2.2** nga AK kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3(tre) viteve të fundit, ku vlera e xhiros mesatare vjetore për tre vitet e fundit duhet **të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit** të kontratës që po prokurohet në mospërputhje me shkronjën c[14] të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
**Në pikën 2.3.** nga AK kërkohet kërkohet që OE të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë ***sa 20%*** të vlerës së përllogaritur të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit në mospërputhje me shkronjën b[15] të pikës 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

[14] vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës** së parashikuar të kontratës. Ky kriter i cili barazon vlerën e xhiros vjetore me vlerën e fondit limtit ul pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

[15] vlera totatle e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**7.1 Rekomandimi:** QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke krijuar hapësirë për zhvillimin e një gare të ndershme dhe konkurruese.

***Në vijimësi***

**8. Gjetje nga auditimi**: Gjatë zhvillimit të procedurës së auditimit me objekt "Blerje Pajisje mjekësore", nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:
Për disa nga pajisjet mjekësore, disa nga specifikimet teknike të karrocës me katër rrota me zinxhir dhe fluksometrit nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**8.1 Rekomandimi:** QKUM, në rastet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, përvec hartimit të procesverbaleve dhe firmosjes së tyre, të bëjnë të mundur verifikimin e detajuar të mallrave/shërbimeve nëse janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

***Në vijimësi***

**9. Gjetje nga auditimi**: Gjatë zhvillimit të procedurës së auditimit me objekt "*Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi te sistemit te pajisjeve teknologjike te QKUM"*, rezulton se në specifikimet teknike të hartuara nga A.K., mungojnë të dhënat kryesore si nr., sasi, m2 etj... si më poshtë:

- Plintusa metalik për rrëshkitje 1
- Mirëmbajtje dhe riparim i pompës thithëse 1
- Piston për derën kryesore me presion vaji 1
- Vijat e verdha të parkimit 1

Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pa mundur studimin e tregut dhe pamundëson dhënien e ofertave nga operatorët pjesëmarrës.
- Realizimi i punimeve për zërat mësipërme në afatin 5 ditor është e pamundur të realizohet me 5 punëtore të kërkuara në kriteret e veçanta që duhet të përmbushë O.E. sipas A.K. Procesverbali i kryerjes së punimeve nuk është shoqëruar me foto që të tregohen qartë realizimi i zërave të mësipërm, në mospërputhje me Nenin 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*".
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 50-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**9.1 Rekomandimi:** QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse, në përputhje me volumin e kontratës dhe të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllogaritet drejtë fondi limit dhe ofertat e dhëna si dhe të dokumentohet i gjithë zbatimi i kontratës.

***Në vijimësi***

**10. Gjetje nga auditimi**: QKUM nuk ka zhvilluar ende një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv si është parashikuar edhe në Rregulloren e brendshme të QKUM, ku në formë eksplicite është përcaktuar mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave.
Sistemi i IT i QKUM aktualisht nuk është pajisur me një procedurë të përshtatshme rezervë (back-up) nga ku të mundësojë gjithashtu ri-përfitimin e të dhënave në rastin e një aksidenti në sistem ose ndaj rrezikut të një sulmi kibernetik në kundërshtim me Nenin 23 , Ligji 10 296 dt. 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit*".
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 50-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** QKUM, të marrë masat që të plotësojë rregulloren e brendshme me mënyrat e komunikimit dhe të informimit të informacionit, sipas niveleve të hierarkisë së institucionit.

***Menjëherë***

**11. Gjetje nga auditimi**: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje set uniforme dhe elementët përbërëse të tyre", nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se një pjesë e madhe e specifikimeve të uniformave janë tejet të detajuara, duke cituar një sërë variablash të cilat janë të ekzagjëruara për funksionin që do të kryejnë uniformat, të paargumentuara si dhe të vështira në momentin e vlerësimit nga Komisioni i vlerësimit të Ofertave dhe Grupi i marrjes në dorëzim. Specifikimet teknike të uniformave janë diskriminuese, në mospërputhje me Nenin 36 "Specifikimet Teknike", Ligji nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**11.1 Rekomandimi:** QKUM, në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

***Menjëherë***

**12. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje objekti ndërtimor viti 2022", përsa i përket kryerjes së shërbimit është kryer në datën 19.12.2022, ndërkohë që shpallja fitues e O.E. është bërë me datë 09.12.2022. Sipas specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta lëvrimi i mallit duhej bërë brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (njoftimi i fituesit), ndërsa sipas A.K. është kryer pas 10 ditësh.
Procesverbali i mbajtur mbi realizimin e shërbimit nuk është i shoqëruar me foto që të dokumentohet procesi dhe realizimi i plotë i shërbimit.
Realizimi për 5 ditë i zërave të mësipërm dhe me dy punonjës është i pamundur, në mospërputhje me Nenin 23 "Specifikimet Teknike", Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 50-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**12.1 Rekomandimi:** QKUM, të bëjë të mundur llogaritjen dhe alokimin e penalitetit sipas kushteve të kontratës mbi ditët jashtë afatit të lëvrimit të mallit dhe në të ardhmen të kryejë lëvrimin e mallit/shërbimit sipas kushteve të kontratës.

***Menjëherë***

## C1. MASA SHPËRBLIM DËMI

**1. Gjetje nga auditimi**: Në hartimin e Specifikimeve Teknike nuk janë detajuar zërat të cilët do të mbulohen nga siguracioni (ndërtesa, instalime teknike e makineri, inventari ekonomik), si minimum për përcaktimin e vlerës që mbulon çdo kategori si dhe dhënien e ofertave nga O.E. të interesuar.
Oferta e sjellë nga O.E. fitues është në shumën 4,427,000 lekë pa tvsh, shumë e cila ndryshon nga oferta e sjellë nga i njëjti O.E. në shumën 4,380,000 lekë pa tvsh gjatë përllogaritjes së fondit limit, me diferencë prej 47,000 lekë pa tvsh, duke mos dhënë arsyet përkatëse, gjë që fakton dhe gjetjen cituar nga grupi i auditimit mbi atë se çfarë përfshihet në kategoritë ndërtesa, zyra dhe pajisje mjekësore.

